



Hëna e Re

Viti XXXII | Nr.343 | Prill 2020 | Sha'ban - Ramadan 1441 | Çmimi 50 den

KORONA NUK ËSHTË FUNDI I BOTËS



PEJGAMBERI
MUHAMED
MENDON
NDRYSHE... 25-26

RAPORT NGA TERRENI:
MYFTINIA E KUMANOVËS

ZEQATI -
KUSHTI I
TRETË I FESË
ISLAME
52-55

MIRË SE VJEN, RAMAZAN

(24 PRILL 2020, E PREMTE)



Në foto: Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi dhe prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myfti i Myftinisë së Tetovës. BFI gjithsej ka 13 myftini.

“KURANI FAMËLARTË ME ZËRA TË BUKUR”



Myftinia e Shkupit përfundoi me sukses projektin “Kurani famëlartë me zëra të bukur”, i cili rezultoi me video enkas për muajin e bekuar të Ramazanit 2020/1441.

Në këtë projekt Myftinia e Shkupit ka përzgjedhur hafëzllarë të daluar, të cilët interpretojnë pjesë nga Kurani famëlartë me zërat e tyre të bukur, ku çdo interpretim është i shoqëruar me ilustrim artistik dhe me përkthim e titrim në gjuhën shqipe.

Videot do të emetohen çdo ditë në kanalin zyrtar të Myftinisë në YOUTUBE dhe në rrjetet tona sociale – ka njoftuar Zyra për Informim e Myftinisë së Shkupit më 14 prill 2020.

EDITORIAL

KUJDES NË DHËNIEN E ZEQATIT DHE TË SADEKATUL-FITRIT

Ramazani është muaj shumëdimensional. Pos ibadeteve të tjera, bamirësia, humaniteti dhe solidariteti janë më të theksuara gjatë këtij muaj, sepse në këtë muaj pos dhënies vullnetare - **sadakasë**, jepen edhe **sadekatul-fitri** dhe **zeqati**. E gjithë kjo bën që gjatë këtij muaj të aktivizohen e të riaktivizohen individë, shoqata, organizata dhe misionarë të brendshëm e të jashtëm, të përkatësisë islame dhe joislame, për të grumbulluar sa më shumë mjete financiare nga të dhënat fetare-islame, respektivisht nga sadekatul-fitri dhe zeqati.

Situata e krijuar nga pandemia e virusit Kovid-19 ka bërë që kriza ekonomike në shoqërinë tonë, por jo vetëm te ne, të thellohet edhe më shumë. Kjo do ta shtojë edhe më tufën e “lypësve” ordinerë, por edhe të atyre sezonalë, lexo: të Ramazanit! Me siguri që edhe kësaj radhe do të ketë të atillë që do të “korrin”, siç thotë një fjalë e urtë, “në emrin e të varfërve, me mbiemër personal”.

Lypja do të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe përmes teknologjisë moderne, ku fare nuk kursethet dinjiteti i të varfërve, i fëmijëve, duke i publikuar ata dhe hallet e tyre në mediat elektronike - vetëm e vetëm për të zhvatur sa më shumë nga sadekatul-fitri dhe zeqati i myslimanëve të vendit tonë. Nga kjo edhe lind dilema se për çfarë interesash punojnë dhe veprojnë “humanistët e Ramazanit”? Gjithsesi, përgjigjja do të ishte: për interesat e tyre të ngushta, interesa të cilat, në radhë të parë, e parcializojnë dhe e dëmtojnë interesin e përgjithshëm të popullatës myslimane të vendit tonë, duke dëmtuar njerëzit në nevojë, si dhe duke dëmtuar burimin financiar të institucioneve arsimore islame në vendin tonë.

Ndërkaq, inkasimi i kontributeve fetare gjatë këtij muaji nga shkollat-kolegjet komerciale, të cilat nuk kanë lidhje me Islamin, si dhe fondacionet e jashtme, është një tregim më vete. Metodot e tyre perfide, për të qenë sa më të suksesshëm në “korrjen” e sadekatul-fitrit dhe të zeqatit, bën që një pjesë e këtyre kontributeve të derdhen tek asociacionet e jashtme. Andaj, duhet pasur shumë kujdes se ku dhe kujt ia japim sadekatul-fitrin dhe zeqatin!

Të rikujtojmë se Medresesja Isa Beu dhe Fakulteti i Shkencave Islame u lindën si nevojë e domosdoshme e zhvillimit të jetës fetare dhe të njëjtat, në radhë të parë, u ndërtuan me sadekatul-fitrin dhe me zeqatin e xhemateve të vendit tonë, të cilët vazhdojnë të japin kontributin në mirëmbajtjen e tyre, duke mundësuar që këto dy vatra të arsimit dhe të edukimit islam të punojnë dhe të funksionojnë në mënyrë normale.

Pra, edhe më tej mbetet obligimi ynë i përbashkët, respektivisht obligim i popullatës islame në vendin tonë, e cila edhe i ndërtoi këto dy vatra të dijes, që t’i mirëmbajë, duke i dhënë kontributet fetare siç janë zeqati dhe sadekatul-fitri në fondin e tyre.

S’ka dyshim se kontributet e dhëna për mirëmbajtjen e Medresesë Isa Beu dhe të Fakultetit të Shkencave Islame janë kontribute që jepen për dobinë dhe interesin e përgjithshëm të popullatës myslimane në vendin tonë.

Me një fjalë, këto dy institucione janë fryt i popullatës sonë. Dhe, ata që kanë investuar në ndërtimin e këtyre dy institucioneve, sot krenohen me rezultatet dhe frytin që po e japin këto dy vatra të arsimit dhe të edukimit islam në zhvillimin e jetës fetare në vendin tonë, duke shkolluar, arsimuar dhe edukuar gjeneratat e reja, të cilat me angazhimet e tyre japin kontribut të çmuar në zhvillimin e jetës fetare në këtë nënqiell e më gjerë.

Q. Osmani



PËRMBAJTJA



5-6

FJALA E REISIT: RAMAZANI 2020

MBISHKRIMET ALLAH DHE MUHAMED NUK HIDHEN NË KONTEJNER

9



12-13

KALENDAR: BESNIKU I KURANIT

ALLAHU NUK E DO ÇRREGULLIMIN (FESADIN)

36-41



56-57

MOS EJA, RAMAZANI!

OH "HILAL" NË AKSION

62-63



5	QEVERIA: FESTAT, NË SHTËPI
5	BUJAR OSMANI: SQARIM
6	NAMAZ, VETËM NË SHTËPI; SHKAKU I SITUATËS
8	LETËR QARKORE: MOS TË HUMBET KONTAKTI ME XHEMATIN
8	DEZINFETIMET NË OBJEKTET E BFI-SË
9	ARRESTOHET DOKTORI QË PRODHOI KORONAVIRUSIN?
10	KORONA NUK ËSHTË FUNDI I BOTËS
11	INFODEMIA, MË E RREZIKSHME SE PANDEMIA
13	MËNGJESI ISLAM...
14	HIPOKRITËT KANË ÇRREGULLIM MENDOR
16	MURTAJA, KARANTINAT DHE GJEOPOLITIKA NË PERANDORINË OSMANE
19	PANDEMIA SI SHKAS PËR NDËRGJEGJËSIMIN E BESIMTARIT
20	AKTUALJA QË RRETHOI KATËR ANËT E BOTËS...
21	KORONA - SËMUNDJE QË E SPROVON NJERIUN MODERN
23	PAS ÇDO VËSHITËRËSIE VJEN LEHTËSIMI
25	PEJGAMBERI MUHAMED MENDON NDRYSHE...
26	IBN SINA (AVICENA), ZBULLUES I KARANTINËS
27	COVID-19, SI TË GJENDET ZGJIDHJA
30	KUR NJERIU FLET ME HAMENDJE...
32	SHTREMBËRIM I TË VËRTETËS
33	ÇDO PERSON ME MJEKËR NUK ËSHTË EDHE BABA
34	MUKI PRAPË U BË REZIL
35	KORONAVIRUSI DHE VIRUSET E VEJËL PA DINJITET
42	NUK LODHIN PUNËT, SA LODHIN PENGESAT
46	KËRKIMI I NJOHURIVE SHKENCORE, VEPRIM ADHURIMI
49	LEGJENDA THOTË: PAS ZBARKIMIT, ANIJET NË FLAKË...
52	ZEQATI - KUSHTI I TRETË I FESË ISLAME
58	BETEJA E BEDRIT
60	FTITIMI DHE NDIHMJA E NDËRSJELLË
61	DOKUMENT: BFI NË LIDHJE ME RAMAZANIN 2020

TERAVIA, SIPAS REKOMANDIMEVE QEVERTARE

Në kohën kur e gjithë bota po përballlet me pandeminë e koronavirusit, ndërsa besimtarët e fesë islame i ndajnë vetëm pak ditë nga fillimi i muajit të shenjtë të Ramazanit, në Maqedoninë e Veriut organizimi i namazit të teravive do të varet nga rekomandimet institucionale – ka deklaruar sot në selinë e Myftinisë së Gostivarit Reis’ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, i cili potencoi se në dallim nga vitet e kaluara, myslimanët këtë herë muajin e shenjtë të Ramazanit e presin me një sprovë globale siç është pandemia Covid-19.

Bashkësia Fetare Islame e RMV kohë më parë pezulloi të gjitha aktivitetet fetare që kryhen në xhami - faljen e pesë kohëve të namazit gjatë ditës, si dhe namazin e xhumasë. Kjo është bërë për të ruajtur sigurinë e besimtarëve, përkatësisht për të parandaluar sëmundjen e koronavirusit – është raportuar nga TV Globi, Gostivar.



Të njëjtën ditë, më 6 prill, 2020, Reis’ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka pasur edhe një intervistë me TV Globin.

QEVERIA: FESTAT, NË SHTËPI



Kryeministri Oliver Spasovski në një konferencë shtypi i ka porositur të gjithë besimtarët - përfshi ata të komuniteti mysliman, ortodoks e të tjerë - se festat fetare Ramazan dhe Pashkë këtë vit duhet kaluar në shtëpi, shkak i pandemisë së koronavirusit.

“Të gjitha festat, përfshi këtu Pashkët dhe Ramazanin, duhet dhe do t’i kalojmë në shtëpi. Këtë vit besimtarët lutjet duhet

t’i realizojnë prej në shtëpi. Mesazhet e Pashkëve do t’i nisim prej në shtëpi; e njëjta do të vlejë edhe për festën e Ramazanit. Nga shtëpia, përmes telefonit, përmes internetit, secili nga familja e vet - jo të mbledhur. Kjo nuk do të na bëjë besimtarë më të dobët. Kjo do të na forcojë, sepse e dimë se me këtë do të shpëtojmë jetë”, ka thënë Kryeministri në detyrë i RMV, Oliver Spasovski. (6.04.2020)

BUJAR OSMANI: SQARIM

Sqarim 2: Xhamitë nuk janë mbyllur me ndonjë vendim të Qeverisë dhe as që ka të drejtë një gjë të tillë ta bëjë Qeveria, por ka qenë vullneti i mirë i Bashkësisë Fetare Islame që t’i ndërpret përkohësisht aktivitetet kolektive fetare, për të ruajtur shëndetin e njerëzve nga rreziku i virusit, për çka të gjithë jemi shumë mirënjohës - si për nivelin e lartë të vetëdijes, ashtu dhe të përgjegjësisë që tregoi BFI në këto ditë të vështira! – ka shkruar Zv/Kryeministri në Facebook më 19 prill 2020.

NAMAZ, VETËM NË SHTËPI; SHKAKU I SITUATËS

Karantinimi apo izolimi në rastet e shfaqjeve të epidemive, apo të pandemive, është detyrim islam i obligueshëm, urdhër i Pejgamberit (a. s.) që duhet me patjetër të respektohet, kurse menaxhimi i këtyre pandemive, mënyra e izolimit, koha e izolimit - janë çështje të ekspertëve të lëmenjve përkatës, është shprehur Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h. Sulejman ef. Rexhepi.

Të nderuar besimtarë të Islamit, vëllezër e motra,

Jemi në vigjilje të Muajit të Shenjtë të Ramazanit, muaj ky i shpalljes së Kuranit, muaj i agjërimit në emër të Zotit, muaj i sakrificës dhe i dashurisë.

Për fat të keq, kësaj here ky muaj i shenjtë vjen në një kohë delikate e të vështirë për tërë njerëzimin, i cili po lufton me pandeminë e shkaktuar nga virusi Covid-19. Ndodh në kohën kur të gjithë ne po përpiqemi të mbrojmë veten dhe familjet tona, të mbrojmë shoqërinë e të mbrojmë popullin.

Së këndejmi, më lejoni që këtë paraqitje timen t'ia kushtoj qëndrimit që ka Islami ndaj shëndetit në përgjithësi dhe ndaj epidemive të ndryshme në veçanti.

Janë pesë vlera universale (esenciale) të cilave myslimani detyrimisht duhet t'u kushtojë vëmendje të plotë dhe s'guxon të dëmtojë asnjëherë prej tyre, sepse çdo veprim ndryshe konsiderohet rreptësisht i ndaluar dhe bart përgjegjësi jo vetëm morale, por edhe ligjore islame. Këto vlera janë:

1. Ruajtja e fesë, e kombit - Ummetit dhe vatanit
2. Ruajtja e jetës dhe e trupit,
3. Ruajtja e mendjes – e arsyes,
4. Ruajtja e familjes, e nderit dhe e moralit; dhe
5. Ruajtja e pasurisë private dhe shoqërore.

Prej shumë begative të mëdha që i ka dhuruar Allahu (xh. sh.) njeriut, përveç begatisë së besimit, shëndeti llogaritet ndër begatitë prioritare, për të cilën çdo njeri, e veçmas besimtari, e ka detyrim të përkujdeset. Në këtë rrafsh, parimi islam është se **“preventiva është më e mirë se shërimi”**. Ky parim i kahershëm i Islamit është pjesë përbërëse e besimit të myslimanëve tani e 14 shekuj. Dhe, të mos harrojmë: myslimani e kërkon ndihmën dhe drejtohet Allahut për shpëtim vetëm nëse ndërmer masat e duhura paraprake për të mbrojtur shëndetin. Ndryshe, çdo veprim konsiderohet jo i kuptuar drejt dhe keqpërdorim i parimeve të Islamit.

NGA KADERI I ALLAHUT, NË KADERIN E ALLAHUT

Në Sahihun e Imam Buhariut (r. a.) gjejmë të regjistruar tregimin e Omer ibn Hatabit (r. a.), i cili në cilësinë e Kalifit ishte nisur për në Sham, për të vizituar bazën ushtarake që kishte atje, në krye të së cilës ishte Ebu Ubejde ibn Xherrahu. Rrugës duke shkuar ai takon Ubejden, kreun më të lartë të ushtrisë, i cili e informon se në Sham ka rënë një epidemi. Ajo po merrte jetën e shumë njerëzve. Omeri (r. a.), për të marrë një qëndrim, konsultoi të gjitha palët - ensarët, muhaxhirët – të cilët kishin mendime të ndryshme. Në fund mori qëndrim që të kthehet, të mos hyjë në Sham, sepse atje pos që rrezikohej jeta e tij, por në rrezik vihej edhe jeta e atyre që i kishte me vete. Ubejd ibn Xherrahu, i cili kishte mendim diametralisht të ndryshëm nga mendimi i Kalifit, i tha: **“A po ik prej kaderit (përcaktimit) të Zotit, o Omer!?”** Omeri (r. a.) tha: **“Po. Po ikim nga kaderi i Allahut, në kaderin e Allahut.”** Gjatë kësaj bisede mes tyre, arriti Abdurrahman ibn Aafi, i cili, pasi kuptoi rrjedhën e bisedës, tha: **“Unë di për këtë çështje, kam informacion, sepse e kam dëgjuar të dërguarin e Allahut (s.a.v.s.) duke thënë: ‘Nëse dëgjoni se në një vend ka epidemi (sëmundje ngjitëse), mos hyni në atë vend; e nëse eventualisht gjendeni në atë vend, mos u largoni nga ai vend për të ikur prej saj.’”** Në këtë rast Omeri

(r. a.) falënderoi Allahun (xh. sh.) dhe u kthye për në Medinë.

Ubejde ibn Xherrahu vazhdoi në Sham dhe u godit nga epidemia, e cila i mori jetën atij dhe gjithë të tjerëve e që thuhet se në atë kohë kishte marrë jetën e rreth tri dhjetë mijë njerëzve - ushtarë e civilë. Pas tij komandën e mori Muadh ibn Xhebeli (r. a.), i cili po ashtu u godit nga epidemia dhe humbi jetën. Pas tij komandën e mori Amr ibn Asi (r. a.), i cili vendosi të merrte masa, me ç'rast iu drejtua popullit me fjalët: **“O ju njerëz, vërtet kjo epidemi është sikur zjarri i ndezur; ju jeni lënda djegëse e këtij zjarri; shpërndahuni nëpër kodrat (malet) e Shamit dhe izolohuni derisa zjarri të mos gjejë më ç'të djegë dhe Allahu ta ngrejë këtë provë prej nesh.”** Këtë udhëzim të Amrit e implementoi populli dhe shpëtuan nga pandemia.

Pra, vetizolimi apo karantina në rastet e shfaqjes së epidemive të ndryshme bazën e përcaktimit e ka në burimet e shëritit islam, përkatësisht në sistemin juridik islam dhe në parimet e përgjithshme islame.

Nocioni **karantinë** rrjedh nga gjuha italiane “kuarantena”, ose nga gjuha frënge “quarantine”, që do të thotë **‘rreth të dyzetat’**. Ky nocion në literaturën islame njihet si “el-HIXHRU es-S I H-H I J **الحَجْرُ الصَّحِّي**”, që synon izolimin e individëve apo edhe grupeve që janë goditur, apo kanë rrezik të goditjes, me ndonjë sëmundje ngjitëse, me intencë të ruajtjes së shëndetit të përgjithshëm.

Këto janë parime të përgjithshme, për të cilat flet Pejgamberi (a. s.), kurse format e organizimit të izolimit, masat që duhet të merren, koha sa duhet qëndruar në vetizolim dhe çështje të tjera - janë teknikalitete, me të cilat duhet të merren ekspertët e fushës përkatëse, organet



kompetente dhe Ministria e Shëndetësisë. Nga argumentet e përgjithshme, nga të cilat qartë nënkuptohet mbrojtja nga rreziku i epidemive apo pandemive të ndryshme, është edhe ajeti kuranor ku Allahu (xh. sh.) thotë: **“Mos e hidhni veten me duart tuaja në rrezik dhe, bëni mirë; se me të vërtetë, Allahu i do bamirësit.”** (El Bekare: 195)

Në hadithin e transmetuar nga Xhabiri (r. a.) thuhet se Pejgamberi (a. s.) ka thënë: **“Ai që ik nga sëmundja ngjitëse (nga vendi ku e ka fillësën sëmundja ngjitëse) është i ngjashëm me atë që ikë (që dezer-ton) nga vija e frontit të luftës, kurse ai që qëndron në atë vend dhe ballafaqohet me durimin ndaj kësaj sëmundje është si ai durimtari në vijën e frontit.”**

Analiza e këtij hadithi të Pejgamberit (a. s.) tregon për dy urdhra ndalesë:

ndalimi i daljes nga vendi i cili është përfshirë nga epidemia, që të mos përhapë sëmundjen edhe te njerëzit tjerë, dhe **ndalimi i hyrjes së njerëzve të tjerë nga jashtë në atë vend ku ka epidemi**, kurse mosrespektimi i këtyre urdhrave konsiderohet mëkat prej mëkateve të mëdha.

Kështu e kishin kuptuar Islamit gjenerata e artë e sahabëve dhe kështu kishin vepruar. Imam Maliku (r. a.) në Senedin e tij tregon se Omer ibn Hatabi (r. a.) njerëherë, duke qenë në Haxh, e pa një grua e cila bënte Tavaf rreth Qabesë, tek e cila vëreheshin shenja të një sëmundjeje ngjitëse. Omeri (r. a.), si Kalif i myslimanëve që ishte, iu afrua gruas dhe i tha: **Oj robëresha e Allahut, mos i dëmto njerëzit; do të ishte më mirë sikur ti të kishe qëndruar në shtëpi!** Pra, prezenca jote është rrezik, që

me këtë sëmundje të dëmtosh edhe të tjerët. E, nëse e bën këtë, atëherë dëmi yt është më i madh se sevapi që bën me Tavafin rreth Qabesë. Gruaja e dëgjoi porosinë e Omerit (r. a.) dhe menjëherë u izolua në shtëpi.

ISLAMI, 660 VJET PËRPARA

Dijetari, mufessiri dhe historiani i njohur islam Ibni Kethiri në veprën tij “El Bidajetu ve en-nihaje” thotë: Karantinën – izolimin, si institucion zyrtar dhe si vend të veçantë për shërimin e njerëzve të sëmurë nga këto sëmundje (ngjitëse), për herë të parë në historinë e njerëzimit juridikisht e normoi dhe financiarisht e mirëmbajti kalifi emevit El Velid ibn Abdulmelik (mes viteve 705-708). Ai në Sham ngriti spitalin enkas për shërimin e të sëmurëve me sëmundje ngjitëse. Bota perëndimore e njohu karantinën në vitin 1377, kur ajo u hap në Venedik të Italisë dhe në Raguza (Dubrovnik) të Kroacisë së sotme, që do të thotë se këto masa dhe institucione bota islame i kishte ngritur plot 660 vjet para se ato të paraqiteshin në pjesën perëndimore të botës.

Konkluojmë se **karantinimi** apo izolimi në rastet e shfaqjeve të epidemive, apo të pandemive, është detyrim islam i obligueshëm, urdhër i Pejgamberit (a. s.) që duhet me patjetër të respektohet, kurse menaxhimi i këtyre pandemive, mënyra e izolimit, koha e izolimit - janë çështje të ekspertëve të lëmenjve përkatës.

Vëllezër e motra,

Islami është fe e dritës dhe e diturisë. Islami nuk injoron, as anashkalon e nuk i

përbuz parimet e shëndosha shkencore. Përkundrazi, respekton dhe kontribuon me shekuj në favor të atyre parimeve.

Apeloi dhe ju lutem që t’ju përmbahemi parimeve islame për shëndetin tuaj dhe të gjithë të tjerëve dhe, njëkohësisht, të respektojmë atë që thonë mjekët dhe ekspertët lidhur me pandeminë Covid -19. Vetëm ashtu do të ngadhënjem dhe do t’i kthehemi normalitetit të jetëve tona; vetëm kështu do të jenë të justifikuar lutjet tona për kërkimin e shpëtimit drejtuar Allahut të gjithëmëshirshëm.

Në fund, po ju përkujtoj se Ramazani edhe në këto ditë të vështira do t’i gëzojë zemrat tona, kurse agjërimi mbetet obligim i çdo besimtarit që është i shëndoshë fizikisht e psikikisht, si dhe i gjithë atyre që nuk janë udhëtarë. Nga xhamitë tona do të vazhdojë të dëgjohej Ezani, si gjithmonë, dhe kandilat do të ndriçojnë me tërë bukurinë e tyre.

Të gjitha myftinitë e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut tani kanë marrë obligimin të organizojnë ligjëratat të ndryshme fetare nëpër mediat e vendit, kurse në çdo xhami për çdo ditë në kohën e drekës do të këndohet nga një mukabele. Ramazani do të jetë i bukur si përherë, pa marrë parasysh nëse situata e krijuar na detyron të falim namazet kushtuar Allahut (xh. sh.) nëpër shtëpitë tona.

Të gjithë besimtarëve myslimanë në Maqedoninë e Veriut e më gjerë, si edhe atyre nga diaspora jonë e çmuar, Allahu i plotfuqishëm ua pranofte ibadetet dhe u dhashtë gëzime.

Ju dëshiroj Ramazan të këndshëm dhe shëndet të plotë. (17 prill 2020)

LETËR QARKORE: MOS TË HUMBET KONTAKTI ME XHEMATIN

Situata që u krijua kohëve të fundit në vend si pasojë e përhapjes së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19, si edhe nga masat emergjente parandaluese që i ndërmoi Qeveria e RMV, po reflekton edhe në punën dhe aktivitetin e BFI dhe të organeve të saj në përgjithësi.

Lidhur me këtë, Reis'ul-Ulema i BFI të RMV rekomandon që të gjitha Myftinitë të organizojnë kujdestari nëpër xhami dhe të caktojnë imamët të cilët do të mbajnë gjallë kontaktet dhe do të jenë në shërbim të xhematin.

Në këtë situatë të rënduar me të cilën po ndeshet popullata, imamët duhet të njihen me problemet eventuale të xhematit të tyre - qofshin ato të lidhura me infektimin eventuale të individëve të caktuar, apo me mungesën e produkteve ushqimore që mund të paraqiten te shtresa e njerëzve tanë të cilët qëndrojnë materialisht më dobët.

Për problemet e këtu eventuale, imamët duhet urgjentisht të njoftojnë Myftininë gjegjëse, kurse kjo informata t'i përcjellë në Kryesinë e BFI, me qëllim që të ndërmerren veprime adekuate për t'u dalë në ndihmë njerëzve në nevojë.

Masa e fundit e shpallur nga Qeveria, pra ora policore që do të vlejë nga data 22.03.2020, është pa diskutim një masë e nevojshme në këtë situatë dhe përshëndetet nga të gjitha organet e BFI të RMV, por njëkohësisht duhet theksuar se ajo godet dhe dëmton rëndë punën dhe ekzistencën e BFI në tërësi, e cila kryekëput varet nga besimtarët myslimanë dhe xhematet. Për këtë shkak, BFI pret që shteti do të ketë mirëkuptim për vështirësitë e saj dhe do e ndihmojë në tejkalimin e problemeve që reflektojnë nga masat e ndryshme. (22.03.2020)



DEZINFECTIME NË OBJEKTET E BFI-SË

Me kërkesë të Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, më 20 mars, 2020, Qendra e Shëndetit Publik - Shkup ka dezinfektuar objektin e Rijasetit (selinë e BFI-së); Medresenë Isa Beu-Paralelja e Vajzave, Shkup; Medresenë Isa Beu-Qendër (restorantin, konviktin), Fakultetin e Shkencave Islame dhe Xhaminë e FSHI.

Dezinfektimi është bërë pas paraqitjes së koronavirusit dhe shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në nivel të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

BFI është e angazhuar për respektimin e plotë të masave qeveritare kundër virusit shkatërrues, i cili ka prekur pothuajse tërë planetin.

Reisi dhe të gjithë të punësuarit, në të 13-të myftinitë, bëjnë lutje që kjo së-



mundje e rëndë të tejkalohet sa më shpejt dhe me sa më pak pasoja. BFI po ashtu u bën apel besimtarëve t'u përmbahen strikt rregullave islame të ruajtjes së pa-

stërtisë dhe të reflektojnë pozitivisht të mesin e të gjithë qytetarëve, pavarësisht besimeve të tyre, si dhe të ndihmojnë veten dhe të tjerët kundër pandemisë.

MBISHKRIMET ALLAH DHE MUHAMED NUK HIDHEN NË KONTEJNER

Më 15 prill, 2020, Myftinia e Shkupit ka dalë me komunikatë, në të cilën thuhet: Me kujdes të veçantë po ndiqet situata e krijuar si pasojë e pandemisë së Covid-19, me ndihmën e hoxhallarëve të Shkupit me rrethinë dhe besimtarëve shkupjanë në përgjithësi, të cilëve publikisht u shprehim mirënjohje të përzemërta, sepse rregullisht raportojnë për gjendjen që mbizotëron në të gjitha rajonet e Shkupit, me qëllim të ndërgjegjësimit të besimtarëve dhe ofrimin e zgjidhjeve mbi rregullat e përgjithshme fetare, në bazë të rekomandimeve të BFI-së, si dhe të institucioneve relevante mbi kujdesin ndaj shëndetit dhe rendit publik gjatë kësaj periudhe.

Feja islame i kushton rëndësi të veçantë dhe gjithmonë i jep përparësi pastërtisë dhe shëndetit të njeriut, bazuar në fjalët e Allahut (xh. sh.) dhe të gjitha mësimëve të Muhamedit (a. s.).

Por, për të pasqyruar moralin e vërtetë islam, ne si besimtarë e kemi për detyrë që t'u përmbahemi rregullave fetare edhe gjatë pastrimit dhe mirëmbajtjes së ambientit ku jetojmë, andaj duhet të dimë saktë se si dhe ku duhet hedhur mbeturinat dhe se në aspekt fetar çka konsiderohet mbetje që lejohet të hidhet në mbeturinë dhe anasjelltas – thuhet në Komunikatë.

Në këtë kontekst, kemi hasur në një



veprim, për të cilin besojmë se nuk bëhet qëllimisht, por si rezultat i moskujdesit nga ana e qytetarëve gjatë pastrimit të shtëpive të tyre, ku mbushen parqet e rrugët, e madje ndoshta me padije hidhen në mbeturina korniza me mbishkrimet Allah dhe Muhamed, andaj i rikujtojmë të gjithë besimtarët se ky veprim është i ndaluar në Islam.

Në lidhje me këtë çështje, ju sjellim udhëzimin në bazë të mësimëve të Pejgamberit dhe dispozitës islame si vijon:

Nëse mbishkrimet e këtu, si rezultat i gjendjes së tyre të vjetruar nuk mund të lexohen, letra me tekstin kurranor duhet të griset dhe të varrosen. Pra, mbështillet me ndonjë rrobë të pastër dhe varrosen në vend të pastër, ku nuk frekuentojnë njerëzit. Nëse nuk ka mundësi të bëhet kjo, alternativa tjetër është se mund të digjet dhe hiri të hidhet në ndonjë vend ku nuk frekuentojnë njerëzit, që do të thotë se hiri nuk guxon të hidhet në ndonjë vend të papastër, ose në kontejner.

Varrosja e fletëve të vjetruara ose të grisura nuk nënkupton përbuzjen; varrosja nënkupton respektin ndaj Kuranit. Një veprim i tillë bëhet me qëllim që Kurani të mos nëpërkëmbet dhe të mos degradohet. Ashtu që varrosen si myslimani. Varrimi i besimtarit nuk nënkupton zhvlerësimin, por respektin dhe nderin ndaj të vdekurit.


Obligim fetar i gjithsecilit prej nesh është që ta demonstrojmë edukatën islame edhe në çështjen e pastërtisë, fillimisht duke u kujdesur ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj vendit ku jetojmë, duke vepruar me përgjegjësi dhe maturi dhe të këshillohemi për çdo veprim që ndërmarim në jetën e kësaj bote.

Lusim Allahun fuqiptotë që të na forcojë edhe më tepër shpirtërisht përballë kësaj sprove- pandemisë së virusit Covid-19! – thuhet në Komunikatën e Myftinisë së Shkupit, të nënshkruar nga Myftiu i saj, dr. Qenan ef. Ismaili.

ARRESTOHET DOKTORI QË PRODHOI KORONAVIRUSIN?

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë zbuluar personin i cili dyshohet se bëri dhe shiti virusin Korona në Kinë. Është ky doktor Charles Lieber, shef i Departamentit të Kimisë dhe Biologjisë në Universitetin e Harvardit, raportojnë mediat amerikane.

Njësitë Federale janë parë në shtëpinë e doktorit 60-vjeçar Charles Lieber, i cili është arrestuar teksa ka qenë në zyrën e tij në Universitetin e Harvardit, kanë raportuar mediat. (6 prill 2020)





Shkruan
H. Sulejman ef. Rexhepi

Korona nuk është fundi i botës

Engjëlli që është i caktuar për të marrë shpirtin e njeriut nuk quhet Korona. Emri i tij është Azrail dhe pa urdhrin e tij nuk merret shpirti; Azraili, ndërkaq, i bindet vetëm Zotit dhe i zbaton vetëm urdhrat e Zotit!

“Përpiku dhe lufto, ose ik” - është një reagim normal njerëzor në situatat e rrezikshme, në të cilat individi kërkon të mbijetojë. Varet nga karakteri i secilit prej neve cilin opsion për të mbijetuar do ta zgjedhë.

Në këto ditë të izolimit të përgjithshëm në gjatë të cilave jemi të vërsuar me informata të duarnduarta, që bëjnë fjalë për përqindje infektimesh e vdekjesh, me raporte që herë të trishtojnë e herë të ngjallin shpresë - ndjenja e frikës nuk është e turpshme, sepse është e natyrshme që njeriu të frikësohet nga diçka që mund të shkaktojë vdekje, siç është rasti me Covid-19. Të ndërmarrësh masa për të mbrojtur veten, familjen dhe rrethin, është guxim.

Por, nuk është e natyrshme nëse njeriu mbërthehet me mënyra disfunkionale të menduarit dhe bie në depression e anksozitet, të cilat pastaj, si pasojë, e zhytin atë në panik. Së këndejmi, në situata krize të përgjithshme, siç është kjo që e po e dridh aktualisht botën, është e nevojshme që të gjithë ne të jemi të informuar drejt dhe nga burime të besueshme, që nënkupton njoftimet zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të shtabeve emergjente të formuara enkas për këtë situatë, të epidemiologëve. Po ashtu, për të qenë të informuar drejt, mund të ndjekim kohë pas kohe edhe sajtin e specializuar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Kaq informim mjafton, sepse konsumimi i çdo gjëje që përhapet nëpër internet sigurisht që e shton anksozitetin (- lemerisjen) dhe depressionin. Anipse po jetojmë e po funksionojmë në një situatë të jashtëzakonshme, që nënkupton kufizime të shumta, shumë më mirë është t’u kthehem gjërave të cilat ndoshta patëm filluar t’i anashkalojmë. Pra, të ringjallim komunikimin dhe afërsinë me familjarët tanë, të bisedojmë për gjëra të cilat moti nuk i kemi biseduar, të këshillojmë njëri-tjetrit, të dëgjojmë mendimet e atyre që përherë kanë qenë të heshtur dhe të analizojmë

frikat e njëri-tjetrit. Njëkohësisht, duhet të shfrytëzojmë mundësitë që ofron teknologjia dhe të vazhdojmë të jetojmë jetën tonë sociale në mënyrë virtuale, të dëgjojmë hallet e shokëve dhe t’ua tregojmë atyre hallet tona.

Kjo situatë dhe kjo krizë do prek edhe në situatën tonë ekonomike dhe në raportet ndër-njerëzore, gjë e cila mund të reflektojë seriozisht në raportet mes njerëzve kur të marrë fund e gjithë kjo. Andaj, në vend se të dëgjojmë pallavra të cilat i përhapin shpirtzinjtë, të cilët në kohë krize të përgjithshme shënjestrojnë ndjenjat tona, duhet të përpiqemi të bëjmë gjithçka që është e mundur për të afërmit tanë, për fqinjët, për miqtë. Dhe, të mos harrojmë se ka njerëz të cilët ndoshta kanë nevojë për ndihmën tonë; andaj, të interesohemi për të tillët e të solidarizohemi, të shfrytëzojmë mundësitë e internetit dhe të telefonave që kemi për të qenë pranë atyre që kanë nevojë për ne.

Të gjitha këto po i them, sepse janë gjëra qenësore e thelbësore dhe i kundërvihen përhapjes së panikut dhe lajmeve të pavërteta, të cilat, nga ana tjetër, paraqesin vepra të dënueshme, me të cilat do të duhej të merrej shteti, i cili e ka për detyrë të na mbrojë prej tyre. Por, kur shteti është i preokupuar me një problem tjetër, siç është në këtë rast lufta kundër përhapjes së virusit, neve të gjithëve na mbetet që vetë të luftojmë kundër përhapjes së gënjeshtërave që shkaktojnë panik. Ne vetë duhet t’i detektojmë ata që në atmosferë të rrezikut për jetën tonë përpiqen të promovohen përmes manipulimeve të opinionit. Jo kot njerëzit që veprojnë ashtu janë emëruar si “marketing-prostituta”.

Në këtë kontekst, duhet të përkujtojmë se jeta dhe vdekja varen ekskluzivisht nga vullneti i Allahut (xh. sh.); andaj, ata që e besojnë këtë fakt - dhe që në numër janë të shumtë ndër ne - nuk guxojnë të bien viktima të panikut, sepse ai është një dënim të cilin e sjell mosbesimi. Njëkohësisht, duhet thënë se bota

është e shqetësuar në këtë kohë nga një virus që nuk vjen nga Zoti; ai është virus i krijuar nga pakujdesia e njeriut - bile, ekzistojnë mendime se ai është krijuar artificialisht.

Ndërkohë, numri i të infektuarve po shtohet, kështu që nuk dihet se kah mund të shkojë kurba (lakorja) në dy javët e ardhshme në vend. Nëse numri i të infektuarve në këtë periudhë shtohet shumë, është e sigurt që organet kompetente do të ndër-marrin restriksione edhe më të rrepta. Dhe, ne të gjithë do të duhet t’i respektojmë maksimalisht të gjitha ato masa. Pa marrë parasysh qëndrimet dhe orientimet tona politike, ne duhet t’i besojmë dhe të mbështetemi te Qeveria dhe masat që ajo i merr përmes institucioneve të veta, njësoj siç po ndodh gjithkund nëpër botë. Dhëntë Zoti ta tejkalojmë sa më lehtë dhe me më pak humbje të jetëve njerëzore këtë pandemi, mandej do të kemi mjaftueshëm kohë ta kritikojmë edhe Qeverinë, edhe politikën; të nxjerrim mllëfin e të derdhim frustracionet.

Sot është kohë e një lufte të përgjithshme mbrojtëse dhe ata që s’mund të qëndrojnë në front, duhet së paku të shërbejnë si logjistikë. Lufta të cilën sot po e bëjnë shtetet dhe tërë njerëzimi kundër virusit Korona, nuk është luftë vullnetare; ajo është luftë e detyrueshme, luftë të cilën duhet ta ndihmojmë e ta përkrahim të gjithë.

Në pritje të ngadhënjimit të njerëzimit mbi virusin, të shpresojmë se Allahu i Plotfuqishëm do t’i pranojë lutjet tona. Jo Korona - Kiameti është fundi i botës! Dhe, engjëlli që është i caktuar për të marrë shpirtin e njeriut nuk quhet Korona. Emri i tij është Azrail dhe pa urdhrin e tij nuk merret shpirti; Azraili, ndërkaq, i bindet vetëm Zotit dhe i zbaton vetëm urdhrat e Zotit! (5 prill 2020)

INFODEMIA, MË E RREZIKSHME SE PANDEMIA

Konspiracionet e ndryshme për të cilat po lexojmë, si edhe informatat që nuk kanë kurrfarë baze të qëndrueshme shëndetësore, ndjellin frikë e panik. Duke i ndjekur ato, edhe njerëzit të cilët nuk janë të prekur nga Korona po fillojnë të ndihen të sëmurë.

Bota është në luftë, njerëzimi po përballë me sfidën më të madhe që e ka prekur pas Luftës së Dytë Botërore; jeta përpara përhapjes së virusit Korona, shikuar nga kjo distancë dhe nga kjo atmosferë që po mbretëron, shumëkujt po i duket si një ëndërr...

S’do mend se ka të vërteta në konstatimin e fillimit të këtij teksti; s’do mend se njerëzimi është i frikësuar përpara hovit që po merr kjo epidemi e panjohur deri sot; s’do mend se njeriu, natyrshëm, më shumë se nga dukuritë tjera, frikësohet nga e panjohura.

Sot, përveç Zotit, të cilit i mbështetemi, asgjë nuk është më e rëndësishme se krijimi i frontit të përbashkët kundër epidemisë vrapëse; sot, si asnjëherë më parë, duken triviale shpurthjet e disave për të bërë politikë; sot edhe arsimit e kultura ia kanë liru vendin luftës së përbashkët; sot edhe organizimi i jetës fetare është i dëmtuar sikur asnjëherë më parë për shkak të ndalesave dhe restriksioneve të cilat po i aplikon Qeveria me rekomandim të ekspertëve të epidemiologjisë.

Por, njeriu, të cilin Zoti, në dallim nga krijesat tjera, e pajisi me aftësinë e të menduarit, i dhuroi inteligjencën dhe aftësinë për t’iu adaptuar kohëve e situatave më të ndryshme, do të ngadhënjë edhe mbi virusin Korona, siç ka ngadhënjyer gjatë historisë mbi epidemi të ndryshme dhe ka tejkaluar kriza gjithëfare.

Së këndejmi, është shumë e rëndësishme që informatat të cilat i ofrohen popullatës lidhur me epideminë të frymojnë me besueshmëri të qindpërqindtë; ato s’guxojnë të modifikohen e të shërbejnë për klikime, sepse ashtu i jepen krahë epidemisë. Një këshillë e gabuar në këtë situatë, mund të shkaktojë një zinxhir të tërë veprimesh të gabuara.

Dhe, kur po flas për këto dukuri, e kam posaçërisht me mediat nga margjinat e internetit, me portalet dhe blogjet e caktuar, të cilat po përhapin panik te qytetarët, pa ia vënë veshin faktit se përgjegjësia ndaj publikimit të informatave në këtë situatë është shumëfish më e madhe se sa në situatat normale.

Është e njohur se në situata kur njeriu është i frikësuar, fillon të kërkojë rrugëdalje gjithkund dhe pavetëdijshëm bëhet viktimë e informacioneve të rrejshme, të cilat shkaktojnë

panik. Nëse kësaj i shtohet edhe fakti që një pjesë e mirë e popullatës tonë nuk di të dallojë lajmin e rremë nga ai i vërteti, fotografia kompletohet në tërësi, kurse njeriu i painformuar - drejt, bëhet përhapës i virusit dezinformativ, i cili shpërndahet me të njëjtin ritëm sikurse pandemia, në mos edhe më shpejt.

Njohësit e rrethanave të këtylla dhe psikologët po thonë se shqetësimet, streset dhe reagimet emotive ndaj frikës ndikojnë që njerëzit më lehtë t’ua besojnë thashethemeve se njoftimeve zyrtare, duke e eliminuar në masë të madhe të menduarit dhe të vepruarit racional.

Në këtë situatë, përfundimisht duhet të gjithë ne të mbështetemi në rekomandimet që vijnë nga organet kompetente shëndetësore e të informohemi nga burime kredibile, të cilat nuk vrapojnë pas lajmeve senzacionaliste. Në këtë drejtim, edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë tërheq vërejtjen se përhapja e lajmeve të paverifikuara është po aq e dëmshme sa edhe vetë pandemia.

Pra, konspiracionet e ndryshme për të cilat po lexojmë, si edhe informatat që nuk kanë kurrfarë baze të qëndrueshme shëndetësore, ndjellin frikë e panik. Duke i ndjekur ato, edhe njerëzit të cilët nuk janë të prekur nga Korona po fillojnë të ndihen të sëmurë.

Këto ditë të trazura që po i jetojmë janë edhe sprovë, përpara së cilës ne të gjithë do të duhet të dëshmojmë gatishmërinë dhe aftësinë për të mbijetuar. Në këto përpyekje nuk ka vend për frikën dhe nuk ka vend për panikun. Mbështetja te Zoti dhe veprimet tona racionale, solidariteti dhe humaniteti - e mbi të gjitha vetëdija e plotë për rrezikun që vjen nga Covid 19 - do të na mundësojnë ta tejkalojmë epideminë e t’i kthehem jetës normale. (22 mars 2020)

Sqarim: Infodemia, një fjalë e re, e krijuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, më 2 shkurt 2020, në Raportin nr. 13 të situatës me koronavirusin. Shih: <https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200202-sitrep-13-ncov-v3.pdf>

(Autori, Reis’ul-Ulema
h. Sulejman ef. Rexhepi, është Kryetar
i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së
Maqedonisë së Veriut)

BESNIKU I KURANIT

20 prillin e vitit 571 e gjithë bota myslimane e kujton si ditë të lindjes së pejgamberit të fundit, Muhamedit (a. s.). Pa mësimet dhe ndjekjen e rrugës së tij, çdo njeri do të ishte i humbur.

Shkruan: Mr. Beqir Memeti

20 prillin e vitit 571 (12 Rebiul evvel, të Vitit të Elefantit) e gjithë bota myslimane e kujton si ditë të lindjes së pejgamberit të fundit, Muhamedit (a. s.). Lindja e Muhamedit (a. s.), pa dyshim është njëra nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë njerëzore. Muhamedi (alejhis-selam) është udhëzuesi, predikuesi, interpretuesi dhe njohësi më i mirë i Kuranit famëlartë. Pa mësimet dhe ndjekjen e rrugës së tij, çdo njeri do të ishte i humbur.

Lindja e Muhamedit (alejhis-selam) shkëlqeu botën dhe ngrysi errësirën. Ai lindi në një kohë dhe vend ku mbizotëronte injoranca, padrejtësia dhe mjerimi. Me një elokuencë të rrallë dhe një modesti vetëmohuese, duhet të pranojmë se nuk ka penë në botë që ta përshkruajë personalitetin e Muhamedit (a. s.), të cilin e ka përshkruar dhe lavdëruar vetë Allahu i Lartësuar në Kuranin famëlartë.

MËSHIRË PËR TË GJITHË NJERËZIMIN

Duke u mbështetur në mësimet kuranore, të gjithë autorët sqarojnë qëllimin e dërgimit të Muhamedit (a. s.), i cili është dërguar si mëshirë për të gjithë njerëzimin, ai është pishtar ndriçues, shembulli më i mirë, njeriu me shkallën më të lartë të moralit etj.

Muhamedi (a. s.) erdhi për t'i udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë, në rrugën e Zotit, krijuesit të botëve. Ai është dërguar për të jetësuar drejtësinë dhe barazinë, pavarësisht dallimeve racore. Ai është dërguar për t'i larguar dhe shpëtuar njerëzit nga nënshtrimi i njëri-

tjetrit dhe për t'u treguar qëllimin e krijimit të tyre.

Më 12 Rebiul evvel, më 20 prill 571, natën e hënë, në qytetin e Medinës, në Arabinë qendrore, ndodhi një ngjarje e jashtëzakonshme. Këtë natë prishet heshtja e vajtueshme dhe mjerimi që kishte mbuluar fisin e kurejshëve.

Muhamedi (a. s.) e shijoi vetë idhëtinë e mungesës së prindërve dhe mjerimin e jetimllëkut. Ai është një

ngushëllim për të gjithë jetimët dhe një kujdestar për të drejtat e tyre. Muhamedi (a. s.) u rrit pa arsim; ai nuk dinte shkrim-lexim. Një jetim dhe analfabet - ku mori gjithë atë dituri të madhe dhe të mrekullueshme? Muhamedi (a. s.) u rrit i varfër. Prindërit nuk i lanë asgjë; ai u rrit nën kujdesin e gjyshit të tij, Abdulmutalibit dhe axhës së tij, Ebu Talibit. Nga të gjithë kurejshët, për fisnikëri dalloheshin hashimitët, nga të



cilët rridhnin të parët e Mekës dhe kujdestarët e Qabesë. Përkërisht nga kjo familje e kishte origjinën Muhamedi (alejhis-selam), kurse trunq familjar i tij arrinte deri tek Ibrahim (alejhis-selam).

Ishte tepër i sinqertë dhe besnik; nuk e tradhtonte kurrë premtimin e dhënë, nuk e shpërdoronte besimin. Shoqëria mekase edhe para zbritjes së Shpalljes, i vlerësonte cilësitë e larta të Muhamedit (alejhis-selam), prandaj edhe njihej si el-emin (besnik).

Gjithësia ka vetëm një Krijues, që meriton çdo lavdërim dhe duhet adhuruar. Zoti për të cilin predikonte Muhamedi (a. s.) është Rabul alemin - Zot i botëve. Gjithë njerëzimi duhet që ta njohë Zotin e botëve dhe vetëm në këtë pikë duhet që të bashkohen, të kuptojnë se janë vëllezër dhe se nuk ka arsye për mosmarrëveshje dhe konflikte.

Nëse e studiojmë Kuranin madhështor, lehtë mund të kuptojmë se Muhamedi (a. s.) nuk krijoi një fe të re, por nxori në sipërfaqe fenë e harruar dhe të vërtetë të Ibrahimit (alejhis-selam), sepse feja është një dhe e vetme: ajo njeh dhe adhuron vetëm një Zot. Këtë fe e kanë predikuar të gjithë pejgamberët e mëparshëm, por popujt e tyre e kanë tjetërsuar dhe deformuar. Feja islame përmes Kuranit dhe Muhamedit (a. s.) vetëm e konfirmoi fenë e vërtetë dhe e pastroi atë nga të pavërtetat që ia veshën asaj gjatë viteve.

Feja është ajo që udhëzon drejt lumturisë së amshueshme, pa të cilën jeta e njeriut është pa qëllim dhe pa kuptim.

MUHAMEDI (A. S.), MODELI MË I PËRSOSUR

Feja që predikon Muhamedi (a. s.) mbështetet në dy gjëra kryesore: adhurimin e Zotit dhe shërbimin e njerëzisë. Prandaj, gjatë misionit të tij ai vendosi parime dhe rregulla në të gjitha fushat e jetës, të cilat do të jenë të vlefshme dhe të pazëvendësueshme derisa të ekzistojë kjo botë. Muhamedi (a. s.) është modeli më i përsosur për të gjithë njerëzimin - në fjalë dhe në vepra, në kohë lufte dhe në kohë paqeje. Ai i zbrërtheu dhe i zgjidhi problemet më të mëdha dhe më të ngatërruara gjatë historisë së njerëzimit.

Gjithnjë sipas mësimëve islame, paqja dhe lumturia mund të arrihen vetëm atëherë kur veset e këqija të njohin lirinë e ndërgjegjes, kur çdo popull dhe besim fetar do të fitojë lirinë dhe të drejtat e veta. Shoqëria njerëzore do ta arrijë lumturinë kur t'i nënshtrohet arsyes, logjikës, ndërgjegjes dhe jo prirjeve sentimentale. Muhamedi (alejhis-selam) i ka poseduar dhe kultivuar të gjitha virtytet, i ka qortuar dhe luftuar të gjitha veset e këqija, prandaj lindja dhe ardhja e tij është dita më e veçantë për të gjithë myslimanët.

Pavarësisht shkrimeve të shumta, jeta e mrekullueshme e tij ende nuk është analizuar në të gjitha segmentet. Çdokush që dëshiron që ta studiojë biografinë e tij, nuk mund që të mos magjepsset nga rezultatet e arritura.

Muhamedi (a. s.) nuk është monopol i kombit arab, por është prijësi i gjithë botës, për atë themi se shoqëria njerëzore do ta arrijë lumturinë kur t'i nënshtrohet arsyes, logjikës, ndërgjegjes dhe jo prirjeve sentimentale.

Këto parime të shenjta i ka vendosur dhe materializuar vula e të gjithë pejgambereve - Muhamedi (a. s.) dhe për atë ardhja e tij në këtë botë është dita më e veçantë për të gjithë njerëzimin.

Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi ty, o i Dërguar! Mirë se të solli Allahu i madhërishtëm!



MËNGJESI ISLAM...



Në historinë islame zë vend të rëndësishëm i ashtuquajturit 'vit i elefantit'. Në këtë vit lindi i dërguari i Allahut (xh. sh.), Muhamedi (alejhis-selam). Dy muaj para lindjes së tij, mëkëmbësi i Abisinisë në Jemen, që quhej Ebreha (i krishterë), dëshiroi që vizitorët të vizitojnë kishën e madhe që ai kishte ndërtuar në Sana (Jemen), e jo Qabënë në Mekë. Ebreha organizoi ushtrinë e tij me një numër të konsiderueshëm ushtarësh, me 13 elefantë të mëdhenj, me qëllim që ta rrëronte Qabënë. Në atë kohë Allahu fuqiplotë dërgoi një tufë shumë të madhe zogjsh dhe ai u mund.

Kjo ngjarje ndodhi pesëdhjetë e pesë ditë para lindjes së Muhamedit (s.a.v.s.), që i përgjigjet muajit shkurt të vitit 571 miladij (kalendari diellor), kurse Muhamedi (a. s.) lindi në mëngjesin e ditës së hënë, dita e dymbëdhjetë e muajit Rebiul evvel (muaji i tretë hënor), në vitin e ngjarjes së elefantit, që i përgjigjet 20 prillit të vitit 571 miladij (kalendari diellor).

Arabët në kohën paraislame i përdornin muajt e vitit hënor, por pa u bazuar në një kalendar të veçantë. Ata llogaritnin mbi bazë të ngjarjeve të veçanta: "viti i ndërtimit të Qabesë nga Ibrahim dhe Ismaili (alejhis-selam)"; "viti i elefantit"; "viti i rindërtimit të Qabesë" etj.

Pas ngritjes së shtetit islam në Medinë, viti hënor fillonte me Muharremin dhe mbaronte me Dhulhixhen, por pa ndonjë pikënisje (kronologji) për vitet. Kjo vijoi kështu nën udhëheqjen e Ebu Bekrit (r. a.), deri në vitin e tretë të kalifatit të Omerit (r. a.), i cili në vitin 17 të Hixhretit mblodhi sahabët më të shquar, që të konsultoheshin rreth çështjes së një kalendari të veçantë.

Aliu (r. a.) kishte propozuar që si erë e fillimit të llogaritjes së viteve në kalendarin mysliman të merret shpërngulja e Muhamedit (sal-Allahu alejhis ves-sel-lem) nga Meka në Medinë-Hixhreti. Kërkesës së kalifit Omer (r. a.), Aliu (r. a.) i është përgjigjur: "Hixhreti ndau të vërtetën nga e pavërteta dhe kontribuoi që Islami të shkëlqejë me një shkëlqim të plotë; le të jetë ky fillimi i llogaritjes së kohës." Kështu që 1 Muharrem i vitit të shpërnguljes së Muhamedit (a. s.) nga Meka në Medinë (16 korrik 622) u mor si fillimi i erës myslimane, duke qenë se ai kishte qenë muaji i parë edhe në kalendarin arab paraislam, po ashtu edhe muaji kur besimtarët ktheheshin nga kryerja e Haxhit.

Sipas Hixhretit, sivjet Nata e Mevludit bie më 28 tetor 2020, e mërkurë. (B.M)

HIPOKRITËT KANË ÇRREGULLIM MENDOR

Ata nuk janë njerëz të besuar as te myslimanët, as tek aleatët e tyre.

Shkruan: Prof. Jusuf Zimeri

13. “Dhe kur atyre u thuhet: Besoni sikurse besuan njerëzit! Ata thonë: “A të besojmë ashtu siç besuan mendjelehtët?” A nuk janë vërtet mu ata mendjelehtët?; Por, nuk e dinë.” (El Bekare: 13)

Kelbiju transmeton nga Salih, ky nga Ibn Abasi, se ky ajet ka zbritur për çifutët.¹ Ajeti kuranor na e bën me dije se kërkesa e Allahut (xh. sh.) dhe e besimtarëve islamë, që shkatërrimtarët të tërhiqen nga veprimtaria e tyre destruktive dhe të kthehen te besimi i pastër dhe i vërtetë. ishte në kontinuitet. Prandaj, Allahu (xh. sh.) thotë: Kur atyre (hipokritëve) u thuhet “Besoni sikurse besuan njerëzit”, ata këtë ftesë e ndienin sikur nënçmim, prandaj edhe thoshin: “A të besojmë ashtu siç besuan mendjelehtët?”

Me nocionin “Sufeha السفهاء” ata aludonin në njerëzit e varfër, edhe pse kjo shprehje në aspektin gjuhësor nënkupton çrregullimin mendor, mendjelehtësinë. Imam Sha’raviu thotë se ata me këtë shprehje aludonin në varfërinë, sepse ata që kishin besuar sipas tyre janë njerëzit e varfër, sepse paria dhe të pasurit e kurejshëve nuk kishin besuar. Sipas tyre, mendjelehtë janë ata që kanë besuar, mirëpo e vërteta është se sëmundja në zemrat e tyre nuk u lejon atyre ta shohin të vërtetën dhe kundërshtohen me vetveten e tyre. Kundërshtohen, sepse ata publikisht e shpalosin besimin - imanin dhe njëkohësisht ata që kishin besuar i konsideronin të marrë, e kjo i bie që ata ishin të marrë. Ky ajet është argument se hipokritët në të gjitha fjalët dhe veprimet e tyre ishin në kundërtësi të përhershme me veten e tyre, prandaj Allahu (xh. sh.) ata i quajti të marrë. Ata nuk e dinë të vërtetën se me veprimtarinë e tyre janë duke e dëmtuar veten e tyre, e kjo është cilësi e mendjelehtëve dhe e të marrëve.



ME CILËSI DJALLËZORE

14. “E kur i takojnë ata që besuan thonë: “Ne besojmë!” Por, kur veçohen me djajtë e tyre, u thonë: “Ne jemi me ju; ne vetëm jemi tallur.”

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti, sipas transmetimit të Ibn Abasit (r. a.), është Abdullah in Ubeje (udhëheqës i munafikëve) dhe shokët e tij. Këta një ditë ishin strehuar në një vend në Medinë dhe po bisedonin kundër myslimanëve. Kur më pas erdhën Ebu Bekri, Omeri dhe Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me ta), hipokritët u trembën prej tyre, por Abdullah ibn Ubeje u lavdërua para tyre, duke thënë: “Shikoni se si do t’i kthej mbrapsht ata të marrë, duke u tallur me ta.” U ngrit Abdullah ibn Ubeje, doli para sahabëve, e kapi për dore Ebu Bekrin (r. a.) dhe tha: Mirë se erdhe, o i pari i familjes Beni Adij! Ti je besniku dhe polaku i Islamit dhe myslimanëve; ti je i dyti në shpellë (e shoqërove Pejgamberin [Alejhis-selam] në shpellë); ti je ai që sakrifikove

veten dhe pasurinë për Pejgamberin [Alejhis-selam]! Pastaj e kapi për dore Omer in Hatabin (r. a.) dhe i tha: Mirë se erdhe, o zotëria i familjes Beni Adij dhe Ka’b. Dallues i së vërtetës nga e pavërteta dhe i forti i fesë së Allahut. Sakrifikues i vetes dhe i pasurisë për të dërguarin e Allahut! Pastaj u kthye nga Aliu, e kapi për dore dhe i tha: Mirë se erdhe, o djallë i xhaxhait të Pejgamberit [Alejhis-selam]; ti je i pari i fisit Beni Hashim pas Pejgamberit [Alejhis-selam]! Aliu (r. a.) menjëherë ia ktheu: Ki frikë Allahun, o Abdullah; mos bëj hipokrizi (munafikllëk), sepse hipokriti është krijesa më e ndyrë tek Allahu i madhërishtëm.

Abdullah ibn Ubeje pas kësaj fjale tha: “Ngadalë, o babai i Hasanit; unë këto fjalë nuk po i them me hipokrizi. Pasha Allahun, edhe imani ynë është si imani juaj, edhe besimi ynë është si besimi juaj. Pas kësaj u ndanë sahabët prej tij, e Abdullahu shkoi te shokët e tij dhe i pyeti: Hë, si e vlerësuar punën time me ta? Ata e lavdëruan Abdullahun.²

Sahabët u kthyen te Pejgamberi [Alejhis-selam], i treguan për rastin që kishte ndodhur dhe në këtë rast kishte zbritur ajeti i lartpërmendur.³

Ajeti na tregon se kur hipokritët takoheshin me besimtarët islamë, e shpalosnin besimin e tyre dhe shtireshin si besimtarë të mirë, të denjë e të sinqertë, por kjo në realitet ishte hipokrizia e tyre, sepse ata kur takoheshin me kërret e tyre, me parinë e tyre, për të cilët Ibn Abasi thotë se janë pabesimtarët, e që Kurani kerim i llogarit me “djajtë”, thoshin: “Ne jemi me ju, nuk jemi me besimtarët; me ta vetëm se po tallemi.”

Shprehja - شَيَاطِينُهُمْ —“shejatinihim djajtë e tyre” është shumësi i shprehjes “shejtan”, që rrjedh nga folja “shetane”, e që do të thotë: largim nga e vërteta. Kurse nocioni “shejtan” në aspektin terminologjik nënkupton: rebelim, kryeneçësi, pavarësisht se është nga xhindet, nga njerëzit apo kafshët.⁴

Ibni Xheriri shpjegon se nocioni “shejatinihim” nënkupton çdo gjë të rebeluar, prandaj shejtanët - djajtë janë nga xhindet dhe nga njerëzit, ashtu siç thotë edhe Kurani fisnik:

وَكذلك جعلنا لكل نبي عدوا شياطين الإنس والجن يُوحى بعضهم إلى بعض زخرف القول غرورا

“Dhe kështu, si për ty ashtu edhe për çdo profet, Na kemi krijuar armiq djajtë e njerëzve dhe të xhindeve, të cilët i flasin njëri-tjetrit fjalë të zbukuruar për t’i mashtruar.”⁵

Në hadithin e transmetuar nga Ebu Dhherri thuhet: I dërguari i Allahut [Sallallahu alejhi ve sel-leme] ka thënë: “Kërkoje mbrojtjen e Allahut nga djajtë që janë prej njerëzve dhe prej xhindeve. Unë i thashë: O i dërguar i Allahut, a ka djaj (shejtanë) edhe nga njerëzit? Tha: “Po.”⁶

Nocioni “Istihza’ë” është tallje me tjetrin, ironizim ndaj tjetrit, të çnderosh tjetrin, të luash me të, e ky veprim është i palejuar dhe konsiderohet mëkat sipas Islamit.

Është mjaft interesant interpretimi i Imam Sha’ravit, kur e shpjegon këtë ajet, i cili thotë: Përmes këtij ajeti Allahu (xh. sh.) na shpjegon se hipokritët –munafikët kanë më shumë se një jetë, më shumë se një natyrshmëri që dëshirojnë të jetojnë. Mirëpo, e vërteta është se njeriu për të qenë i përqendruar, stabil, detyrimisht duhet të jetojë vetëm një jetë, një natyrshmëri. Hipokritët kur janë në mesin e myslimanëve, tentojnë të jetojnë një jetë,

një natyrshmëri të besimit, e ata në këtë rast nuk e paraqesin veten e tyre, ata në këtë rast e kanë rolin e artistit kur luan rolin e ndonjë figure apo personaliteti tjetër. Në anën tjetër, kur janë me pabesimtarët jetojnë me natyrshmërinë, apo me jetën e kufirit, dhe këtu vërehet se jeta e tyre është plot kundërtësi.⁷ Në realitet, hipokritët nuk janë njerëz të besuar as te myslimanët, as tek aleatët e tyre.

15 “Allahu tallet me ta; Ai do t’i lë një kohë të gjatë që të bredhin andej-këndeje në mohimin e tyre.”

Përmes këtij ajeti kuranor Allahu (xh. sh.) i përforcon besimtarët islamë se Ai do të jetë në ndihmën e tyre, e në anën tjetër i kërcënon hipokritët me dënim të ashpër.

Hipokritët janë një popull që nuk kanë fuqinë që të tallen me dikë. Ai që ka forcën dhe pushtetin është Allahu (xh. sh.), i cili kur do të tallet me ta, tallja e Tij do të jetë e dhimbshme. Përdërisa hipokriti me gjuhët e tyre ekspozojnë atë që nuk e mbajnë në zemër, atëherë edhe trajtimi i Allahut ndaj tyre do të jetë varësisht nga veprimtaria e tyre. Përdërisa ata sipërfaqësisht paraqesin e imanin - besimin, Allahu në jetën e kësaj bote ndaj tyre do të ketë trajtim sikur të myslimanëve, por botën tjetër, ditën kur dalin në shesh të fshehtat, ata do të jenë në fund të zjarrit të xhehenemit, edhe më të zhytur se pabesimtarët, sepse këta janë më të rrezikshëm.⁸

ALLAHU TALLET ME TA

Ibni Abasi (r. a.) thotë: “Allahu tallet me ta.” Ditën e Gjykimit hipokritëve që talleshin me fenë e Allahut dhe me myslimanët, Allahu (xh. sh.) do t’ua hapë një derë të xhenetit. Kur të afrohen për të hyrë brenda, ajo mbyllet dhe sërish kthehen në xhehenem. Thuhet: Allahu (xh. sh.) për besimtarët do të ndez një dritë (nur) në momentin kur kalojnë mbi Urën e Siratit. E, kur të arrijnë hipokritët, Allahu do të ndërhyjë mes tyre dhe myslimanëve, ashtu siç thotë Allahu (xh. sh.).

وَحِيلَ بَيْنَهُمْ وَبَيْنَ مَا يَشْتَهُونَ

“Dhe ndërhyhet (ndërhyn Allahu) ndërmjet tyre dhe ndërmjet asaj që dëshirojnë ata.”⁹

Nocioni “Istihza” - tallje, ironizim - në kuptimin e tij të vërtetë nuk mund t’i atribuohet Allahut fuqiptotë, porse në këtë rast vjen në kuptimin e ndëshkimit dhe të dënimit. Allahu (xh. sh.) e përdori këtë shprehje për t’i përshkruar ata se si kanë vepruar.

Nocioni “tug’jan طغيان” e ka kuptimin e teprimit, të tejkalimit të normës, të tejkalimit të kufirit. Prandaj, Allahu (xh. sh.) do t’i ndëshkojë ata, për shkak se e kanë tepruar dhe i kanë tejkaluar të gjithë kufijtë në mohimin e tyre.

16. “Ata janë prej atyre që kanë blerë (zgjedhur) rrugën e gabuar, në vend të së vërtetës. Tregtia atyre nuk u sollli kurrfarë dobie, dhe as nuk janë orientuar në rrugë të drejtë.”

Allahu (xh. sh.) e sqaron realitetin e atyre që u cilësuan me tiparet e hipokrizisë, se ata janë në rrugë të gabuar, nuk do të përfitojnë asgjë as në jetën e kësaj bote e as në jetën e botës tjetër. Ata kanë hyrë në një tregti falimentuese që nga fillimi.

Allahu (xh. sh.) përmes këtij ajeti na sqaron edhe për një cilësi tjetër, që plotëson mozaikun e hipokrizisë së tyre. Ajo është tregtia që ata kanë blerë lajthitjen, humbjen – dalaletin, me kundërvlerë të pagesës, që është udhëzimi – hidajeti.

Imam Sha’ravi shpjegon se këtu bëhet fjalë për shitblerje, e përdërisa kemi shitblerje, atëherë kemi këmbim të dy sendeve. Mirëpo, cili ishte çmimi me të cilin hipokritët blenë lajthitjen e tyre? Pasuria me të cilën munafikët paguan çmimin e blerjes së lajthitjes ishte hidajeti, që është natyrshmëri e krijimit të njeriut apo liria e zgjedhjes për përcaktim mes dy sendeve.¹⁰

Më tej kjo do të thotë: Munafikët janë nga ata të marrë, të cilët kanë shpërdorur kapitalin e jetës së vet. Në vend që të blinin udhëzimin për në rrugën e drejtë, ata kanë blerë humbjen.¹¹


Pjesa e ajetit “Tregtia atyre nuk u sollli kurrfarë dobie” është dëshmi se tregtia e tyre është në humbje, sepse ata po ecin drejt zjarrit të xhehenemit, e kjo humbje është më e tmerrshme se humbja e pasurisë në tregtinë e kësaj bote. Në përmbyllje të shpjegimit të këtij ajeti Imam Sha’ravi thotë: “Personaliteti i hipokritit, nëse tenton ta përkufizosh është: Ai është njeri pa dinjitet, pa burrëri, i dobët dhe i paguximshëm; bën përpjekje të bëjë komplete fshehtazi; ai e urren edhe veten e tij, bile edhe nëse arrin të fshehë të metat e tij para njerëzve. Mjafton të thuhet që ai është gënjeshtar para vetes së tij.”¹²

(Vazhdon)

¹ Tefsirul Kurtubij, 1/199
² Muhamed Alij Taha Ed-Durre, Tefsirul Kur’ani kerim ve l’rabuhu ve bejanuhu, 1/38
³ Dalliu, Hafiz Ibrahim, Ajka e kuptimit të Kur’ani kerijmit, fq. 47-48.
⁴ El-Esfehani, el Mufredat, fq. 261. Alusi, Ruhul Meani, 1/157.
⁵ Suretu El En’am: 112
⁶ Musnedi i Ahmedit
⁷ Tefsiru Esh’aravi, 1/159
⁸ Tefsiru Esh’aravi, 1/161
⁹ Suretu Es-Sebe: 54
¹⁰ Tefsiru Sha’ravi, 1/163
¹¹ H. Dalliu, Ibrahim, Ajka e kuptimeve të Kur’ani kerijmit, fq. 49.
¹² Tefsiru Esh’aravi, 1/164.

MURTAJA, KARANTINAT DHE GJEOPOLITIKA NË PERANDORINË OSMANE

Shumë vëzhgues - osmanë dhe perëndimorë - pohuan se deri në vitin 1840 plaga ishte zhdukur përgjithmonë nga Perandoria. A ishin osmanët dhe evropianët perëndimorë, veçanërisht interesat e fuqishme detare dhe tregtarët britanikë, të unifikuar në mbështetjen e tyre për karantinën? Vërehen një numër traktatesh mjekësore osmane në favor të kësaj mase dhe një numër shkrimtarësh angloamerikanë që nuk ishin.



Nga Birsën Bulmus

Shumë nga shtetarët më të mëdhenj osmanë dhe figura letrare nga shekulli XV dhe deri në fillim të shekullit XX e konsideruan murtajen si një kërcënim të rëndësishëm për perandorinë e tyre.

Shumë osmanë duartrokitën vendosjen e një karantine kundër sëmundjes në

vitin 1838, si një mjet për t'i rezistuar gjithashtu depërtimit politik dhe tregtar britanik dhe francez.

Apo, përpjekja e mëvonshme sanitare osmane për të parandaluar shpërthimet urbane të murtajes do të ndihmonte në ngjalljen e revoltës arabe kundër Perandorisë në vitin 1916?

Debatet fetare mbi murtajen dhe masat e ndërmarrja kundër saj kishin një

rëndësi të madhe në Perandorinë Osmane deri në reformat e karantinës të vitit 1838. Osman bin Süleyman Penah vdiq në vitin 1817; ai ishte një zyrtar i njohur mjekësor gjatë sundimit të Selimit III (1789-1807) dhe një kundërshtar i karantinës. Ai e kuptoi se mënyra më e mirë për të parandaluar reformën ishte prishja e legjitimitetit të saj fetar. Osmanët, shteti kryesor islam nga pushtimi i tyre i Mekës në vitin

1517 deri në shpërbërjen e Perandorisë në vitin 1923, ishin të prekshëm nga kritika se murtaja ishte një bekim nga Zoti, ndaj të cilit të gjithë myslimanët duhet të japin dorëheqjen e tyre nga sëmundja. Selimi III u rrëzua brenda tre vjetëve nga pamfliet i Osmanit për këtë temë; dhe rebelët fituan me sukses legjitimitetin popullor duke akuzuar sundimtarin për braktisjen e besimit të tij dhe duke ndjekur modernizimin e reformave. Megjithatë, argumenti dogmatik i Osmanit që çdo masë paraprake ndaj murtajes dhe sëmundjeve të tjera epidemike ishte një tradhti e besimit të myslimanëve në fatin e Zotit.

Shumica e autorëve e kundërshtuan këtë pozicion fatalist duke vërejtur se marrja e masave paraprake përmbush detyrimin e Zotit ndaj njerëzve për të ndërmarrë nismat në trajtimin e gjykimeve për sa i përket murtajes. Mbrojtësit e parë të tillë të veprimtimit individual në letërsinë osmane mbi murtajen ishte Risdris-i Bitlisi, një burrë shteti osman i shekullit XVI, dhe Isamedin Ahmed bin Mustafa, një njeri i spikatur i mesit të shekullit XV.

Gjykatësit dhe studiuesit osmanë u përqendruan më shumë në reagimet individuale ndaj murtajes; domethënë, në formën e kërkimit të trajtimit mjekësor ose përpjekjes për të gjetur një zonë të infektuar nga murtaja.

Karantinat do të shtynin masa më të gjera të politikës së shëndetit publik, siç është përcaktimi i murtajes si një sëmundje infektive materiale dhe duke propozuar që osmanët të zbatonin një karantinë për të mbrojtur subjektet e tyre. Debati nëse ligji islam sanksionoi masat materiale kundër murtajes vazhdoi derisa karantina u zbatua në vitin 1838. Përkrahësit e masave proaktive ishin në gjendje të krijonin një argument të mjaftueshëm për zbatimin e karantinës nga Hamdan në vitin 1838. Hamdan dhe avokatët e mëparshëm të masave proaktive ishin në gjendje të lundrojnë në burimet juridike islame, përkatësisht Kuranin, librin e shenjtë të Islamit, thëniet e pejgamberit Muhamed (hadithet) dhe përvojat e hershme të komunitetit mysliman për të justifikuar reformën. Kjo prirje drejt reformës nuk ishte unike për një kontekst islam osman dhe u krahasua, madje, edhe me shtetet shumë të zhvilluar të Evropës Perëndimore, siç është Anglia. Edhe këtu, dogmatistët fetarë, kësaj here të krishterët protestantë, kundërshtuan reformat mjekësore si karantinën, dhe mohuan që Zoti sanksionoi përpjekjet individuale dhe shtetërore për të kapërcyer sëmundjen epidemike.

Ndërsa studiuesit osmanë më së shpeshti ndërtuan diskutimin e tyre mbi plagën rreth pyetjes se si duhet t'u përgjigjen njerëzit vuajtjeve të shkaktuara nga sëmundja nëse Zoti përcakton gjithçka? Një përgjigje e tillë, e parë nga ana e dogmatikut Osman, ishte se gjithëfuqia e Zotit nuk lejon të gjitha veprimet individuale.

KONCEPTUALIZIMI I MURTAJES NË MENDIMIN ISLAM

Reforma në karantinën osmane të vitit 1838 ishte vërtet një pikë kthese në historinë e sëmundjes epidemike të Perandorisë. Sulltan Mahmudi II adoptoi karantinën nga këshilltarët dhe mjekët e Evropës Perëndimore; siç shihet nga rekomandimet e paraqitura për sundimtarin osman në lidhje me zbatimin e institucionit, dy vjet më parë vinin nga mjeku austriak Anton Lago. Rivali egjiptian Muhamed Ali kishte nisur karantinën e tij nën drejtimin e zyrtarëve të huaj rreth shtatë vjet më parë. Paraardhësi i Mahmudit II, Sulltan Selimi III, ishte përpjekur ta bënte këtë në vitin 1806. Shumë vëzhgues - osmanë dhe perëndimorë - pohuan se deri në vitin 1840 plaga ishte zhdukur përgjithmonë nga Perandoria.

A ishin osmanët dhe evropianët perëndimorë, veçanërisht interesat e fuqishme detare dhe tregtarët britanikë, të unifikuar në mbështetjen e tyre për karantinën? Vërehen një numër traktatesh mjekësore osmane në favor të kësaj mase dhe një numër shkrimtarësh angloamerikanë që nuk ishin. Saktësisht për këtë mospërputhje dhe si e bënë realitetin gjeopolitik të kohës, përkatësisht nxitjen osmane për reformë dhe dëshirën e njëkohshme britanike për zgjerim tregtar dhe kolonial, e pasqyruan këtë tension në mes britanikëve dhe osmanëve? A mund të krahasohet karakterizimi i kritikëve angloamerikanë për karantinën si një institucion disiplinor shoqëror dhe etnikisht përçues me realitetet osmane? Së pari, ishin perëndimorët ose osmanët dhe reformatoret e tjerë myslimanë kryesisht përgjegjës për autorizimin dhe / ose implementimin e karantinës.

Megjithëse udhëheqësit fetarë osmanë dhe evropianë shpesh sanksionuan veprimin kundër sëmundjeve të epidemisë nga shekulli XVI e tutje, evropianët pa dyshim miratuan karantinën shumë kohë para osmanëve. Shkrimtarët e Rilindjes nga Boccaccio në Fracastoro shkruante për natyrën ngjitëse të murtajes, dhe një numër i qyteteve shteteve italiane krijuan karantina qysh në shekullin XV për të izoluar ata të sëmurë nga murtaja. Shtetet e tjera evropiane

veçanërisht fuqitë detare si Anglia dhe Franca - miratuan institucionin gjatë shekujve XVI-XVIII.

“Murtaja e Madhe” në Londër e vitit 1665 dhe shpërthimi në Marsejë në vitin 1720, bindën shumë skeptikë se nevoja për të zbatuar më rreptësisht masat e izolimit në mënyrë ishte që të mbronin njerëzit nga ekspozimi ndaj sëmundjeve vdekjeprurëse nga jashtë. Edhe bashkësitë tregtare të mërgimtarëve nga këto vende kërkuan të shmangnin murtajen në qytetet osmane të Kajros, Smyrna dhe të Stambollit duke zbatuar në heshtje karantinat e tyre atje. Megjithatë, ndryshimet midis osmanëve dhe fuqive detare evropiane ishin shumë më delikate. Osmanët dhe autorët e tjerë të traktateve të murtajes në Lindjen e Mesme nga viti 1347 deri në 1600 nuk ndryshonin rëndësisht nga homologët e tyre evropianë perëndimorë.

Të dy si evropianët dhe myslimanët shpesh e kuptuan murtajen në terma ngjitëse dhe i qarkulluan veprat e tyre në qarqe të ngushta miqësore ose akademike. Në fakt, studiuesit evropianë dhe myslimanë shpesh do të bashkëveprojnë në një mënyrë që e bënë të vështirë dallimin midis dy ‘civilizimeve’, pasi ata huanzuan lirshëm koncepte, përvoja dhe modele krahasuese nga njëri-tjetri.

HENDEKU MIDIS PERCEPTIMEVE EVROPIANE DHE OSMANE NDAJ MURTAJES

Mes viteve 1600 dhe 1800, me ngritjen e merkantilizmit dhe zhvillimit tregtar jashtë shteteve të Evropës veriperëndimore, reformat institucionale si karantina erdhën si rezultat i një programi shtetëror të zhvillimit ekonomik dhe ndryshimit rrenjësor shoqëror, duke filluar me shtetet detare si Anglia. Shkrimtarët e traktateve të murtajes angleze në veçanti morën pjesë në këtë sistem në zhvillim. Autorët e traktateve të murtajes ishin dëshmitarë të ndryshimeve thelbësore në kontekstin e tyre shoqëror me përmbajtje ideologjike - në vlerat ekonomike merkantiliste të veprave të tyre. Me pak fjalë, ata do të bëhen kontribues të rinj të gatshëm në një agjendë ekonomike kombëtare që do të justifikonte reformën merkantiliste në emër të shëndetit publik. Mirëpo, osmanët nuk iu përgjigjën drejtpërdrejt zhvillimit të idesë më të re evropiane të karantinës dhe ligjërimit merkantilist, deri pas vitit 1800, kur shkrimtarët e traktateve të murtajes si Hamdan filluan të thërrisnin për reforma. Qeveria osmane, thjesht, nuk zbatoi një program modernizues të udhëhequr nga

shteti, aq më pak një karantinë. Kishte relativisht më pak shkrimtarë të traktateve të murtajës osmane të shekullit XVII dhe XVIII, sesa në shekullin XVI, megjithëse edhe ata mbetën të kufizuar në qarqet miqësore dhe akademike. Kështu, ndryshe nga kolegët e tyre anglezë, ata nuk morën pjesë në kulturën e shtypur ose nuk reflektuan interesa të reja tregtare. Sidoqoftë, dallimet e tyre me shkrimtarët e traktateve të murtajës merkantiliste ishin më ekonomike sesa kulturore, pasi ata, ashtu si paraardhësit e tyre të shekullit XVI, mbetën pritur ndaj ideve dhe inovacioneve të reja.

Osmanët kishin një angazhim të vazhdueshëm ndaj masave proaktive të drejtuara në mbrojtjen e shëndetit dhe kishin të paktën një ligjërim të kufizuar me botën e jashtme. Sidoqoftë, suksesi i merkantilistit evropian përfundimisht do t'u bënte presion osmanëve, duke i ekspozuar ata në kërcënime të reja tregtare dhe ushtarake. Ekonomikisht, fuqitë e reja merkantiliste, veçanërisht Anglia, do të prishnin ekonominë osmane dhe madje do të kërcënonin sovranitetin e saj në emër të shëndetit publik modern, evropian perëndimor. Politikisht, ky kërcënim ideologjik do të çonte në kërkesa në rritje për ndarjen dhe kolonizimin e Perandorisë.

Një aspekt tjetër kyç për të kuptuar nocionet osmane të murtajës është që shkrimtarët e traktateve deri në reformën e Hamdanit në vitin 1838, shpesh referoheshin në njohuri magjike në një larmi formash për të thirrur ose kanalizuar mbinatyroren, ose forca të padukshme për logjikën njerëzore, për të

lehtësuar vuajtjet njerëzore ose për të shmangur vdekjen. Sigurisht, shkrimtarët gjatë shekujve XVI dhe në fillim të XVII, si Bitlisi dhe Taşk, cituan formulat e veshura me kohë të Ahmed al-Bunit (vd. 1225) dhe besimtarëve të tjerë në përdorimin ritual të vargjeve, fjalëve, shkronjave për të siguruar ndërhyrjen

FAKTE NË NJË STUDIM TËRHEQËS

Autorja Birsen Bulmus (Birsen Bulmuş) në botimin e saj "Murtaja, karantinat dhe geopolitika në Perandorinë Osmane", botuar nga Edinburg University Press në vitin 2012, i eksploron këto fakte në një studim tërheqës të shkrimtarëve të traktateve të murtajës osmane gjatë gjithë luftës së tyre gati 600-vjeçare me këtë sëmundje epidemike. Gjatë rrugës, ajo adreson pasojat politike, ekonomike dhe sociale të metodave që ata përdorën për ta luftuar atë.

hyjnore për të shpëtuar popullatën nga sëmundja.

Besimi i Hamdanit se ndërkombëtarizimi i karantinës osmane në 1838 sinjalizoi kapitullim për britanikët ishte i pabazuar. Nga fillimi i tij, interesa të ndryshme u përplasën në Këshillin e Lartë të Shëndetit të Stambollit. Mjekët austriakë mund të kenë drejtuar Këshillin e Shëndetit të Lartë të Stambollit për një kohë të shkurtër, por ai u drejtua shpejt edhe një herë nga një president osman, stafi administrativ i të cilit ishte shpesh në konflikt me anëtarët e huaj të Këshillit. Muhamed Ali (1769–1849), i cili filloi një proces të modernizimit të reformës në Egjipt, në përpjekje për të marrë përsipër Perandorinë, vendosi një karantinë të veçantë në Aleksandri dhe publikun tjetër.

ADMINISTRATA SANITARE

Osmanët kishin përqaftuar plotësisht një vizion të ri të murtajës dhe karantinave në vazhden e konferencave sanitare ndërkombëtare të vitit 1894 dhe 1897. Ky vizion i sëmundjes pranoi me të vërtetë zbulimin e Alexander Yersinit të vitit 1894 të bacileve të murtajës në Hong Kong, si të vlefshme për të justifikuar masat higjienike që kërkuan të eliminojnë shkakun përfundimtar të sëmundjes: kushtet e ndyra të jetesës dhe jositare të shoqërive 'të pamodifikuara' ishin shkaqet e sëmundjes. E vetmja mënyrë se si sëmundja në fjalë mund të eliminohej ishte përmes veprimeve rutinë. Kjo nënkuptonte krijimin e një administrate sanitare që do të krijonte spitale për të trajtuar të sëmurët përmes vaksinimeve dhe trajtimeve të tjera moderne. Ky libër argumenton se Hamdan Bin El-Merhum Osman Hoxha, ishte me të vërtetë një figurë thelbësore në historinë e murtajës në Perandorinë Osmane, pasi vizioni i tij i karantinës si një instrument i sovranitetit kombëtar kishte ndikimin më të qëndrueshëm politik në reformat mjekësore osmane rreth epidemisë së sëmundjes.

Para kohës së tij, osmanët kishin një pamje thelbësore paramoderne ndaj murtajës dhe sëmundjeve të tjera epidemike. Megjithëse osmanët tradicionalisht e konceptuan murtajën dhe shëndetin në mënyra që nuk binin në kundërshtim me besimin e tyre islam, ata reagues ndaj "Vdekjes së Zezë" dhe shpërthimeve të mëvonshme të murtajës plotësisht në të njëjtën mënyrë.

(E solla në shqip: Selim Ibrahim; enkas për HeR, nga SHBA)



PANDEMIA SI SHKAS PËR NDËRGJEGJËSIMIN E BESIMTARIT

"Allahu ka kontroll dhe fuqi të plotë mbi çështjet e Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Jusuf, 21)

Shkruan: Mr. Beqir Memeti

Sëmundjet gjatë gjithë historisë kanë qenë shoqëruese të jetës dhe të fateve njerëzore. Ato kanë qenë me pasoja - nga me të lehtat, deri tek më të tmerrshmet - mirëpo çdoherë kanë qenë kalimtare, ashtu siç është jeta jonë në këtë botë. Nga çdonjëri prej nesh kërkohet që t'i respektojmë udhëzimet shëndetësore, të bëhemi qytetarë të përgjegjshëm dhe shembull i mirë për të tjerët. Pa dyshim se në kohën e sotme, kur dinamizmi i jetës është i shpejtë dhe informimi është masiv, beteja me pandeminë Covid-19, dhe çfarëdo sprove tjetër, është më e vështirë sidomos në aspektin psikologjik.

Natyrë e njeriut është imune ndaj çdo sëmundje falë të madhit Zot; njeriu e shfrytëzon mendjen, di, kupton, kujdeset, mjekohet dhe, në fund, me ndihmën e Zotit, del fitimtar.

Jetojmë në një kohë kur shumë pak njerëz arrijnë që ta përcjellin të vërtetën përgjatë gjithë jetës. Shumë pak njerëz kanë mundur që ta ruajnë karakterin, moralin dhe dinjitetin para sfidave dhe sprovave të jetës. Pikërisht këta pak njerëz janë të vendosur që jetën e tyre ta kalojnë në pajtim me vlerat dhe vlerat që kërkohen nga Zoti, ata janë që e ruajnë ekuilibrin e shoqërisë së shëndoshë.

SPROVË E MADHE

Sot të gjithë jemi dëshmitarë të një sprove të madhe që e ka shtrënguar gjithë njerëzimin, duke i ndërprerë përditshmërinë, veprimtarinë ekonomike dhe prodhuese, duke kufizuar dhe ndërprerë punën e shumë institucioneve, duke e privuar nga argëtimi dhe rekreacioni. Të gj-



tha këto kufizime dhe ndalesa janë masa parandaluese për të shpëtuar me sa më pak pasoja.

Në pjesën më të madhe të botës janë mbyllur edhe vendet e adhurimit të besimeve të ndryshme: xhamitë, kishat, manastiret dhe sinagogat. Në botën myslimane është mbyllur shtëpia e parë e ndërtuar për adhurimin e Zotit, Qabeja, xhamia të cilën e ndërtoi, ku u fal dhe ligjëroi vetë Muhamedi (alejhis-selam) në Medinë, xhamia e Israsë dhe e Miraxhit-Mesxhidul Aksa në Kuds.

Xhamitë janë mbyllur edhe në vendin tonë, ndoshta për herë të parë pas 600 viteve. Besimtarët çdo ditë luten dhe shpresojnë që t'ju rikthehen atyre, me respekt të shtuar, pasi asnjëherë si këto ditë

vlera e xhamisë dhe e xhamatit nuk është kuptuar më mirë.

Është mbyllur medreseja "Isa Beu", simboli i edukimit, i dijes dhe vatra më e vjetër në Ballkan, pa të cilën nuk mund të mendohet organizimi i jetës fetare islame, pasi prej saj dalin nëpunës fetar të edukuar, të arsimuar dhe të aftë për detyrat që do t'u besohen.

Është mbyllur edhe Fakulteti i Shkencave Islame, një institucion arsimor dhe shkencor me vlerë të veçantë për myslimanët e këtyre trevave, sukseset e të cilit janë meritë e angazhimit të gjithanshëm të mësimdhënësve dhe e mbështetjes nga Rijaseti i BFI-së dhe vetë Reis'ul-Ulemaja, si njeriu i parë i saj.

Në gjithë këtë dramë njerëzore, e kri-

juar nga derma që na ka pllakosur, pa dyshim se ka urtësi dhe mirësi, të cilat njerëzit janë të paaftë e të pafuqishëm që t'i shohin dhe, për rrjedhojë, edhe mund t'i urrejnë. Këtë e dëshmon ajeti kuranor:

“...Por, mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është dëm për ju. Allahu e di, e ju nuk e dini.” (Bekare: 216)

TË BËJMË ATË QË DUHET

Prandaj, është koha që ta ushqejmë shpirtin dhe zemrën, të shpërndajmë shpresë e përgëzime dhe jo frikë e shqetësim. Në të sotmen ku duket sikur është ndalur koha, ku dinamizmi i jetës ka pushuar, duhet ta analizojmë të kaluarën dhe duhet menduar si ta ndërtojmë të ardhmen. Të forcojmë bindjen se fuqia dhe pushteti janë vetëm të Zotit, Ai i sprovon njerëzit duke ua pakësuar dhe shtuar atë. Të jemi të vetëdijshëm se nuk ka asnjë pasuri që mund të paguajë shëndetin dhe mirësitë e Zotit, se nuk ka kufizim dhe sprovë që mund ta zbeh besimin e njerëzve në Zotin e Madhërishtëm dhe se gjithë kjo do të kalojë vetëm me ndihmën e Zotit Mëshirues.

Të bëjmë atë që duhet, dhe jo atë që duam, ta shfletojmë të kaluarën tonë, të shohim gabimet tona dhe të kërkojmë falje nga Zoti për të gjitha lëshimet gjatë jetës sonë. T'i përkushtohemi ushqimit shpirtëror, t'i rikthehemi traditës së gjyshërve e stërgjyshërve tanë, të cilët shëndetin dhe kohën e lirë e kanë shfrytëzuar duke ndihmuar familjen, duke u kujdesur për nevojat e përditshme dhe duke mos e ngarkuar veten e tyre me gjëra që nuk u interesojnë dhe që janë të padobishme. Vetëm kë-shtu, do të kemi më pak preokupime të panevojshme, më shumë ngrohtësi familjare dhe më tepër kontribut dhe angazhim shoqëror.

Çështja që i preokupon ndoshta të gjithë njerëzit e botës është: çka do të ndodhë pasi të kalojë kriza shëndetësore si pasojë e Covid-19? Pa dyshim se kjo çështje i preokupon edhe besimtarët myslimanë, të cilët duke analizuar me kujdes të kaluarën e tyre, duhet të mendojnë se si t'i vazhdojnë, si t'i plotësojnë e t'i përsosin punët e mira dhe të mos i përsëritin gabimet në jetët e tyre; t'i forcojnë lidhjet me Zotin e tyre, t'i përmirësojnë marrëdhëniet me njerëzit tjerë dhe të shtojnë kujdesin ndaj ambientit.

Dua bëjmë edhe për besimtarët e nënqiellit tonë, që me ndihmën e Zotit ta kalojnë me sa më pak pasoja këtë derexhe, në veçanti për nëpunësit fetarë si: udhëheqjen e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedoninë së Veriut, në krye me Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, myftilërit, imamët etj., të cilët përmes angazhimit të vazhdueshëm kontribuojnë në menaxhimin sa më të lehtë dhe të suksesshëm të jetës fetare në këto rrethana të vështira.

Kurrë mos t'i harrojmë fjalët e Kuranit fisnik: “Punoni, se Allahu, i dërguari i Tij dhe besimtarët do t'i shohin punët tuaja.” (Teube: 105)



AKTUALJA QË RRETHOI KATËR ANËT E BOTËS...



Nga Prof. Jasemin Shabani

Aktualja që rrethoi katër anët e botës, që erdhi në heshtje dhe vazhdon t'i zgjerohet kufijtë, duke shtuar njëkohësisht edhe volumin e presencës, na është bërë dert mbi kokë.

Shtrohen shumë informata...

Flasin shumë gjuhë...

Jepen rekomandime...

Kërkohen dhe shumë rrugë të tjera me qëllim që të shmanget, apo të zhbëhet, problemi.

“Veproni, se Allahu do ta shohë veprën tuaj ...” (Kuran, Teube: 105)

Vepruan mjekët me dijen që kanë për të mbyllur rrugët e sëmundjes. Vepron e gjithë shoqëria për të mbyllur shtigjet e kësaj sprove.

Pyes: Ku po gabohet, që sprova sa vjen e rritet, ndërkohë që kemi menduar se jetojmë në një shekull ku jemi dukshëm të avancuar në njohuritë shkencore të mjekësisë?! Një virus i panjohur sikur i rrëzoi të gjitha. Thua të jemi larguar nga ajo që na mësoni i dërguari i Allahut (salallahu alejhi ve selem) dhe sahabët se si duhet të lahen duart?

Ku ikën shekujt mes të dërguarit të Allahut dhe kohës sonë? Kësaj situatë i mungon një element kyç, pa të cilin nuk ndihmon asgjë. Mungon thënia: “Dhe Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata nëse ata, ndërkohë, kërkojnë falje (istigfar).” (Enfal: 33)

Një element si ky çan çdo rrugë pa dalje.

Një element si ky eliminon çdo pengesë.

Një element si ky rrugëton mbi shtatë kat qiej, përlulur, duke bartur me vete edhe dëshminë e vogëlsisë sonë e njëkohësisht duke pohuar Madhësitinë e Krijuesit tonë.

Këshilloj veten dhe njëkohësisht lexuesit të shtojmë istigfarin - kërkimin e faljes e ndoshta Allahu do ta mëshirojë këtë popull dhe do t'ia kthejë sigurinë e cila tashmë është dukshëm duke i munguar.

لا إله إلا أنت سبحانك إني كنت من الظالمين

<<la ilahe il-la ente subhaneke inni kuntu minedh-dhalimin>>

“S’ka zot tjetër (që meriton adhurimin), përveç Teje. I madhëruar dhe pa të meta je Ti (Allah), ndërsa unë isha prej të padrejtëve.”



KORONA - SËMUNDJE QË E SPROVON NJERIUN MODERN



Është koncept sociologjik islam se rënia dhe dënimet janë rezultat i rënies së njerëzores te njeriu. “A nuk e shohin ata se për çdo vit sprovohen një herë apo dy herë, e përsëri nuk marrin mësim.” (Et Teubeh: 125)



Shkruan: Shaqir Fetahu

Njerëzimi sot po ballafaqohet me sëmundjen që po trishton tërë globin. Ka depërtuar në zemrat e të gjitha gjeneratave, shtresave intelektuale, niveleve të ndryshme ekonomike, institucioneve të niveleve të larta dhe të ulëta, pasanikëve e të varfërve - të shëndoshë e të sëmurë, pleq e të rinj, fetarë e afetarë etj. Me qëllim të ballafaqimit me këtë kundërshtar të jetës njerëzore, bota ka filluar t'i qaset nga të gjitha aspektet, me qëllim të zbutjes dhe tejkalimit të këtij rreziku momentalisht të madh. Kjo ka filluar t'i marrë edhe viktimat e saj, që janë me përmasa të mëdha.

Me seriozitetin më të madh po i qasen qendrat e ndryshme hulumtuese, zbuluese, gjurmuese në të gjitha sferat

shkencore dhe humane, në të gjitha vendet e botës, që brenda aftësive dhe mundësive të veta, të gjejnë zgjidhjen e këtij rreziku të madh botëror. Institutet e sferave të ndryshme psikologjike, sociale, filozofike, fetare, e në veçanti ato shëndetësore, mundohen të japin zgjidhjet e para dhe definimin e kësaj sëmundje të rëndë, për të analizuar shkaqet e paraqitjes, historikun, fuqinë, dëmet etj., me qëllim të gjetjes së rrugës së daljes nga kjo situatë e rrezikshme dhe aktualisht pa ndonjë sukses të dukshëm. Preferenca e vetme është izolimi dhe pastërtia e nivelit të lartë, me qëllim të pengimit të përhapjes së saj.

Islami, si koncept jete, e definon çdo sferë që ka të bëjë me njeriun dhe shoqërinë, pra edhe këtë çështje me të cilën po ballafaqohemi në këtë kohë, andaj edhe

ne do mundohemi t'i qasemi nga aspekti islam kësaj çështje, që sadopak të japim kontributin tonë për të ngritur vetëdijen e besimtarit dhe të njeriut në përgjithësi, duke iu qasur nga disa dimensione.

SËMUNDJET, PJSË PËRBËRËSE E JETËS

Jeta është dhurata dhe vlera më e madhe që i është dhënë njeriut dhe, si e tillë, është e shenjtë. Sa është e dashur dhe e ëmbël, aq është edhe me vështirësi dhe probleme të llojeve të ndryshme, të cilat atij i sjellin pikëllim, demoralizim, trishtim, ankth etj.

Edhe sëmundjet janë situata të cilat, në esencë, janë normale, sepse sëmundjet e këtuja e kanë goditur njerëzimin prej njeriut të parë dhe ato kanë qenë sfidë e të

gjitha kohëve, vendeve, popujve, civilizimeve. Posaçërisht në shekullin e fundit, ku solli pasoja të rënda në të gjitha sferat, qofshin ato ekonomike dhe fizike. Bota është ballafaquar gjatë historisë me sëmundje të ndryshme dhe gjithmonë pasojat e tyre kanë qenë të papërshkrueshme, si: nga tifoja, lebroza, kolera, AIDS, Sars dhe tani Korona.

Kurani famëlartë paraprakisht bën përgatitjen psikike, morale dhe fizike të besimtarit, duke e paralajmëruar me një segment të pandashëm në jetën e tij: me vështirësitë, me problemet etj. që mund ta godasin njeriun: *Ve le nebluvenekum...*

Ky paralajmërim është mëshirë e të Madhit Zot ndaj njeriut, me qëllim të njoftimit të njeriut dhe njerëzimit në përgjithësi se jeta do të kalojë patjetër në pengesa të këtitilla, ndërsa njeriu duhet të jetë i përgatitur dhe i profesionalizuar, me qëllim që të ballafaqohet me to. Allahu nuk ia lë njeriut që ai jetën ta kalojë në befasi, papritshmëri, mahnitje, huti, panik, shqetësim, depresion, trishtim, ankth, pesimizëm, etj. Për këtë ia definon çështjet kryesore dhe vështirësitë me të cilat mund të ballafaqohet, si: frika, uria, varfëria, shkatërrimi i pasurisë, vdekja, rrënimi etj. Pra, edhe sëmundjet janë një ndër situatat me të cilat njeriu patjetër të ballafaqohet në jetën e tij. Jeta nuk është vetëm kënaqësi, qetësi, rehati, lumturi etj., por edhe pengesë e vështirësi, ashtu siç janë e keqja dhe mira, nata dhe dita, pozitivja dhe negativja etj. Në esencë, edhe njëra edhe tjetra janë pjesë përbërëse të jetës dhe e plotësojnë njëra-tjetër dhe nuk do të gabojmë nëse themi se ky është edhe ligji i Allahut në natyrë, pa të cilin nuk mund të zhvillohen dukuritë e natyrës, proceset zhvillimore të njerëzimit në përgjithësi etj.

Për këtë i madhi Zot në Kurandin famëlartë thotë:

“Ne çdo send kemi krijuar në masë të caktuar.” (El Kamer: 49)

“... Po, mund që ju të urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju të doni një send, e ai është dëm për ju. (Allahu e di fundin e çdo sendi) e ju nuk e dini.” (El Bekareh: 216)

RËNIA MORALE SJELL ÇRREGULLIME

Njeriu sipas konceptit islam është mëkëmbës i Zotit në Tokë dhe, si të tillë, i është vënë në shfrytëzim dhe shërbim gjithë çka ka në tokë dhe në qiej. Ai ka për obligim ta ndryshojë botë në drejtim të së mirës. Njerëzoria është qëllimi kryesor i jetës njerëzore: t'i japë shpirt çdo

sendi në natyrë - qoftë materiale, fizike, politike, shoqërore. Ai është subjekti kryesor i zhvillimeve në jetë; ai është edhe drejtues i të mirës dhe të keqes. Dhe, gjithçka që ndodh, faktor kryesor është njeriu. Për këtë njeriu thirret të jetë si subjekti i të mirës dhe shkatërrues i të keqes. Historia është dëshmitare e ngritjeve të mëdha dhe, në momentin kur kanë humbur shpirtin dhe moralin, kanë pësuar shkatërrimin dhe rëniet shumë të rënda, me pasoja të paparshikueshme për njeriun dhe njerëzimin. Andaj, ngritjet e mëdha njerëzore duhet të zhvillohen në ekuilibër dhe simbiozë të materiale dhe shpirtërore- morale, ndërsa ngritja e njëres pa tjetrën është njëanshmëri dhe humbje e ekuilibrit, moment ky që sjell lëkundjet dhe rëniet e trishtueshme në jetën njerëzore. Andaj, edhe sot në kohën e ngritjes më të madhe të civilizimit njerëzor, ku njeriu pushtoi Tokën, qiejt, bën kontrollin e shoqërive, të ekonomisë, të politikës, shkencës, duke e çelur madje edhe epokën e hulumtimit për t'i gjetur zgjidhje edhe vdekjes - që është një enigmë e madhe e njeriut modern - bota si duket e humbi shpirtin, e humbi moralin, e humbi njerëzoren. Etikologët në shekullin e fundit e paralajmëruan civilizimin botëror se ai po zhvillohet vetëm në aspektin material, me një mungesë të madhe të shpirtit dhe të moralit dhe këtë mënyrë të ngritjes dhe zhvillimit e emërtoi *civilizim i sëmurë dhe me pasojë katastrofale për qenien njerëzore*. Botën moderne si duket e mori harresa e dinamizmit për t'i mbajtur monopolin materiale dhe u bë rob i saj (- i materiale), me rënie drastike morale dhe shpirtërore, që sollën të sëmundjet e papara në botë, si: alkoolizmi, amoraliteti, prostitucioni, narkomania, homoseksualizmi, lezbeizmi, zhdukja e personalitetit të njeriut, shkatërrimi i familjes si qelizë kryesore e shoqërisë, distancimi i njeriut me njeriun, i popujve nga popujt, zhvillimi i vrasjeve, i luftërave, zhdukja e vlerave njerëzore dhe e vetë njeriut etj. Rreziku më i madh nuk qëndron në zhvillimin e politikës dhe ekonomisë; shtyllat kryesore të zhvillimit njerëzor sot, por pse jo edhe në dekadat e fundit, shënojnë zhvishjen e tyre nga vlerat e shpirtit dhe të moralit. Kjo do të thotë rënie në kthetrat e epshtit, të emocionit, që të çon drejt asaj që është destruktive. Kjo bëri që njeriu modern për gjithçka të mendojë, e aspak për atë që është krijuar: kthim drejt vetvetes, të mendojë për vetveten dhe njerëzoren, siç thotë Gëte, Gijon, Bernard Show, Bertrand Rasel, Husein Nasr dhe etikologë dhe filozofë të tjerë të botës moderne. Edhe sida, edhe sarsi u vërtetua se janë rezultat i këtij

deformimi moral e njerëzor, por pa dyshim edhe te virusi Korona patjetër të ketë dorë vetë njeriu. Është koncept sociologjik islam se rënia dhe dënimet janë rezultat i rënies së njerëzore te njeriu. Kurani famëlartë shembull për këtë sjell civilizimet në historinë njerëzore, të cilat shkatërrimin e gjetën kur u larguan nga ky koncept: përmend civilizimin në kohën e Salihut (a. s.) dhe dënimin që përjetoi ai dhe populli i tij, Nuhin (a. s.), Lutin (a. s.), civilizimet e mëdha egjiptase të faraonëve, civilizimin romak e bizantin etj. E gjithë kjo po ndodh në momentin kur njerëzimi me pakujdesinë e vet, i robëruar nga lakmia e kësaj bote, i prish marrëdhëniet dhe ligjet që i krijoi Zoti në natyrë e në kosmos.

FATKEQËSITË JANË SPROVA

Çdo zhvillim në jetë nuk është e rastit; është me një qëllim të caktuar. Andaj, gjithçka në zhvillimet e jetës në tokë dhe në natyrë janë fenomene që flasin, që definojnë, që shpjegojnë dhe që japin porosi. Ato bëjnë që njeriu të hap debat me to, me qëllim që t'i kuptojë ato. Edhe fatkeqësitë e ndryshme në këto momente të sëmundjes nga virusi Korona është fenomen, i cili në sulmin e vet nuk zgjedh mjete rrezikshmërie dhe pasojash drastike që i sjell njerëzimit. Në këtë mes, kulturologët, etikologët, sociologët mundohen ta definojnë atë nga prizmi i rregullave dhe koncepteve të tyre. Njashtu edhe studiuesit e besimeve të ndryshme në botë, në veçanti përfaqësuesit e mësimin islam, mundohen të kontribuojnë në këtë kohë, duke shpjeguar dhe duke i dhënë domethënie edhe kësaj situatë apo sëmundjeje, duke iu qasur mësimëve kuranore dhe frymës së tyre. Nga kjo mund të konkludohet se virusi Korona në këto momente paraqet: sprovë për kalitje dhe qëndrueshmëri në goditjet e jetës; vetëdijësim të njeriut për një qasje më të shëndoshë ndaj jetës.

Kjo sëmundje e rrezikshme, që po rrezikon globin në shikimin shpirtëror dhe moral islam paraqet sprovë për një kalitje dhe qëndrueshmëri në goditjet dhe stuhitë e jetës, të cilat janë të patjetërsueshme. Sëmundjet janë goditje që e sprovajnë njeriun dhe njerëzimin me qëllim të dhënies kuptim dhe mësim jetës në vështirësi dhe përgatitjes për tejkalimin e tyre. Sprova e përgatitjes për tejkalimin e tyre të gjitha forcave fizike dhe shpirtërore për formimin e një personaliteti të shëndoshë fizik, psikik, shpirtëror, moral për të arritur te vlera që quhet *qëndrueshmëri*, të cilën Kurani famëlartë e quan *“sabër”*.

Institucioni i sabrit nuk është ikje nga sprovat, vështirësitë, por aftësi dhe për-

gatitje e fortë për të besuar dhe lidhur shpirtin dhe të menduarit me Zotin, me qëllim që t'u qëndrohet stuhive, baticave dhe zaticave të kohës që njeriu i përjeton. Të këtitilla sprova e forcojnë shpirtin, moralin, trupin, gatishmërinë, forcën për të kuptuar dhe ngadhënjyer ndaj çdo goditje që e trondit njeriun. Për këtë Allahu fuqiptotë kërkon nga Muhamedi (a. s.) *“t'u japë sihariqin atyre që janë të durueshëm”*, për shkak se, nëse arrijnë pjekurinë e durimit në tejkalimin e vështirësive dhe të fatkeqësive të jetës, *“ata do të shpërblehen pa masë në botën tjetër”*.

KU GABOVA?!

Sprova ka qenë prezente gjatë tërë jetës së njeriut dhe të njerëzimit; ato e kanë goditur njeriun e thjeshtë, por sprovat më të mëdha i kanë goditur njerëzit e zgjedhur, bartësit e idealeve të larta hyjnore në shërbim të njeriut, duke filluar nga pejgamberët, dijetarët, luftëtarët për të mirën etj. Sprova është situatë që e kalit njeriun dhe njerëzimin, për të arritur atë më të mirën, më të lartën, më humanen, më të drejtën, më të lumturën dhe për ta arritur zhvillimin njerëzor konform rrugës së vërtetë.

Vetëdijësimi i njeriut për një qasje më të shëndoshë ndaj jetës: Fatkeqësia që sjellë virusi Korona është vetëdijësim e njeriut, i botës moderne e më gjerë për një qasje të shëndoshë dhe gjithçka që përfshin ajo, si: lidhjen me Zotin, me natyrën, me pasurinë, me ekonominë, me njeriun, me rrethin dhe natyrën. Njeriu duhet t'i kthehet vetvetes dhe të analizojë rreth qëllimit të jetës, lidhjes së tij me Zotin, nënshtrimin ndaj ligjeve dhe vullnetit të Tij, vënia e personalitetit të Tij në shërbim të njeriut dhe të zhvillimit të së mirës ndër njerëz – të gjitha këto janë çështje kryesore rreth të cilave duhet menduar dhe ato duhen analizuar. Kurani famëlartë ngjarjet e këtitilla në histori i definon si vërejtje, si mësim, si vetëdije, si argument, duke thënë: *“...Pra, merrni përvojë, o ju të zotët e mendjes.” (El Hashër: 2)* *“A nuk e shohin ata se për çdo vit sprovohen një herë apo dy herë, e përsëri nuk marrin mësim.” (Et Teubeh: 125)*

Andaj, njeriu modern në këto momente, përveç mobilizimit për dalje nga kjo krizë, duhet të fillojë seriozisht të mendojë se ku ka gabuar, ku ka prishur, ku ka shkatërruar, ku i ka përzier ligjet e Zotit etj.

(Autori është Myfti i Myftinisë së Gostivarit)

(Kryhet në numrin tjetër)



PAS ÇDO VËSHHIRËSIE VJEN LEHTËSIMI



Pejgamberi (a. s.) na ka mësuar si të lutemi në këto situata: “O Zot, më ruaj nga lebra, nga çmenduria, nga murtaja dhe epidemia dhe nga të gjitha sëmundjet e këqija.”

Shkruan: Dr. Husein Rizai

“Thuaj: “Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga Allahu; Ai është ndihmëtari ynë. Prandaj, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët.” (Teube, 51)

Në këtë kohë, kur gati e gjithë bota është duke përjetuar një panik real ose artificial nga “Virusi Korona”, duke qenë të vetëdijshëm për seriozitetin dhe përmasat mbarëbotërore që ka marrë kjo epidemi, e pashë të arsyeshme të përndaj me ju disa mesazhe, me shpresën që Allahu (xh. sh.) të na qetësojë sadopak zemrat tona, e të bëjmë atë që është më e mira për të dyja botët.

E, pra, si duhet të jetë diskursi ynë ndaj kësaj çështjeje, e cila është mjaft e rëndësishme për ne?

Ajo që duhet të na karakterizojë në këtë kohë të trazuar është pikërisht besimi tek Allahu (xh. sh.) dhe mbështetja tek Ai. Besimi te Krijuesi i jetës dhe i vdekjes, i të dukshmes e i të padukshmes, i virusit dhe i tërmetit, i gjithçkaje tjetër që ne e dimë dhe shumëçkaje tjetër që ne nuk e dimë. Le t'i kujtojmë vetës tonë se ka një Zot të cilit ne i besojmë, se ka një kader (përcaktim) të cilit nuk mund t'i shmangemi dhe se streha më e sigurt në këtë kohë është streha e Krijuesit që di gjithçka dhe bën çfarë të dojë.

Ajo që duhet të jetë më se e nevojshme në këto momente është marrja e masave parandaluese ndaj kësaj epidemie, me higjienën personale dhe të ambientit në krye. Pastërtia është një nga hapat më të rëndësishëm për ta sfiduar këtë pandemi. Përkujdesja

për higjienën personale, familjare dhe kolektive është masa që duhet ndërmarrë paraprakisht. Feja islame i jep një rëndësi të madhe higjienës personale dhe higjienës së ambientit ku jetojmë e punojmë, duke e konsideruar higjienën dhe pastërtinë si pjesë të besimit.

I dërguari i Allahut dhe shokët tijnë raste të jashtëzakonshme përdornin metodën e karantinës. Ai e pranonte praninë e sëmundjeve ngjitëse dhe merrte masa kundër tyre. Është shumë me rëndësi të përmendet se sahabët e mençur ishin të vetëdijshëm dhe të bashkuar në mendimin se çështja e mbrojtjes së shëndetit është më e rëndësishme se përfitimet e tjera publike dhe se kjo nuk është në kundërshtim me besimin në kader.

I dërguari i Allahut ka rekomanduar të merren masa dhe të ndalohet hyrja në vendet ku është përhapur sëmundja, kurse në anën tjetër e ka ndaluar largimin nga vendi i sëmundjes, madje ndonjëherë i ka ndërprerë edhe kontaktet me njerëzit e sëmurë. Për shembull, njëherë besnikërinë e një personi të sëmurë e ka marrë me shkrim, duke pasur parasysh gjasat e ngjitjes së sëmundjes. Megjithatë, një njeri të sëmurë nga sëmundja e lëkurës e ka kapur për dore dhe i ka mundësuar që të ushqehet dhe e ka urdhëruar duke i thënë: *“Ha në emër të Allahut dhe duke u siguruar tek Ai.”*

Këto veprime të të dërguarit të Allahut, pa dyshim, janë bërë me qëllim kryesor: vënien e një balance të ndjeshme ndërmjet masave të marra kundër mosngjitjes së sëmundjeve dhe mospërrjashtimit të të sëmurit.

I dërguari i Allahut në aspektin e mbrojtjes së njerëzve nga sëmundjet ngjitëse ka siguruar një disiplinë dhe edukatë të posaçme, sidomos në mbrojtjen prej grimcave që dalin nga pështyma dhe këlbaza. Edhe vetë kur teshtinte, e mbulonte fytyrën e vet me dorë ose me rrobë dhe e parandalonte shpërndarjen rreth e përçark të grimcave të pështymës.

Në kontekstin e pastërtisë së mjedisit ka urdhëruar: "...pastroni shtëpitë dhe lagjet tuaja" dhe se "largimi i gjithçkaje që pengon nga rruga është sadaka". Madje, ndonjëherë edhe personalisht e ka pastruar mesxhidin. "Largohuni nga tri gjëra që janë shkak-tare të mallkimit: bërja e nevojës së vogël në burimet e ujit, në mes të rru-gës dhe në hije" - janë fjalët që e përshkruajnë rëndësinë e kësaj çështjeje. Edhe pastërtisë së ushqimeve dhe të pijeve u ka kushtuar rëndësi, si shumë të rëndësishme për shëndetin. Urdhrrat e të dërguarit të Allahut për mbulimin e enëve të ushqimit, apo enëve të pijeve, mbulimi i enëve të ujit, kujdesi i tij për pirjen e ujit të pastër dhe inkurajimi i shpërndarjes së ujit te njerëzit si element kryesor për pastërtinë, kanë qenë disa nga masat që ka marrë në këtë drejtim.

Pa dyshim që ndalimi i hyrjes në zonën e infektuar me epidemi, dhe po

ashtu edhe ndalimi i daljes prej saj, pa-stërtia trupore dhe e ambientit, kontrolli mjekësor në rast dyshimi dhe njoftimi i autoriteteve, evitimi i çdo lloj veprimi të panevojshëm i cili mund të çojë në marrjen apo përhapjen e virusit etj., janë rregulla jo vetëm shëndetësore, por edhe fetare, andaj ne si besimtarë duhet të japim shembullin e respektimit të rregullave shëndetësore, si porosi fetare dhe si bindje ndaj autoriteteve kompetente.

Besimtari nuk duhet të kaplohet nga frika dhe paniku intensiv, i shkakuar nga sprovat që mund ta prekin atë, ose njerëzit përreth tij. Duhet të jemi të vetëdijshëm se sprovat me të cilat sot ballafaqohemi nuk janë vetëm sprovat tona dhe të shekullit që po jetojmë, porse edhe të atyre para nesh, i shumë të tjerëve që janë ballafaquar me sprovat e veta që kanë pasur. Andaj, në të gjitha këto momente dhe situata të pakëndshme besimtari duhet të tregojë durim dhe qëndrueshmëri. Ai nuk dorëzohet kollaj, sepse e di që kjo është e kalueshme, madje edhe e shërueshme. Për durimin me maturi që e tregon besimtari do të shpërblehet shumëfish nga i madhi Allah. Muhamedi (a. s.) thotë: "Çdo myslimani që lëndohet nga ndonjë e keqe Allahu do t'ia fshijë gjynahet siç bien gjethet e pemës." "Nëse dikush në kohën e një murtaje (sëmundjeje ngjitëse) qëndron në vendin e tij, duke

shpresuar me durim shpërblimin e Allahut dhe duke besuar se asgjë nuk do t'i bjerë atij, përveç asaj që Allahu e ka shkruar (caktuar) për të, ai do të marrë shpërblimin e një dëshmori."

Ne si besimtarë besojmë me të vërtetë se duaja është thelbi i adhurimit, se ajo na afron tek Allahu fuqiptotë, se ajo mund të jetë shkak edhe për kthimin mbrapsht të caktimit – atëherë, më shumë se kurrë ne jemi të ftuar të kthehemi te lutjet drejtuar Allahut fuqiptotë dhe përjetimi i tyre me shpirt e me zemër. Pejgamberi (a. s.) na ka mësuar si të lutemi në këto situata: "Me emër të Zotit, të atij Zoti pranë emrit të të Cilit nuk ka gjë që të dëmton në qiell e në tokë dhe Ai (Zoti) është Dëgjues dhe Shikues." (3 herë) "O Zot, më ruaj nga lebra, nga çmenduria, nga murtaja dhe epidemia dhe nga të gjitha sëmundjet e këqija." "O Zot, na ruaj nga largimi i të mirave Tua, nga kthimi i shëndetit në sëmundje, nga sprovat e papritura dhe nga çdo zemërim i Yt."

O Allah, na mbro nga kjo sëmundje që është përhapur gjithandej. O Zot, na ruaj nga fatkeqësitë dhe sëmundjet të cilat nuk kemi mundësi t'i largojmë! Na ruaj dhe na mbro nga çdo e keqe që mund të na godasë! O Allah, na dhuro qetësi në besim, shëndet në trup dhe na ruaj nga dënimi Yt!

"Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi!" (Inshirah, 5)



PEJGAMBERI MUHAMED MENDON NDRYSHE...

A ka forcë lutja, që e vetme, të ndalojë një dermatit si virusin korona? Çfarë ka thënë i dërguari i Zotit para 1400 e sa viteve? - Artikull i botuar në revistën amerikane "Newsweek".

Shkruan: Dr. Craig Considine

Pandemia COVID-19 është duke e detyruar qeveritë dhe burimet e lajmeve që t'i ofrojnë popullatës botërore këshillat sa më të sakta dhe ndihmuese, sepse kjo sëmundje vërtet po e kaplon tërë globin. Kërkesat për mjekë dhe infermierë të profesionalizuar janë të larta, ashtu si dhe kërkesat për shkencëtarë që studiojnë format e përhapjes së pandemive dhe efektet e tyre.

Ekspertët, si imunologu Dr. Anthony Fauci dhe raportuesi për çështje mjekësore Dr. Sanjay Gupta, thonë se higjiena e mirë dhe karantinimi, ose, thënë ndryshe, praktika e izolimit nga të tjerët, me shpresën se do të mund të parandalohet përhapja e sëmundjeve ngjitëse, janë mjetet më efektive për ta kufizuar COVID-19.

Por, a e dini kush tjetër e ka sugjeruar higjienën e mirë dhe karantinimin gjatë një pandemie?

Muhamedi, Pejgamberi i Islamit, para më shumë se 1400 vitesh.

Edhe pse ai, në asnjë formë nuk është një ekspert "tradicional" për sëmundje vdekjeprurëse, sidoqoftë Muhamedi ka dhënë këshilla shumë të shëndosha për ta parandaluar dhe luftuar zhvillimin e sëmundjeve si COVID-19.

Muhamedi (a. s.) ka thënë: "Nëse do të dëgjoni se mortaja ka shpërthyer në një vend, mos hyni, mos shkoni atje; por nëse mortaja shpërthen në një vend, ndërsa ju jeni aty, mos e lëshoni atë vend!"

Ai gjithashtu ka thënë: "Ata që kanë sëmundje ngjitëse duhet të mbahen larg nga të shëndoshët."

Muhamedi (a. s.) gjithashtu i ka nxi-

Newsweek

tur njerëzit fuqimisht që të ndjekin praktika higjienike, që do t'i mbanin njerëzit të shëndoshë nga infektimi.

Viniu re thëniet, haditheve, vijuese të Pejgamberit Muhamed:

"Pastërtia është pjesë e besimit."

"Lani duart pasi të zgjoheni, sepse nuk e dini se kah kanë lëvizur duart tuaja derisa keni qenë duke fjetur!"

"Bereqeti i ushqimit fshihet në larjen e duarve para dhe pas ushqimit."

Po sikur dikë ta kaplojë sëmundja? Çfarë këshille do t'u jepte Muhamedi njerëzve që po vuajnë nga dhimbjet?

Ai do t'i inkurajonte njerëzit që gjithmonë të kërkojnë trajtim mjekësor dhe shërim, duke thënë: "Shëroni veten tuaj me ilaçe! Sepse, Zoti nuk ka krijuar asnjë sëmundje e të mos ia këtë krijuar edhe ilaçin; përveç një sëmundjeje: pleqërisë."

Mbase më e rëndësishmja është se ai dinte ta mbante baraspeshën midis besimit dhe arsyes së shëndoshë.

Në javët e fundit disa njerëz kanë shkruar aq larg me sugjerimet e tyre, saqë kanë sugjeruar se lutja do të ishte më e mirë për t'u mbrojtur sesa t'u përmbahesh rregullave bazë të distancimit social dhe karantinës.

Si do t'i përgjigjej Pejgamberi Muhamed idesë që lutja duhet të jetë arma e vetme, ose më e rëndësishme e shërimit?

Vijini re këtij rrëfimi, të treguar nga shkencëtari persian i shekullit IX E't-Tir-

midhi, që thotë: Një ditë Pejgamberi Muhamed pa një beduin që po e linte devenë e tij pa e lidhur. E pyeti beduinin: "Pse nuk e lidh devenë tënde?" Beduini u përgjigj: "I mbështetem Allahut." Pejgamberi i tha: "Lidhe njëherë devenë, pastaj mbështetju Allahut!"

Muhamedi (a. s.) i nxiste njerëzit që të kërkojnë udhëzimin përmes fesë, por ai shpresonte gjithashtu se ata do t'i merrnin masat themelore parandaluese për të ruajtur stabilitetin, shëndetin dhe mirëqenien e të gjithëve.

Me fjalët të tjera: Ai shpresonte se njerëzit do ta përdorin arsyen e shëndoshë!

Përktheu: Ensar Sinani

Dr. Craig Considine është një shkencëtar, profesor, ligjërues botëror dhe kontribues për media, që punon në Departamentin e Sociologjisë në Universitetin e Rajsit (Rice University). Ai është autor i veprave The Prophet of Love: A Catholic's Note on Prophet Muhammad (2020), Tughra Books: Clifton, New Jersey; Islam in America: Exploring the Issues (2019), ABC-CLIO: Santa Barbara, California; Muslims in America: Examining the Facts (2018), ABC-CLIO: Santa Barbara, California etj.

Burimi: Newsweek, ON 3/17/20 AT 1:06 PM EDT, New York, NY 10004, <https://www.newsweek.com/prophet-prayer-muhammad-covid-19-coronavirus-1492798>

IBN SINA (AVICENA), ZBULUES I KARANTINËS



Mjeku i madh mysliman Ibn Sina është zbuluesi i karantinës si mjet për luftimin e sëmundjeve që përhapen përmes ajrit. Historiani dhe epidemiologu amerikan David W. Tschanz në një artikull shkencor të këtyre ditëve, kur bota përballlet me virusin Korona, rrëfen se i pari që ka zbuluar se disa sëmundje ngjitëse përhapen përmes “gjurmëve“ që njerëzit e sëmurë i lënë në ajër dhe që mund të ngjiten në trup ose në teshat e njerëzve të tjerë është filozofi, mjeku dhe fizikani i madh mysliman Ibn Sina, i njohur në Perëndim edhe si Avicena (980-1037). Këto sëmundje janë ato që sot quhen viruse respiratore, ose që përhapen përmes frymës – ajrit, ndër të cilat bën pjesë edhe virusi i famshëm Ko-

rona, ose Covid-19.

Ky zbulim i Ibn Sinasë, përkatësisht teoria e tij se sëmundja përhapet përmes gjurmëve të mbetura në ajër, e çoi atë që të aplikojë karantinën, ose izolimin e njerëzve dhe largimin e tyre prej njëri-tjetrit, si mjet për përkufizimin e përhapjes së këtyre sëmundjeve ngjitëse.

Madje edhe fjala karantinë, që rrjedh nga dialekti venecian i italishtes dhe që d.m.th katërdhjetë, rrënjët i ka te ky zbulim i Ibn Sinasë, sepse ai periudhën e izolimit të njerëzve nga njëri-tjetri e kishte kufizuar me 40 ditë dhe e kishte quajtur katërdhjetësh (arabisht: El-Erbeiniyyeh). Kjo metodë ka arritur në Evropë përmes tregtarëve venedikas që kishin mësuar për këtë metodë të Ibn Sinasë dhe e ki-

shin aplikuar atë në vendin e tyre në shekujt XIV dhe XV.

Ibn Sina kishte sugjeruar që në kohë të një epidemie, të këtij lloji, duhet të mbylleshin tregjet, xhamitë, shkollat dhe të obligoheshin njerëzit të rrinë në shtëpi derisa të kalojë epidemia - pikërisht ashtu siç e ka kuptimin fjala karantinë sot dhe siç po aplikohet në botë me rastin e pandemisë së virusit Korona.

Përgatiti: Ensar Sinani

Referenca:

1. David W. Tschanz, MSPH, PhD (August 2003), "Arab Roots of European Medicine"
2. <https://en.wikipedia.org/wiki/Quarantine>

COVID-19, SI TË GJENDET ZGJIDHJA

Kjo krizë nuk është vetëm krizë shëndetësore, por edhe e mënyrës se si veprojmë ne me të - që nga reagimi i vonuar, deri tek efektet personale. Pritshmëria jonë ndaj krerëve politikë është që ata të sigurojnë si shëndetin, ashtu edhe lirinë tonë. Kur kjo krizë të kalojë, duhet të analizojmë se pse shkoi puna kaq larg dhe çfarë mund të mësojmë nga Singapori.

Shkruan: Prim. dr. Mair Iseini

Studiuesit kanë ardhur në përfundim se izolimi dhe mbyllja në shtëpi është mjeti i vetëm me të cilin mund të luftohet virusi Korona. Karantina zakonisht përcaktohet për periudhën e inkubacionit të sëmundjes ngjitëse. Për Covid-19 periudha e karantinës është 14 ditë, nga data e fundit e ekspozimit, sepse 14 ditë është periudha më e gjatë e inkubacionit që shihet për koronaviruset të ngjashme.

Për këtë arsye, Qeveria ka ndërmarrë masa që të mbyllë shkollat, universitetet, të izolojë personat që kanë pasur kontakt me të infektuarit nga virusi Korona apo vijjnë nga zonat që janë të prekura nga ky

virus, ka kufizuar lirinë e lëvizjes së qytetarëve, si dhe masa të tjera. Këto masa, sipas ekspertëve, e ulin nivelin e përhapjes së virusit Korona nga 80 deri në 99 për qind. Epidemiologët thonë se të paktën një muaj kalendarik izolim i tërësishëm, është i domosdoshëm për ta luftuar virusin Korona.

Që në ditët e para, kur virusi Covid-19 u shfaq në Kinë, të gjithë ekspertët e shëndetit sugjeruan që të gjithë ata persona që kishin sëmundje të ndryshme të evitonin lëvizjet e shpeshta nëpër rrugë. Vetëm në këtë mënyrë ata mund të shmangnin përhapjen e këtij virusi. Transmetimi nga njeriu tek njeriu ka sjellë dhe një rritje të ndjeshme të numrit të rasteve në çdo vend ku është shfaqur koronavirusi.

Shumë raste janë mjaft të buta, sa që nuk mund ta kuptoni kurrë se jeni të infektuar. Këta njerëz mund të etiketohen si të infektuar, por asimptomatikë, por mund të infektajnë të tjerët. Ende ka shumë që nuk dimë për sëmundjen, por e dimë se mund të jetë fatale për grupe të caktuara, si ata mbi moshën 60 vjeç dhe ata që kanë sëmundje të tjera klinike. Kjo është dhe arsyeja pse mjekët këshillojnë se edhe nëse nuk jeni të prekur ende nga Covid-19, silluni sikur jeni të infektuar. Kjo ndihmon për të praktikuar distancimin shoqëror.

Covid-19 është një sëmundje e cila nuk ka imunitet natyror tek popullata, pasi nuk ekziston ende një vaksinë për të. Kjo nënkupton se mënyra e vetme që virusi të



largohet nga popullsia, në një farë kuptimi, është ose të infektosh të gjithë, ose të kufizojë aftësinë e virusit për t'u përhapur nga një person në tjetrin. Distanca sociale është ajo që "krijon një pengesë" dhe që i mbron njerëzit që janë më të rrezikuar nga ky virus në komunitet.

INFEKSIONI DHE SËMUNDJA, TË PAPANASHIKUESHME

Shumë pak dimë për Covid-19: infeksioni dhe sëmundja janë seriozisht të paparashikueshme - vetëm kjo është e sigurt. Megjithatë, përvoja e deritanishme tregoi se 80 për qind e pacientëve zhvillojnë simptoma shumë të lehta, ose aspak nuk i vërejnë. Qytetarët duhet të kenë frikë, por, nuk guxojmë të krijojmë panik.

Ka ende pyetje pa përgjigje edhe se, vallë, pacientët e shëruar përsëri mund të sëmuren nga virusi Korona, cilat ilaçe janë më të mira, pse është kështu të disa, e ndryshe të njerëz të tjerë. Rekomandimi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) është: ata që janë lëshuar nga spitali pas dy testeve të njëpasnjëshme, edhe 14 ditë të mbeten në izolim shtëpiak. Po bëhen përpjekje maksimale që të shpëtohet jeta e secilit. Si do të jenë statistikët, nuk dihet. Pandemia duhet të përfundojë së pari dhe tani është prioritet mjekimi.

Ka edhe fëmijë të infektuar, por ata nuk janë të sëmurë, nuk kanë zhvilluar kurrfarë simptomash për çka edhe nuk ka nevojë për hospitalizimin e tyre. OBSH

bëri thirrje që të mos merren ilaçe kokë më vete. Më së miri është pacientët të cilët dyshojnë se kanë virus Korona të tregojnë se cilat sëmundje kronike i kanë, sepse terapia është e ndryshme, varësisht gjendjes gjithëpërfshirëse shëndetësore të personit. Prej gjithsej mbi 500 persona të sëmurëve nga virusi Korona, mbi 60 janë hospitalizuar në Klinikën Infektive.

Janë disa çështje të cilat në të ardhmen kërkojnë një përgjigje të saktë, për të kuptuar se me çfarë po përballet realisht njerëzimi.

Sa njerëz janë infektuar? - Shumë ekspertë thonë se ky nuk është numri i saktë, pasi disa njerëz, edhe pse kanë sëmundjen, nuk shfaqin simptoma. Zhvillimi i një testi me antitropa do t'i lejojë kërkuesit që të kuptojnë se sa njerëz e kanë pasur realisht sëmundjen. Vetëm atëherë do të kuptohet sa larg dhe sa lehtë u shpërnda Covid-19.

Sa vdekjeprurës është, në të vërtetë? - Vetëm duke ditur numrin e të prekurve në mënyrë të plotë, atëherë do të shikojmë me siguri sa ishte përqindja e të vdekurve. Për momentin llogaritet se vetëm 1% e njerëzve të infektuar me koronavirus vdesin. Por, nëse ka një numër më të madh pacientësh simptomatikë, atëherë edhe vdekshmëria është më e ulët.

Simptomat e plota që shfaq - Simptomat kryesore janë temperatura dhe kolla. Por, njerëzit kanë raportuar edhe për fyt të thatë, dhimbje koke dhe diarre. Në disa raste edhe humbje të nuanës dhe shijimit.

Çfarë roli kanë fëmijët për shpërndarjen e sëmundjes? - Fëmijët me Covid-19, shumica prej tyre e kanë kaluar me simptoma të lehta, ndërsa vdekshmëria për këtë grupmoshë paraqitet shumë e ulët krahasuar me të tjerët. Normalisht, fëmijët janë super-shpërndarës të sëmundjes. Megjithatë, është ende e paqartë se deri në çfarë faze e shpërndajnë këtë virus.

Nga erdhi Covid-19? - Covid-19 shpërtheu në Wuhan të Kinës në fund të 2019-s. Mendohet se sëmundja ka dalë nga një treg kafshësh. Koronavirusi njihet nga ekspertët si Sars-CoV-2 dhe lidhet ngushtë me viruset që infektjnë lakuriqët e natës. Megjithatë, është ende e paqartë se si kaloi nga lakuriqi i natës të një specie që ende mbetet misterioze dhe më pas te njerëzit. Kjo "hallkë e zinxhirit" mbetet e panjohur dhe mund të jetë burim infeksionesh të tjera.

Si vepron Covid-19 në verë? - Gripi është shumë i zakonshëm në muajt e dimrit, por për sa i përket këtij virusi, ende nuk dihet se si do të funksionojë gjatë verës.

Pse disa njerëz kanë më shumë simptoma? - Për shumicën e njerëzve koronavirusi është një infektion i lehtë. Sidoqoftë, rreth 20% e njerëzve kanë simptoma më të forta. Pse ndodh kjo? Përparakisht mendohet se është sistemi imunitar. Ekspertët shprehen se mund të ketë edhe faktorë gjenetikë. Sidoqoftë nëse kjo gjë kuptohet më qartë nga shkencëtarët,

atëherë do të ketë mënyra parandalimi që njerëzit të mos shkojnë deri tek terapia intensive.

Sa zgjat imuniteti i trupit dhe a infektosh sërish pasi e ke kaluar sëmundjen? - Ka pasur shumë spekulime, por pak prova se sa mund të durojë imuniteti i trupit ndaj virusit. Ndërkohë sa u përket personave që thonë se janë infektuar sërish, sipas disa ekspertëve kjo mund të jetë e gabuar. Sipas tyre, një prej testeve ka qenë i gabuar dhe personat nuk kanë qenë të shëruar.

A do të zhvillojë mutacione virusi? - Viruset pësojnë mutacione gjatë gjithë kohës. Në përgjithësi, pritet që viruset të evoluojnë dhe të bëhen më pak vdekjeprurës, por kjo nuk garantohej. Shqetësimi lind se nëse virusi pëson mutacion, atëherë sistemi imunitar nuk e njeh më dhe vaksina specifike nuk vepron më ndaj tij (siç ndodh me gripin).

I mungon Evropës përvoja e Sars-it? - Megjithëse tingëllojnë të tmerrshme, këto masa do të mund të kishin ndihmuar. Evropa nuk reagoi shpejt dhe në mënyrë efektive ndaj pandemisë që po përhapej; kjo ishte pasojë e një arrogancë eurocentriste dhe e përpjekjeve të pakoordinuara për të mbrojtur firmat lokale. Megjithëse krerët e shteteve dhe qeverive kishin dënuar për virusin që në fund të dhjetorit, ai u injorua për një kohë të gjatë si „një problem aziatik“. Gjithçka që Singapori e bëri ashtu si duhet - mbylljen e hershme të kufijve, teste të zgjeruara dhe ndjekjen e kontakteve për izolim - vendet evropiane e bënë gabim. Le të marrim si shembull Austrinë. Fluturimet nga Kina, Irani dhe Italia u ndaluan vetëm më 9 mars. Frika se do të dëmtohet ekonomia lokale për shkak të ndalimit të udhëtimit, bëri që qeveria të merrte vonë masa rigorozë. Një nga qendrat e shpërthimit të pandemisë në Evropë, Ischgl në Austri, kishte nevojë për 8 ditë gjithsej për të reaguar ndaj rasteve të konfirmuara të turistëve me Korona nga Islanda dhe të mbyllte baret, liftet e skive e hotelet. Pastaj me nxitim dhe pa i testuar më parë të gjithë turistët, u nisën në shtëpi, duke e shpërndarë virusin në të gjithë Evropën. Kapacitetet e testimit të evropianëve janë të pakta, megjithëse qeveritë kishin jo pak kohë për t'u përgatitur. Madje, as personeli mjekësor nuk ka qasje të mjaftueshme në teste dhe kjo shkakton një tjetër mungesë - atë të mungesës së mjekëve dhe të infermierëve, që duhet të futen në karantinë e të presin me ditë rezultatet e testeve të tyre.

Sipas ekspertëve, kur Covid-19 sulmon, ai e kthen qelizën e pacientit në një "fabrikë virusesh". Ai e nis me sipërfaqen

e qelizës, ku virusi ngjitet në një proteinë që normalisht ndihmon për rregullimin e presionit të gjakut të pacientit. Pa dashur, qeliza e fut virusin brenda, aty ku "sulmuesi" e shkakton ngarkesën e vet dhe e nxit atë (qelizën) të prodhojë më shumë viruse. Virusi komandon mekanizmat e vetë qelizës për t'u bërë kopje e kodit të tij gjenetik, duke prodhuar më shumë viruse, e duke shpërndarë mikrobe të tëra në sipërfaqen e qelizës, gjë që çon në infektimin e më shumë qelizave të tjera.

Barnat ekzistuese në farmaci mund të vepron për të goditur pjesë të ndryshme të kësaj "makinerie". Megjithëse ato nuk janë prodhuar me qëllimin për t'u përdorur si ilaçe antivirale, në përpjekjen për të trajtuar numrin në rritje të infeksioneve me Covid-19, shkencëtarët shpresojnë se këto ilaçe mund të ofrojnë ndihmë.

PESË VJET PËR ZBULIMIN E ILAÇIT?

"Ne nuk kemi luksin e një programi pesëvjeçar për zbulimin e ilaçit. Kemi nevojë për diçka tani" - thotë Warner Greene, mjek e studiues në institutin "Gladstone" të Virologjisë dhe Immunologjisë. Kërkimet janë përqendruar tek disa ilaçe që shihen si "kandidatë" potencialë e të çuditshëm njëkohësisht, siç janë ilaçet kundër kancerit, ato ndaj sëmundjes së zemrës, një ilaç kundër skizofrenisë dhe një trajtim për sëmundjen e Parkinsonit. Aktualisht po kryhet testimi me klorokinën - një ilaç kundër malarisë.

Koronavirusi mund të jetë përhapur në Evropë që në muajin tetor. Në këtë përfundim kanë arritur shkencëtarët italianë, të cilët theksojnë se qindra pacientë u dërguan në spitale me pneumoni serioze dhe simptoma të ngjashme me gripin.

Disa prej atyre që kishin simptoma të ngjashme me Covid-19 vdiqën pas disa ditësh në spital. Eksperti i Epidemisë, Adriano Decarli, tha: "Ne duam të dimë nëse virusi ishte tashmë këtu në Itali në fund të vitit 2019 dhe nëse po - pse mbeti i pazbuluar për një periudhë relativisht të gjatë. Në këtë mënyrë do të mund të kishim një pamje më të qartë në rast se do të na duhej të përballeshim me një valë të dytë të epidemisë."


Pacientët e shtruar në spitale trajtohen me serume dhe ilaçe që e lehtësojnë gjendjen, me shpresën se trupi do t'i përgjigjet virusit, por nuk kanë ende një mjekim që prek vetë virusin. Rrethimisht, zgjidhja nga shumë shtete është gjetur tek parandalimi, pra izolimi. Këshilltari i lartë i Drejtorit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Dr. Bruce Aylward, thotë se izolimi pa testimin masiv

nuk do ta zgjidhë problemin, raporton 'Time'. Sipas tij, deri në gjetjen e vaksinës, zgjidhja është 1) zbulimi sa më parë dhe i sa më shumë të infektuarve dhe pas zbulimit 2) izolimi i rasteve të zbuluara. Aylward thekson se zbulimi mund dhe duhet të bëhet përmes kryerjes së testeve masive të popullsisë, duke ndjekur shembullin gjenial të Koresë së Jugut.

Kjo e fundit aplikoi testimin masiv dhe jo rast pas rasti, siç veprojnë sot shumë shtete, mes të cilëve Shqipëria. Testimi masiv bën që të zbulohen shumë të prekur brenda një kohe të shkurtër, duke marrë masa direkte ndaj tyre, si: izolim, vetizolim dhe trajtim në spital nëse do të jetë nevojja. Kjo i liron të tjerët që të mund të vijojnë jetën normale duke respektuar masat mbrojtëse. Aktualisht, mjaft vende po aplikojnë kufizimin e lëvizjeve, por sipas Dr. Bruce Aylward kjo nuk do të funksionojë pa testimin masiv, sepse virusi do të vazhdojë të jetë te njerëz të pakëzaminuar ende ose mund të shpërthejë një moment tjetër. Mundësia e shpërthimit të virusit në një moment të dytë, nëse aplikohen vetëm kufizimet, është konfirmuar edhe nga studiues të tjerë. "Thjesht, kufizimi i lëvizjeve të qytetarëve është si të shkelësh frenat dhe në momentin që ti heq këmbën nga frenat, do të përballësh sërish me virusin."

Pse Shtetet e Bashkuara të Amerikës po mbesin pa maska për punonjësit mjekësorë? Gjatë ditëve të fundit jemi duke shtruar pyetje, sepse mungesa e materialit mbrojtës, sidomos maskave, është duke na goditur më shumë sesa shumë absurditete neveritëse në reagimin e Amerikës ndaj pandemisë. Megjithatë, do të ishte e këndshme të kishim teste të hershme të përhapjes për koronavirus - strategjia e Koresë Jugore, që përdori për të frenuar shpërthimin e saj. Do të ishte mahnitëse nëse do të mund të shmangnim mungesën e respiratorëve dhe hapësirave spitalore, të shmangnim katastrofën që ka pllakosur Italinë. Por, asnjëra më nuk kanë peshë - në fakt, nuk është e mundur asnjë ndërhyrje e rëndësishme - nëse punëtorët e kujdesit shëndetësor nuk mund të kontaktojnë me pacientët me Covid-19 pa u sëmurë edhe vetë.

E ardhmja? Kjo krizë nuk është vetëm krizë shëndetësore, por edhe e mënyrës se si veprojmë ne me të - që nga reagimi i vonuar, deri tek efektet personale. Pritshmëria jonë ndaj krerëve politikë është që ata të sigurojnë si shëndetin, ashtu edhe lirinë tonë. Kur kjo krizë të kalojë, duhet të analizojmë se pse shkoi puna kaq larg dhe çfarë mund të mësojmë nga Singapori.



KUR NJERIU FLET ME HAMENDJE...

**Nga Myftinia e BFI-Gostivar,
Shërbimi për Informim**

Vërtet sot, në kohën tonë, gjithçka mund të ndodhë. Por, se mund të ndodhë që nga çajtoret dhe merrave të fshatit të jepen qëndrime rreth një institucioni shumë serioz, siç është Bashkësia Fetare Islame e RMV - kjo nuk na ka shkuar ndër mend, në veçanti nga një i quajtur kolumnist, preokupim i të cilit janë thashethemet.

Islam Shaqiri prej çajtores së fshatit në kolumnën e tij "Haram" po sulmon Reis'ul-Ulemanë, se gjoja merret me çështjen e Erdoanit dhe të Turqisë e të turqve, e aspak me çështjen shqiptare. Mënyra se si shkruan, tregon se është shumë i ngarkuar psikikisht; mbase i mungon siguria i të qenit shqiptar. Kjo përvojë vjen nga ata që, shpeshherë, kur dështojnë në vetvete, janë të këtitllë, mu ashtu siç komunikojnë edhe Islam Shaqiri - pa njohuri, pa logjikë, pa argumente, pa kulturë debati, me mllef; sikur dikush atij personalisht i ka ndonjë hak; i përdhosur, saqë kjo e dërgon drejt një shpifjeje të kulluar. Kjo bënë të mendojmë se sa i paditur dhe sa i painformuar është rreth çështjeve të organizimit fetar-islam, ose sa tendencioz që është.

Njihet i shkreti: njeri që nuk ia diti vlerën as besimit, as xhamisë, as prijësve fetarë. Shaqir Islamit me shkrimin e tij i ka ndodhur si fjala e urtë: "mos e vet", se tregon vetë". Shaqir Islami tregon vetë, se aspak nuk qenka i informuar as për besimin e vet, as për institucionin e vet fetar; po, bile, as edhe për imamët e vet që i ka për çdo ditë në fshat, të cilët me siguri i kanë kryer edhe shumë obligime fetare në shtëpi.

E pyesim Shaqir Islamit: Vallë, a ke qenë ndonjëherë në selinë e BFI të RMV? A ke pasur fatin dhe nderin ndonjëherë të takohesh me ndonjë personalitet të lartë fetar - të mos flasim, edhe me Reis'ul-

Ulemanë - dhe të bisedosh dhe ta njohësh konceptin bashkëkohor të tij mbi Islamit dhe kombin në përgjithësi, dhe në këtë mënyrë të njihesh me projektet e BFI-së në të kaluarën dhe sot?! Jo! Këtë e di shumë mirë. Po, a ke hyrë ndonjëherë në xhamitë e bukura të fsh. Vrapçisht dhe a ke kontaktuar ndonjëherë me imamët e këtij fshati, që kanë studiuar në qendrat më të mëdha fetare shkencore të vendeve arabe?! E, këtë nuk e dimë. Por, për nga nënçmimi që ua bën atyre, lë përshtypjen sikur nuk ke jetuar në fshatin Vrapçisht dhe sikur nuk je as njeri i xhamisë, e as njeri i konsultimit me prijësit fetarë të Vrapçishtit e më gjerë.

Vetëm diçka na brengos: ofendimi në nivelin më të ulët që ua bën atyre që kryejnë detyrën e myezinit dhe thirrjes së Ezanit. Kjo na sjell ndër mend pyetjen: mos, vallë, ke ndonjë lidhje me VMRO-DPMNE-në?! Ajo shumë pak para shkrimit tuaj bërtiti se, nëse vijmë në pushtet, hapi i parë do të jetë ndalimi i Ezanit, sepse "këtë dhunë nuk kanë mundësi ta dëgjojnë më", kanë thënë. A e di Shaqir Islami se kjo është tradhtia më e madhe që mund ta bëjë një njeri, kushdo që jetë ai?! Shaqir Islami fort mirë e di që Ezanin nuk arritën ta ndalin edhe situatat më të vështira dhe regjimet më autokratike në botë.

Jemi të vetëdijshëm se nuk ia vlen të merremi me shkrimin e tij dhe me të, po ja për hir të opinionit bëjmë me dije disa çështje, të cilat duhet t'i dijë çdo njeri që e ndjen veten mysliman:

Bashkësia Fetare Islame është institucion i vetëm dhe kompetent që e organizon jetën fetare islame në tërë territorin e BFI të RMV, me mbi një milion besimtarë shqiptarë, turq, torbeshë, romë, boshnjakë etj., e cila qëndron mbi 13 shtyllat e veta që quhen Myftini të BFI, me mbi 700 xhami dhe mbi 1.000 nëpunës fetarë.

Haxhi Sulejman ef. Rexhepi e udhëheq këtë institucion të madh me vullnetin

e të gjitha strukturave brenda BFI të RMV, institucioneve fetare, enteve dhe organizatave të saj dhe si udhëheqës në periudhën e tij për herë të parë në historinë kësaj organizate, vetëm me një urdhër, u zyrtarizua gjuha shqipe në nivel administrativ në tërë territorin e saj, edhe atë: në Kryesi, në shkollat e mesme islame, në Fakultetin e Shkencave Islame, në media dhe në shumë sfera të tjera. Të njëjtat të drejta i kanë edhe vëllezërit tanë anëtarë të BFI të RMV: turqit, torbeshët, romët, boshnjakët etj.

Sot, në kuadër të BFI të RMV janë të

organizuar mirë Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup, Medreseja Isa Beu në Shkup dhe Paralelet e Shtrira për Vajza në Shkup, Tetovë, Gostivar. Sot kemi mbi treqind studentë, dhjetëra profesorë – akademikë, mbi njëqind profesorë nëpër medresetë dhe afër 900 nxënës dhe nxënëse në procesin edukativo-arsimor. Nuk është lënë pas dore as Maqedonia Lindore, kështu që edhe atje është hapur Paralelja e Shtrirë për Djem e Medresesë Isa Beu, me qëllim të formimit të kuadrove tona për organizimin e jetës fetare islame; pastaj, organizatat e ndryshme, si: ajo "Hilal", Agjencia e Standardit Hallall etj. etj.

Sa u përket turqve, Erdoganit dhe Turqisë, dhe mllefinit që po e nxjerr kundër Reis'ul-Ulemasë vetëm pse po del në krah të njerëzve të larguar nga trojet e tyre të Sirisë, ku humbin jetën me mijëra fëmijë, gra, burra, pleq e të rinj, duke iu falënderuar shtetit turk përmes Presidentit Erdogan, ti merr të drejtën të kritikosh haptas Reisin dhe institucionin që ai udhëheq. Andaj, po të informojmë se Reis'ul-Ulemaja si i pari i institucionit fetar, mban lidhje me të gjitha shtetet ku e shef interesi: me SHBA, me ambasada të ndryshme të

shteteve në Maqedoninë e Veriut, me Shqipëri, Kosovë dhe të gjitha shtetet ku e shef interesi institucional.

Të gjykosh dhe të japësh mendim vetëm në bazë të ndonjë debati në kafene, duke pirë kafe, me siguri duke bërë shaka me një turk apo shqiptar, vërtet është akt nonsens për një njeri që thirret intelektual. Çështja e shqipes dhe e turqishtes nuk është çështje kafeneje; është çështje institucionale, e këtë Bashkësia Fetare Islame e ka zgjidhur në mënyrën më të mirë.

Në fund, z. Shaqir Islami, nëse vërtet ke pasur një fije sinqeriteti, por ke shpifur nga fakti se nuk ke pasur njohuri, andaj ne po ta falim ashtu siç kërkon Kurani famëlartë dhe Muhamedi (a. s.), i cili shpesh, edhe në momentet më të vështira, duke iu lutur Zotit, ka ditur të thotë: "Zoti im. Fali ata, se nuk dinë." Duke marrë parasysh se nuk ke njohuri për rrjedhat e Islamit dhe të Bashkësisë Fetare Islame në vend dhe jashtë, atëherë nuk je larg urdhëro në zyrat e Kryesisë, apo të Myftinisë - nëse konsideron se ato shtëpi janë edhe tuat - dhe do shohësh vetëm një të vërtetë: se sa i painformuar je rreth Islamit, e në veçanti për Reis'ul-Ulemanë, për Bashkësinë Fetare Islame dhe Myfti-


nitë e saj në përgjithësi. Në veçanti, do të njihesh edhe me projektet fetare islame në këtë nënqiell.

Vërtet, na vjen pak rëndë se humbim kohë me ju, mu në kohën kur jemi duke kontribuar në tejkalimin e krizës së koronavirusit që po rrezikon njerëzimin dhe këtë nënqiell, po ja që ne kemi konsideratë edhe për ata që nuk na njohin dhe po na fyejnë pa argumente, sado pak t'i përgjigjemi, me qëllim të informimit të tij, si dhe opinionit më të gjerë, që ndoshta i kanë lexuar të pavërtetat dhe shpifjet tuaja. Mbesim me shpresë se ju do ta zgjeroni hapësirën dhe njohuritë tuaja me kontakte, hulumtime dhe pranim të informatave burimore, sepse vetëm në këtë mënyrë do të ngriheni në nivelin për të vlerësuar veprimtarinë e ndonjë personaliteti, institucioni apo diçka tjetër.

("Koha", 31 mars 2020, https://www.koha.mk/kur-njeriu-flet-me-hamendje/?fbclid=IwAR2hZZUVU4S51A4CDSbW1Hj--1rzB0B-TRs_eGqg_ELqMMGbfSBvIBwG9Q)

Shpjegim: Të tri reagimet janë në lidhje me një shkrim të Shaqir Islamit, botuar në gazetën "Koha", Shkup, më 20 mars 2020: <https://www.koha.mk/haram/>





Nga Muzemil Osmani

REAGIME

SHTREMBËRIM I TË VËRTETËS

Nuk do të thotë që je laik në ndonjë gjë dhe tërë jetën të ngelësh i tillë, i padijshtëm, por duhet të mundohesh të mësosh diçka, apo të informohesh saktë, para se të marrësh të shkruash diçka, sidomos kur bëhet fjalë për një kategori kurranore siç është ajo e ulul-emrit (udhëheqësit të besimtarëve), sepse mund të dalësh dy herë laik.

I tillë është shkrimi i Shaqir Islamit me titull Haram, ku dëshiron të tregohet shqiptaromadhi dhe mbrojtës i vetëm i shqipes në këtë vend, duke haruar se vetë kolumnën e fillon me një fjalë në gjuhën arabe. Qenka marre, sipas jush, të shkruhet për Presidentin Erdoğan (Erdoan), të cilin Reisi në shkrimin e tij e vlerëson si një lider mysliman, por, ja, ka qëlluar të jetë turk, prandaj gjërat nuk duhen shikuar gjithmonë me syrin e laicitetit.

Keni thënë në shkrimin tuaj: "unë që lexoj bile, kaq vite nuk kam lexuar nga Ju, ndonjë rresht të vetëm për brengosjet, për hallet, telashtet, vuajtjet e shqiptarëve fukara dhe mjeranë në vendin tonë". Vërtet këtu tregoheni shumë i painformuar. Më vjen keq se s'paskëshit lexuar asgjë, por, për hir të informimit tuaj të drejtë, do t'ju jap disa informata, që herën tjetër të jeni më i informuar, se nuk duam njerëzit tanë me emër mysliman të paraqiten naivë:

Po i numëroj disa:

- Me ardhjen në krye të BFI-së të Sulejman ef. Rexhepit në vitin 1991, u zyrtarizuar gjuha shqipe në të gjitha institucionet dhe organet e BFI; ju jeni të vonshëm në këtë drejtim.
- Flamuri kombëtar shqiptar me ardhjen e Sulejman ef. Rexhepit valëvitet në të gjitha institucionet dhe organet e BFI-së – edhe atje ku shqiptarët nuk janë 20%, si p.sh.: në Manastir, Prilep, Shtip e Veles. E di që edhe për këtë nuk keni ditur gjë.
- Meqë të tangon çështja shqiptare dhe thirrsh që lexon shumë, më vjen keq t'i thuash vetes që lexon e mos ta kesh lexuar librin Shqiptarët e Maqedonisë. Ky libër është produkt i Konferencës së Parë Shkencore Mbarëshqiptare pas pavarësisë së Maqedonisë (sot: RMV), e cila është mbajtur në lokalet e Medresesë Isa Beu në Kondovë në vitin 1993. E dini kush ishte iniciues i kësaj Konference? – Sulejman ef. Rexhepi; edhe këtu jeni shumë i vonshëm...
- Vazhdojmë prapë me çështjen kombëtare. I "nderuar", sa për informimin tuaj, ligjëratat e para të Universitetit të Tetovës u mbajtën në mejtepet e xhamive; Rektorat i Universitetit ishte objekti i Bashkësisë Fetare Islame. A e dini kush ka qenë në krye të BFI-së në këtë

periudhë? – Sulejman ef. Rexhepi, i cili ishte edhe njëri ndër nënshkruarit për themelimin e UT-së; e di që edhe këtë s'e keni ditur...

Flisni se asnjëherë nuk është marrë Sulejman Rexhepi me hallet, telashtet, dertet e popullit shqiptar. I "nderuar", Reisi asnjëherë nuk bën propaganda në emër të fatkeqësive dhe telasheve të popullit tonë, por, ja erdhi radha dhe unë po i përmend disa punë të Reisit për këto çështje:

- Me ardhjen në krye të BFI-së, mbi 700 studentë deri më sot kanë marrë bursa studentore nga BFI;
- Prej vitit 2015 e deri më sot mbi 300 të sëmure janë kuruar jashtë vendit me iniciativë të Sulejman ef. Rexhepit; edhe këtë s'e keni ditur...
- Mos t'i harrojmë ndihmat humanitare, permanente, për familjet me gjendje të rëndë ekonomike...

Reisi asnjëherë nuk është i mendimit që me hallet e kësaj shtrese të bëhen propaganda mediatike...

Prandaj, i "nderuar", që shumë keni lexuar, më duket se s'paskeni lexuar sa duhet. Ju ndoshta nuk i lexoni as reagimet, as kolumnat e as opinionet e Reisit, as veprat e tij (janë shumë!), të cilat flasin edhe sot dhe do të flasin në çdo mot. Po ua përmend shkarazi vetëm kompletin e veprave të tij "Për Fe e Atdhe", që u promovua para do kohe e që u vlerësua nga personalitete të shquara si një kontribut i çmuar shumëvjeçar në drejtim të sensibilizimit të çështjes mbarëshqiptare.

Të gjithë njohësit e çështjeve fetare thonë se Maqedonia e Veriut është vendi ku është ruajtur më mirë Islami burimor, autokton, prandaj ju nga laiciteti juaj mund të fajësoni edhe veten tuaj se nuk e njihni mirë. E keni tollovitur shkrimin, duke u futur në një lumë prej të cilit me të vërtetë s'dini as vetë si të dilni. Karakamishevës, ndërkaq, moti i është treguar rruga në lidhje me Ezanin, kështu që ju, në këtë drejtim, jeni shumë i vonshëm...

Në fund të këtij reagimi, po ju pyes: si mendoni, pse është dekoruar Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi me dekorime të shumta, të cilat nuk i bëjnë nder vetëm atij personalisht, po të gjithë neve?! Po ju përkujtoj se Reisi është i dekoruar nga Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta, nga ai i SHBA Donald Trump, nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK, është shpallur Ambasador për Paqe Globale...

("Koha", 27 mars 2020, <https://www.koha.mk/shtremberim-i-te-vertetes/?fbclid=IwAR3pf0ZwmYgDeR0tEWIhIpTWjqODLs3UKbHdhm4USYctuiyN7mP33dx4Cf8>)



Nga Qufli Osmani

ÇDO PERSON ME MJEKËR NUK ËSHTË EDHE BABA

Nga Shaqir Islami kam lexuar edhe më herët shkrime, nga të cilat përfitohet përshtypja se ai është një njohës i mirë i çështjeve që i tangojnë shqiptarët e këtij nënqielli, por shkrimi i tij me titull "Haram", jo vetëm që ma zbehu përshtypjen time për të, por po ashtu më bëri që sinqerisht të ndihem keq për atë se në çfarë situatë është ai me bashkëfshatarët e tij të përkatësisë turke dhe sa i painformuar qenka një intelektual shqiptar rreth kontributit të Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi për kauzën shqiptare, jo vetëm te ne.

"Fërkimet" që po bëhen nëpër çajtoret e f. Vrapçisht, në mes shqiptarëve dhe turqve, edhe pse të izoluar, ato janë rezultat i ish-sistemit, që sa më shumë t'i përcajë dhe t'i hasmërojë mes vete myslimanët, respektivisht shqiptarët si etnikum më i madh me përkatësi islame, me myslimanët e etnikumeve më të vogla, në këtë rast me turqit. Kjo është një fushatë mirë e planifikuar nga armiqtë e vërtetë të popullit shqiptar - vetëm e vetëm t'i realizojnë apetitet e tyre. Në këtë drejtim sugjeroj që të lexoni publikimet e shumta të ish-ambasadorit të Shqipërisë në OKB, Abdi Baleta, prej nga do t'i kuptoni më së miri raportet e vërteta ndëretnike të rajonit ballkanik, por edhe më gjerë.

Sa i përket shastisjes së tij nga leximi i kolumnës "El-Feth" të Reis'ul-Ulema së BFI-së, atë do ta krahasoj me punën e katër qorrave me elefantin, të cilën vetë Shaqir Islami, para do ditësh, në një shkrim të tij me titull "Katër qorrat dhe elefanti", na e përkujton për të krahasuar punët qorre të politikanëve tanë.

Por, ja që shastisja e tij me kolumnën "El Feth" të Reis'ul-Ulema së BFI-së përngjan si puna e qorrave, të cilët përmes të prekurit duan ta përshkruajnë qenien e elefantit. Ai që ia kap "surlen", vjen në përfundim se elefanti është gjarpër; ai që ia prek njërin këmbë, elefantin e përshkruan si një pemë; e kështu me

radhë, sipas perceptimit, përmes prekjes, kanë dhënë mendimin e tyre se si mund të jetë elefanti. Pra, edhe Shaqir Islami, me leximin e një kolumne të Reis'ul-Ulema së BFI-së, që ka të bëjë me politikën e shtetit turk lidhur me konfliktin në Siri dhe refugjatët sirianë, vjen në përfundim se Reisi qenka në anën e turqve!

Një vlerësim i tillë e shtyn atë që mllefin ndaj bashkëfshatarëve të vet turq ta adresojë te Reis'ul-Ulema i BFI-së, me pretekstin se ai nuk merret me problemet e shqiptarëve, por me ato të Turqisë. Ndoshta preokupimi me "muhabetet" nëpër çajtoret e Vrapçishtit nuk e ka lejuar Shaqir Islamit t'i lexojë kolumnat e Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, të cilat janë të shumta në numër dhe që prekin çdo ngjarje dhe dukuri - qoftë ajo të jetë vendore, rajonale apo botërore.

Ndoshta pikërisht për këtë është i paditur se roli i një lideri fetar islam është që, pos tjerash, t'i përcjellë me vëmendje të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me një pjesë të ummetit - me këtë rast me refugjatët sirianë - të cilëve askush nuk u ndihmon, përpos Turqisë.

Ndoshta për këtë ka mbetur i painformuar se kontributi i Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi në shqiptarizimin e kësaj bashkësie është tejet i madh dhe i dukshëm. Ardhja e tij në krye të BFI-së bëri që mësimi në Medresenë Isa Beu të zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe, bëri që në mbledhjet e organeve dhe të strukturave të BFI-së të debatohet shqip, bëri që gjuha shqipe të jetë gjuhë e administratës, bëri që gazeta e BFI-së nga "Mllada Meseçina" të botohet vetëm në gjuhën shqipe, me emrin shqip "Hëna e Re". Me një fjalë, e ndaloi "limanovskizimin" e BFI-së.

Ndoshta për këtë (Shaqir Islami) nuk ka mundur t'i përcjellë reagimet që vinin nga Kongresi Botëror Maqedonas, nga individë si Todor Petrovi, nga ASHAM, si dhe të "përfaqësuesve" turq, boshnjakë

e romë, të cilët, të nxitur nga politika e organeve shtetërore, i janë kundërvënë Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi me akuza të ndryshme, që aludonin në shqiptarizimin e BFI-së nga ana e tij.

Ndoshta për këtë nuk ka mundur të mbajë mend se Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi ishte i vetmi që haptazi iu kundërvu vrasjeve të shqiptarëve në shërbimin ushtarak të ish-Jugosllavisë, ku këtë fat makabër e pati edhe një i ri nga f. Vrapçisht.

Ndoshta për këtë nuk ka mundur ta dëgjojë zërin e Reis'ul-Ulema së të ngritur kundër padrejtësive të mëdha që u bëheshin shqiptarëve në emër të demokracisë gjatë periudhës së tranzicionit në fushën e arsimit, kulturës etj.

Ndoshta për këtë nuk ka mundur të ketë informatë për atë se Reis'ul-Ulema sa studentëve shqiptarë u ka dhënë dhe u jep bursa për të studiuar shkencat ekzakto; sa e sa tubime, konferenca shkencore, janë mbajtur nën patronazhin e Reis'ul-Ulema së BFI-së; sa e sa vepra shkencore janë botuar me iniciativë të tij – të gjitha këto në të mirë të popullatës sonë.

Sa i përket kënaqësisë apo melodisë së Ezanit, ajo nuk varet vetëm nga myezinët, por para së gjithash varet nga ai që e dëgjon. Sepse, veshët që nuk e pranojnë Selamin, nuk mund ta shijojnë Ezanin!

Sidoqoftë, në Islam gjithnjë ka vend për përmirësim, tolerancë, mirëkuptim dhe besoj se kjo mund të arrihet edhe në f. Vrapçisht; kuptohet, nëse parimeve islame u jepni përparësi ndaj inateve lokale, të cilat në kohë të fundit nxiten edhe nga subjektet politike. Të mos japim gjykime në shikim të parë, sepse siç thotë një fjalë e urtë: "Çdo person me mjekër nuk është edhe baba".

("Koha", 29 mars 2020, https://www.koha.mk/cdo-person-me-mjeker-nuk-eshte-edhe-baba/?fbclid=IwAR34_LJjIV3liSz4_T0BvTZUT7HSMTCrHRywyFPiwEpKXrVHjinx_m_dI)

”

MUKI PRAPË U BË REZIL

Nga Muzemil Osmani

Muki prapë u lajmërua me ofendime dhe, definitivisht, po dëshmon se ai nuk ka ndonjë rol dhe detyrë tjetër në partinë e tij përveçse të ofendojë shqiptarët që nuk i shkojnë për qejfi; në mesin e tyre, edhe Reis'ul-Ulemanë dhe Bashkësinë Fetare Islame në përgjithësi.

Kësaj here qenka marrë me Reisin duke i shkëputur një deklaratë nga një intervistë, të cilën ai e kishte dhënë në një emision televiziv, e cila kishte të bënte me ndihmesën që shteti gjithsesi duhet t'ua ofrojë edhe Bashkësive Fetare, pra edhe

BFI-së, në këto kohë të rënda të luftës kundër pandemisë Korona, e cila po e dëmton rëndë edhe organizimin e jetës fetare.

Ky deputet i mëparshëm, që nuk po dihet se kujt po i shërben me deklaratat e veta të pamatura, e bëri rezil veten, por edhe partisë së cilës i takon, së cilës po i bën dëme të cilat do t'i kthehen bumerang, sepse opinion ynë nuk i harron dhe nuk i fal sjelljet e pakontrolluara të dikujt që mbahet shumë i guximshëm e që është frikacak deri në palcë.

Të sulmohet e të ofendohet Reis'ul-Ulemaja për asgjë në këto ditë kur ai po bën çmos për t'u ndihmuar besimtarëve myslimanë dhe të gjithë të tjerëve në çdo

formë të mundur, nuk është asgjë tjetër përveçse paturpësi e cila buron nga urrejta të cilën Muki e mban në vete vite me radhë. Ofendimet që po i bën ai flasin për edukatën e tij, por edhe për karakterin labil, pa kurriz, të cilin po e shfrytëzojnë ata të cilët kanë nevojë për atë.

Ky njeri po e merr dhe do të marrë përgjigjen e duhur nga besimtarët myslimanë dhe nga i tërë opinionin shqiptar të cilin ai po dëshiron ta manipulojë me paturpësinë e vet. Historia shqiptare do ta radhit në listën e Halit Ternocit, Rahman Morinës e Esat Pashës.

Tung e ki'.

(9 prill 2020)


REAGIM

Në lidhje me ofendimin e rëndë me fjalor të pistë, që iu bë Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi nga M. Zeqiri, ish-deputet i Parlamentit të RMV, Myftinia e BFI - Gostivar shpreh indinjatë të thellë, për shkak se këtë ofendim e kupton si atak kundër BFI të RMV, organeve të saj dhe besimtarëve në përgjithësi.

Myftinia e BFI – Gostivar, megjithatë, ndjen nënçmim të nivelit të ulët të polemizojë me individë me kulturë injorante dhe të pistë dhe ky turp i papërshkrueshëm që po i ndodh M. Zeqirit është i pafalshëm moralisht dhe i paharrueshëm.

BFI e RMV dhe organet e saj vazhdojnë rrugëtimin e tyre si çdoherë, duke i kontribuar të mirës së përgjithshme të kësaj shoqërie.

Shërbimi për Informim i Myftinisë së Gostivarit
(10 prill 2020)



KORONAVIRUSI DHE VIRUSET E VEGJËL PA DINJITET



Nga Salim Sulejmani

Njeriu si krijesa më e dashur e Zotit shpesh në këtë jetë gjendet përballë sfidave dhe sprovave të ndryshme. Sot njeriu gjendet përballë një sprove të madhe që ka kapluar çdo vend në rruzullin tokësor. Atij i duhet të përballë dhe të dalë fitimtar përballë virusit Korona, që është sprova më e madhe e çdo vendi dhe çdo populli sot.

Kësaj nuk i shpëtoi as vendi dhe myslimanët e këtij vendi. Kur shteti ynë mori masa të ndryshme për t'u përballur me këtë pandemi, Institucioni më i lartë fetar në RMV, Bashkësia Fetare Islame, Haxhi Reisi Sulejman ef. Rexhepi, bashkë me myftinjët, ishte nga të parat që mori masat dhe bëri thirrje që njerëzit të respektojnë rekomandimet e institucioneve dhe të

ruajnë veten dhe të tjerët. Këto vendime nuk ishin të lehta, sepse për myslimanët të largohesh nga xhamia, të mos shkosh të falësh xhumanë dhe të ndahesh nga xhemati, është shumë pikëlluese.

Përveç kësaj, Bashkësia Islame e RMV me mundësitë e saj u solidarizua me spitalet e qyteteve të ndryshme, duke u dhuruar maska mjekësore.

Të gjitha këto masa dhe vendime u morën duke pasur për bazë Kuranin fisnik, i cili na mëson se të shpëtosh një jetë njeriu është sikur të shpëtosh gjithë njerëzimin.

Të gjitha këto vendime dhe masa kanë edhe koston e tyre ekonomike. Institucionet shtetërore marrin masa edhe në këtë aspekt, që sadopak të zbusin krizën ekonomike gjatë luftës me këtë pandemi.

Është shumë e drejtë që edhe Bashkësia Islame që pas ndalimit të aktiviteteve të saja të kërkojë të përfshihet dhe të ndihmohet nga shteti për të kaluar këtë krizë, e cila njerëzimin e ka vendosur përballë një sprove të madhe.

Është e dhimbshme të shohësh se në këtë kohë të kësaj pandemie dalin viruse të vegjël dhe njerëz pa dinjitet që sul-

mojnë gjithmonë Bashkësinë Islame dhe kryetarin e saj. Ai njeri nuk është hera e parë që sulmon Institucionin fetar të myslimanëve. Si duket ai, edhe pse deputet dhe nënkryetar i partisë në pushtet, nuk merret me punën e tij për ta përmirësuar jetën e qytetarëve, po shpif dhe sulmon Bashkësinë Islame. Sikur nuk di gjë tjetër dhe sikur të këtë vetëm këtë vazife.

Por, nuk ka vend për pesimizëm: njerëzimi do ta fitojë këtë sprovë, do ta fitojnë edhe qytetarët e këtij vendi.

Jemi në prag të muajit të bekuar të Ramazanit, muaj kur Allahu i madhërishtëm lëshon mëshirën e madhe të Tij mbi njerëzimin. Kjo pandemi do të ngelë vetëm një nga sprovat me të cilat Allahu i madhërishtëm na fton t'i kthehemi Atij dhe të fitojmë mëshirën e madhe që ka garantuar për durimtarët. Ndërsa deputeti në fjalë edhe më tej do të ngelë vetëm një virus që sulmon kohë pas kohe Bashkësinë Islame dhe kryetarin e saj. Shpifjet dhe sulmet e këtij virusi nuk do t'i bëjnë dëm institucionit të lartë fetar, por vetë ai do të turpërohet, siç ka ndodhur gjithmonë.

(9 prill 2020)

ALLAHU NUK E DO ÇRREGULLIMIN (FESADIN)



Në krye të ndotjes së ambientit dhe të prishjes së ekuilibrit ekologjik sot shihet prirja e pandalshme për shtim ekonomik, si dhe prirja për shkapërderdhje dhe për harxhim të tepruar e të kotë; shpeshherë të pakuptimtë. Aty qëndron egoizmi i stërtheksuar individual dhe kolektiv. Njerëzit sot sikur po garojnë me njëri-tjetrin në harxhime të kota dhe këtë e shohin edhe si virtyt, apo si shenjë të ngritjes dhe të prosperitetit. Ndërkaq, njerëzimi sa është duke e paguar tani për tani çmimin e rëndë të kësaj plangprishjeje, aq më shumë do ta paguajë edhe në të ardhmen.

**Shkruan: Rejhan Neziri
(Enkas për Her)**

Fesadi nënkupton prishjen e një rendi, pengimin e funksionimit normal të tij dhe dëmtimin duke e zhdukur të dobishmen brenda tij. Fesadi është një çrregullim që është rezultat i një qëllimi të keq, të vetëdijshëm, për të shkakuar dëm. Lidhur me këtë Kurani fisionik thotë: “Ka ndonjë nga njerëzit që

ffjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (pse në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat), dhe për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet Allahun dëshmuar, e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë. E posa të kthehet, ai në tokë ngarend të bëjë shkatërrim në të, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin).” (el-Bekara, 2:204-205) Në këtë ajet flitet për një mendësi, mentalitet të dëmshëm që ma-

nifestohet, madje, edhe si formë kulture, jo vetëm si një reagim i atypëratyshëm personal i një njeriu të çorientuar, në shkatërrimin dhe shkretimin e natyrës në përgjithësi dhe të ambientit në veçanti. Në qoftë se e kemi parasysh fatkeqësinë me të cilën ballafaqohet sot njerëzimi në fushën e shëndetit dhe të të ushqyerit, besoj se vërejtja që shprehet te ky ajet kuranor mund të kuptohet më lehtë dhe më qartë. Në një kohë kur thajse gjithçka po

dhmen. Porosia kuranore “hani dhe pini, por mos e teproni, se Allahu nuk i do tepruesit!” (el-A’raf, 7:31), ofron jo vetëm një parim ekonomik, por para së gjithash etik, që përfshin të gjitha fushat e veprimtimit njerëzor; në rastin tonë konkret, në ruajtjen e mesatares, të ekuilibrit e të baraspeshës ekologjike. Ruajtja e mesatares dhe kujdesi për të në Islam fiton karakterin e një filozofie jete. Porosia tjetër kuranore e përforcon akoma më shumë këtë që thamë: “Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfrit, edhe atij në vend të huaj, po mos shpenzo tepër e pa rrugë. Ata që shpenzojnë tepër (mastrofshinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të Tij.” (el-Isra’, 17:26-27) Këto dy ajete, kujdesin për tjetrin e ngrënë në detyrë parësore fetare dhe këtu nuk bën pjesë vetëm kujdesi për barkun e tyre, por edhe për mushkëritë e tyre, për sytë e tyre, për veshët e tyre, me një fjalë: për jetën e tyre. Shpenzimi i tepërt, vend e pavend, ndikon drejtpërsëdrejti në realizimin e detyrës së kujdesit ndaj tjetrit. Teprimi në të mirat materiale, shihet si ves joetik, si punë djallëzore. Kjo mund të çojë në një stad ku njeriu nis ta harrojë pozitën e vet reale në këtë univers, nis ta shikojë veten të pavdekshëm, të amshueshëm, sepse në bazë të të mirave materiale që ka dhe të cilat ai i konsideron si të pashtershme, i japin atij mundësinë që edhe jetën e tij ta shikojë të pashtershme. Tipin e njeriut të këtyllë Kurani e përshkruan kështu: “Mjerë për atë që ka tubuar pasuri dhe që e ruan atë (për ardhmërinë e endërruar) dhe që mendon se ajo pasuri do ta bëjë atë të pavdekshëm.” (el-Humezeh, 104:2-3) Në momente shtërngimi, ky nuk do të ngurrojë të mos e shkelë tjetrin, vetëm e vetëm të arrijë të “pavdekshëmëria” e tij. Ndërkaq, besimtarin e mirëfilltë Kurani e përshkruan si njeri të qetë e të matur: “E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë... edhe ata që kur shpenzojnë, nuk e teprojnë e as nuk janë dorështrënguar, po mbajnë mesataren e janë të matur.” (el-Furkan, 25:63, 67)

bëhet artificiale dhe po del nga natyra dhe natyrshmëria e vet përmes ndryshimit apo ndërhyrjes njerëzore në hormonet e tyre, njeriu dhe mbarë njerëzimi po e shikon i zhgënjyer dhe i pafuqishëm tatëpjetën e tij drejt një humnerë të përbashkët.¹

Në krye të ndotjes së ambientit dhe të prishjes së ekuilibrit ekologjik sot shihet prirja e pandalshme për shtim ekonomik, si dhe prirja për shkapërderdhje dhe për harxhim të tepruar e të kotë; shpeshherë të pakuptimtë. Aty qëndron egoizmi i stërtheksuar individual dhe kolektiv. Njerëzit sot sikur po garojnë me njëri-tjetrin në harxhime të kota dhe këtë e shohin edhe si virtyt, apo si shenjë të ngritjes dhe të prosperitetit. Ndërkaq, njerëzimi sa është duke e paguar tani për tani çmimin e rëndë të kësaj plangprishjeje, aq më shumë do ta paguajë edhe në të ar-

njeri e di se çka ka punuar dhe çka ka lënë prapa!...” (el-Infitar, 82:1-5) Dëmet marramendëse që i shkaktojnë ambientit shpërthimi i centraleve bërthamore, si ai në Çernobil në vitin 1986, armët biologjike dhe kimike, madje vetëm provat e funksionimit të këtyre armëve në dete e oqeanë, qysh sot ta përkujtojnë skenën e tmerrshme të Kiametit të Madh.ⁱⁱ

Ndotja e mjedisit është pasojë e pashmangshme e veprimeve të njeriut që e ka humbur kuptimin e ekzistimit të tij. Ajetet e mësipërme kuranore na bëjnë me dije se ndotja dhe harxhimi material i ambientit, në fakt, është pasojë e një ndotjeje shpirtërore që lind nga largimi prej vlerave universale etike. Në mos qentë pasojë e saj, së paku ka një lidhshmëri të fuqishme midis të dyjave, pra ndotjes fizike të ambientit dhe ndotjes shpirtërore të njeriut. Vetëdija më e fuqishme e kontrollit në ruajtjen e bukurive natyrore dhe të të gjitha qenieve në natyrë është vetë ndërgjegjja e njeriut. Ai duhet të arrijë të kuptojë plotësisht dhe me vetëdije të thellë se ndotja e ambientit është mëkat te Zotit, është kundërvajtje nga aspekti juridik, dhe është turp, si dhe ngrënie e hakut të të gjithë njerëzimit. Ajo që do ta kontrollojë shoqërinë, respektivisht individin, është sistemi i vlerave të mbështetura në Qenien tejfizike. Natyrisht që është e pamjaftueshme që këtë temë ta lidhim vetëm për vetëdijen, ndërgjegjen dhe kontrollin personal të individit. Për t’u realizuar kjo, nevojiten gjithësi edhe organizatat publike dhe sociale dhe sisteme të fuqishme kontrolli.ⁱⁱⁱ

AMBIENTI NË JETËN DHE PRAKTIKËN E MUHAMEDIT (A. S.)

Në studimet e jetës dhe veprimtarisë së Muhamedit (a. s.) shpeshherë shumë aspekte të jetës së tij ngelen në hije, pa u studiuar mirë. Një prej këtyre aspekteve është edhe kujdesi që ai ka treguar ndaj ambientit. Shumëkush, sipas kësaj, mund të pyet me habi se çfarë mund të ketë thënë dhe bërë Muhamedi (a. s.) në shkretëtirë, për çfarë ambientit dhe ekologjive mund të flitet në shek. VII në shkretëtirat e Arabisë?! Mirëpo, studimi më i thellë dhe, në veçanti, nga një këndvështrim ekologjik i jetës dhe i praktikës së tij, do të na habit me bagazhin e madh dhe të mahnitshëm të fjalëve e veprave të tij në këtë drejtim. Lirisht mund të pretendojmë se ai ka qenë një ambientalist i madh dhe pas vete ka lënë një trashëgimi që mund të quhet “sunnet ekologjik”. Me këtë term nënkuptohet dashuria e Muhamedit (a. s.) ndaj qenieve

të gjalla dhe ndaj natyrës si dhe tërësia e fjalëve dhe e veprave të tij në kontekst të ruajtjes së natyrës dhe të gjallesave të tjera në të.^{iv}

Hadithet e Muhamedit (a. s.) lidhur me mjedisin, si dhe këndvështrimin e tij ambientalit, do të mundohemi ta analizojmë në disa nëntituj:

MOTIVIMI PËR VEPRA TË MIRA

Mendësia që mëtohet të ofrohet në shkallë të parë nga hadithet në raportin njeri-mjedis, është përvetësimi i mënyrës së jetesës së njeriut brenda së mirës dhe së bukurës kundrejt mjedisit. Njeriu që e pranon këtë mënyrë jetese, do të jetë konstruktiv kundrejt mjedisit të tij dhe në çdo rast do të mundohet të veprojë drejt; madje edhe do të ndjejë kënaqësi nga ky veprim. Në rastet kur nuk do të bëjë mirë, ose kur nga pakujdesia do të përzihet në të këqij, ai shpirtërisht do të ndjehet i mërzitur dhe i shqetësuar. Një mysliman, i cili edhe nga ky prizëm e merr shembull Muhamedin (a. s.), do të krijojë një jetë dhe një personalitet të mbështetur në të mirën dhe në të bukurën.

Ja disa nga thëniet e Muhamedit (a. s.) në këtë drejtim:

“Ka thënë Allahu fuqplotë: Kush niset të bëjë një vepër të mirë dhe nuk arrin ta bëjë, do t’ia regjistroj si një të mirësi. Kush niset të bëjë një vepër të mirë dhe e bën atë, do t’ia regjistroj atij nga dhjetë deri në shtatëqind fish më shumë...”^v

“Çdo vepër e mirë quhet sadaka (lëmoshë)”^{vi}

Një beduin e pyeti Muhamedin (a. s.): “Cili është njeriu më i mirë, o i dërguar i Zotit? Ai u përgjigj: Ai që rron gjatë dhe bën vepra të mira.”^{vii}

“Imani (besimi) përbëhet nga gjatëdhjetë e ca, ose shtatëdhjetë e ca pjesë. Më e larta dhe më e vlefshme është fjala e dëshmisë se s’ka Zot tjetër pos Allahut, kurse më e pakta, më e ulëta (pjesë e besimit) është largimi i një pengese nga rruga. Edhe turpi është pjesë e imanit.”^{viii}

“Mua m’u prezantuan veprat e umetit tim, të mirat dhe të këqijat. Ndër veprat e mira e pashë largimin e një pengese nga rruga, kurse ndër veprat e këqija e pashë pëshlymën (këlbazën) e hedhur në tokë dhe të pambuluar me dhë.”^{ix}

“Një njeri e pa në rrugë një dru (degë, ferrë) që u pengonte njerëzve dhe e largoi mënjane. Për këtë edhe hyri në Xhenet.”^x

Tregon Ebu Berzah, se ai e ka lutur



Muhamedin (a. s.): “Mësomë diçka të dobishme, o i dërguar i Zotit! Ai më tha: *Largoji pengesat nga rruga ku ecin myslimanët (njerëzit)*!”^{xi}

Të kësaj natyre ka edhe shumë hadithe të tjera. Të gjitha këto kanë një synim: krijimin e qëllimit të mirë në qenien njerëzore, si dhe gatishmërinë për të krijuar një botë, një mjedis dhe një ambient më të mirë, më të bukur, më të këndshëm dhe më të jetueshëm, që ta përkujton Xhenetin.

MJEDISI SI “VLERË E PËRBASHKËT”

Muhamedi (a. s.) në një rast ka thënë: *“Myslimanët janë ortakë në tri gjëra: kullosë, ujë dhe zjarr.”*^{xii} Pra, këto tria janë pronë e përbashkët e të gjithë banorëve të një vendi. Edhe pse ky hadith, në të drejtën klasike islame, është trajtuar nga aspekti i pronës private dhe publike, ne mendojmë se ky hadith ka përmasa

akoma më të gjera se kaq, madje globale. Me këtë nuk bëhet fjalë vetëm për ujin e natyrshëm të burimeve, të lumenjve, të liqeneve etj., jo vetëm për kullosat dhe gjelbërimet që kanë mbirë vetvetiu e që nuk janë mbjellë nga dora njerëzore dhe jo vetëm për burimet e zjarrit e të energjisë siç janë drutë, xehet, nafta, gazi natyror etj., si prona të përbashkëta të të gjithë banorëve të një vendi, por, për më tepër, këtu bëhet fjalë për mbjelljen e një vetëdijeje për vlerat e përbashkëta njerëzore. Rrjedhimisht, ajo që është vlerë e përbashkët, nënkupton edhe përgjegjësinë e përbashkët për ruajtjen e saj. Parimet universale që mund të nxirren nga ky hadith janë me sa vijon: 1. Këto burime dhe vlera të përbashkëta (uji, kullosa dhe zjarri/energji) duhet t’u sigurohen të gjithëve. Askush dhe asnjë gjallesë nuk guxon të privohet nga këto. Në një hadith Muhamedi (a. s.) ka thënë: *“Tre vetave Allahu nuk do t’u flasë në Ditën e Gjykimit, nuk do t’i pastrojë (falë) ata dhe ata do të përjetojnë dënim të dhembshëm: i pari është ai që zotëron ujë të tepruar dhe nuk i jep udhëtarit...”*^{xiii}; 2. Këto burime dhe vlera duhet të përdoren drejt, me masë dhe në mënyrë të baraspeshuar. Në Medinë pusi Rume i takonte një çifuti, i cili myslimanëve ujin ua shiste me çmim të lartë. Muhamedi (a. s.) tha: *“Kush ia blen pusin këtij çifuti, nesër në Xhenet do të ketë një pus të këthillë.”* Doli Osmani (r. a.), e bleu me paratë e veta dhe e falë vakëf (pronë publike). Lidhur me këtë Muhamedi (a. s.) tha: *“Sa mirësi të bukur ka bërë Osmani!”*^{xiv} Në një rast tjetër doli një zënkë midis Zubejrit (r. a.) dhe një banori të Medinës lidhur me ujitjen e hurmave. Me këtë rast Muhamedi (a. s.) i tha Zubejrit: *“O Zubejr, ujiti hurmat tua dhe pastaj lëshoje ujin të rrjedhë te fqinji yt!”*^{xv}; 3. Këto burime dhe vlera duhet të vihen në shërbim të të gjithëve. Siç do të shohim edhe më vonë, Pejgamberi (a. s.)

i ka dhënë rëndësi të madhe gjelbërimit, pyllëzimit, por në radhë të parë punimit të tokës djerr; ai ka ndaluar djegien e natyrës dhe të kafshëve apo të insekteve; ai ka ndaluar prerjen pa arsye të drurëve etj. Në një rast Muhamedi (a. s.) vërejti se dikush pa arsye e kishte prerë një dru lotusi. I zemëruar shumë, tha: *“Kush e ka prerë këtë dru, Allahu e përmbystë në Xhehenem!”*^{xvi} Të tria këto dhe të ngjashmet me këto duhet të lihen në shërbim të të gjithëve, në mënyrë që të gjithë mund t’i gëzojnë këto begati të Zotit dhe askush të mos krijojë monopol mbi këto vlera dhe pasuri të përbashkëta. Siç kujdesemi që këto t’i ruajmë e t’i kultivojmë për vetvete, të njëjtën ta mendojmë edhe për të tjerët.^{xvii}

i ka dhënë rëndësi të madhe gjelbërimit, pyllëzimit, por në radhë të parë punimit të tokës djerr; ai ka ndaluar djegien e natyrës dhe të kafshëve apo të insekteve; ai ka ndaluar prerjen pa arsye të drurëve etj. Në një rast Muhamedi (a. s.) vërejti se dikush pa arsye e kishte prerë një dru lotusi. I zemëruar shumë, tha: *“Kush e ka prerë këtë dru, Allahu e përmbystë në Xhehenem!”*^{xvi} Të tria këto dhe të ngjashmet me këto duhet të lihen në shërbim të të gjithëve, në mënyrë që të gjithë mund t’i gëzojnë këto begati të Zotit dhe askush të mos krijojë monopol mbi këto vlera dhe pasuri të përbashkëta. Siç kujdesemi që këto t’i ruajmë e t’i kultivojmë për vetvete, të njëjtën ta mendojmë edhe për të tjerët.^{xvii}

RËNDËSIA E PASTËRTISË

Për secilin është e njohur se ç’rëndësi ka pastërtia në jetën personale dhe sho-

qërore të njeriut, por jo vetëm të tij. Nga këndvështrimi islam, koncepti i pastërtisë përbën tërësinë e pastërtisë shpirtërore dhe materiale; këto janë të pandashme. Pastërtia e shpirtit nënkupton largimin e mendimeve dhe të veseve të këqija e djallëzore. Një shpirt i pastër, një mendje e kulluar dhe një karakter i brumosur me vlera e virtyte, nuk mund të paramendohet t’i bëjë keq njeriut, shoqërisë, mjedisit dhe natyrës. Prandaj edhe Islami i jep përparësi në radhë të parë kësaj pastërtie, e cila përbën edhe lëndën e ahmakut, apo të moralit islam. Ngjitas dhe pandashëm me këtë është pastërtia trupore, e teshave, e banesës apo e shtëpisë, e oborrit, e mëhallës, e fshatit, si dhe e rrethit ku banon dhe jeton ai. Ky është një zinxhir i pashkëputshëm i cili, thamë, zanafillën e ka në zemrën dhe shpirtin e njeriut. Një shpirt i kalitur me vlera të larta fisnike nuk e duron dot papastërtinë, bërllokun, përlyerjen dhe ndotjen. Këto e lëndojnë atë në shpirt, fillimisht. Krahas pastërtisë shpirtërore, Muhamedi (a. s.) i ka dhënë rëndësi të veçantë edhe asaj materiale, trupore, fizike, mjedisore. Vetë kryerja e ritualeve fetare si: namaz, agjërim, haxh etj. janë të kushtëzuara me pastërtinë trupore, të teshave dhe të vendit ku këto rituale do të kryhen. Për t’u lutur pesë herë në ditë, parakusht është avdesi, pastrimi me ujë i pjesëve të trupit të cilat në jetën e përditshme janë më tepër në kontakt me gjërat që mund ta ndotin trupin, apo petkun e njeriut. Muhamedi (a. s.) ka thënë: *“Çelësi i namazit është pastërtia...”*^{xviii} Një ditë Muhamedi (a. s.) tha: *“Ai që në zemrën e tij ka sa një thërrime kryelartësi e arrogancë, nuk do të hyjë në Xhenet.”* Njëri nga të pranishmit i tha: “Njeriu ka dëshirë të veshë tesha të bukura, të mbathet bukur (a quhet edhe kjo kryelartësi?).” Muhamedi (a. s.) iu përgjigj: *“Allahu është i bukur dhe e do bukurinë. Kryelartësia nënkupton përçmimin e së vërtetës (nga vetë mendjemadhësia) dhe përbuzjen e njerëzve.”*^{xix}

Sipas kësaj, myslimani i vërtetë është një njeri i pastër në shpirt, i pastër në trup e në veshje, i pastër në vendin ku jeton dhe vepron; ai është një njeri të cilit nuk i ka hije e kundërta e kësaj. Sigurisht që ai prijte të jetojë në një botë të pastër materialisht me ujin, me ajrin, me tokën dhe me rrethin; të pastër shpirtërisht me shoqërinë e tij, me botën e tij shpirtërore dhe morale.^{xx}

Muhamedi (a. s.) aq shumë rëndësi i ka dhënë pastërtisë fizike, saqë ka urdhëruar që myslimani më së paku një herë në javë të bëjë banjë^{xxi}, t’i presë



thonjtë, t'i rruajë qimet nën sjetull dhe te vendet e turpit, t'i shkurtojë mustaqet^{xxii}, t'i lajë duart para dhe pas buke^{xxiii}, ta ruajë pastërtinë e gojës dhe të dhëmbëve duke e përdorur *misvakun* (lloj brushe nga druri)^{xxiv}...

Në shumë hadithe të Muhamedit (a. s.) flitet për rëndësinë e ruajtjes së pastërtisë së ujit dhe të pushimoreve të njerëzve. Kështu, ai ka thënë: *"Ruhuni nga dy sende që shkaktojnë mallkimin! E pyetën: Ç'janë ato, o i dërguar i Zotit? Ai tha: Të kryesh nevojën (fiziologjike) në vendkalimet e njerëzve, ose nën hijet e pemëve (ku pushojnë njerëzit dhe bagëtia)"*^{xxv}. Ai po ashtu ka kërkuar që vathët e kafshëve të vendosen larg burimeve apo rrjedhave të ujit^{xxvi} dhe e ka ndaluar urinimin sidomos në ujin që nuk rrjedh.^{xxvii} Për fat të keq, sot sa e sa lumenj, liqene, dete dhe brigje të tyre po ndoten fillimisht nga rrjedhat e kanalizimeve, nga ujërat e zeza të fabrikave, nga nafta që rrjedh a derdhet nga anijet-cisternë, nga testimet e armëve të ndryshme kimike, biologjike e nukleare në dete e oqeanë?!

GJELBËRIMI DHE PYLLËZIMI

Duhet theksuar se Muhamedi (a. s.) që nga fëmijëria e tij ka qenë i lidhur ngushtë me natyrën dhe mjedisin e tij. Ai

vetë ka deklaruar se si fëmijë dhe si djalosh ka shërbyer si bari në rrethinat e Mekës: *"Allahu nuk ka dërguar asnjë pejgamber dhe që ai të mos ketë qenë (fillimisht) bari. I thanë: A edhe ti ke qenë bari, o i dërguar i Zotit? Tha: Po, edhe unë i kam ruajtur bagëtisë e banorëve të Mekës për disa kirat (shumë të hollash)"*^{xxviii}. Përveç kësaj, në periudhat e mëvonshme të jetës së tij, edhe ai vetë ka pasur disa kafshë (kuaj, dhen, dhi etj.), por edhe kopshte e vreshta.^{xxix} I rritur në kushte të këtilla, ai sigurisht që ka pasur një kujdes të veçantë ndaj mjedisit dhe ka shërbyer si model për të tjerët në këtë drejtim.

Ai është angazhuar për pyllëzimin e mjedisit kudo që ka qenë e mundshme. Historiografi El-Beladhuriu (v. 892) në librin e tij *Futuhu'l-Buldan* shënon ngjarjen në vijim: Kur Muhamedi (a. s.) ishte në vendin e quajtur Dhurajb et-Te'vil (me siguri, në kthim e sipër nga ekspedita Dhu Kard), një person nga Medina i thotë atij, duke iu referuar malit aty pranë: "O i dërguar i Zotit, këtu në këtë vend ne i pushojmë devetë dhe i kullosim dhentë..." Atëherë Muhamedi (a. s.) tha: *"Kushdo që këtu pret ndonjë dru, në vend të tij le të mbjellë një tjetër si kompensim për të!"* Dhe, kështu, me kalinin e kohës ky vend u quajt El-Gabeh (pyll).^{xxx} Atë që sot është praktikë e za-

konshme në shtetet moderne, Muhamedi (a. s.) e nisi që në shek. VII, pra zëvendësimin e çdo druri të prerë me një dru apo fidan tjetër të mbjellë rishtazi.

Muhamedi (a. s.) 12 milje rreth e për-qark Medinës, nga qendra e saj, i shpalli si "zona të ndaluara" (*haram*), ku ishte e ndaluar prerja e drurëve, këputja e gjetheve, prishja e kullotave, mbytja e kafshëve apo gjuetia etj. Ai ka thënë: *"Ibrahimi (a. s.) e ka shpallur Mekën të shenjtë (të paprekshme), kurse unë e shpall Medinën, që ndodhet midis dy shkëmbinjve, të shenjtë (të paprekshme). (Në këtë hapësirë) nuk pritet asnjë dru dhe nuk mund të ndiqet (për gjueti) asnjë kafshë!"*^{xxxi} Përcjell Enes bin Maliku (r. a.) se derisa ishim duke u kthyer nga lufta e Hajberit, kur mbërritëm pranë kodrës Uhud, Muhamedi (a. s.) tha: *"Kjo kodër na do neve dhe ne e duam atë."* Pastaj bëri me shenjë drejt Medinës dhe tha: *"O Allah! Po e shpall të paprekshme (të ndaluar) hapësirën midis këtyre dy shkëmbinjve të Medinës, ashtu siç e shpalli të paprekshme Ibrahim (a. s.) Mekën..."*^{xxxii} Të mësuar dhe të inspiruar nga Muhamedi (a. s.), edhe shokët e tij më vonë do ta respektojnë dhe kultivojnë në vazhdimësi kujdesin ndaj mjedisit.

Përcjell Ebu Hurejreja (r. a.) se pasi Muhamedi (a. s.) e shpalli të paprekshme, të mbrojtur, zonën përreth Medinës: *Unë*

edhe sikur të shihja ndonjë dre duke kul-lotur, nuk e trembja më, sepse dymbë-dhjetë milje përreth Medinës ai (Muhamedi a. s.) e shpalli hima (zonë të mbrojtur)"^{xxxiii} Po kështu edhe Sa'd bin Vekkasi (r. a.) një ditë e pa një skllav se si po priste dru apo ua shkundte gjethet. E ndali prej kësaj dhe, si ndëshkim, ia mori sendet me vlerë që ai i kishte...^{xxxiv}

THEMELUES I "PARQEVE NACIONALE"

Historiani i mirënjohur Muhammed Hamidullah shënon në detaje rastin kur banorët e qytetit të Taifit e pranojnë Islam-in, mirëpo paraprkishte një delegacion i tyre bëjnë një marrëveshje me Muhamedin (a. s.) në Ramazan të vitit 9 pas hixhretit. Pika katër e kësaj marrëveshjeje, të cilën autori e sjell të plotë, parashikon që lugina e Taifit të shpallet po ashtu e paprekshme, sikurse Meka dhe Medina me rrethinë, ku nuk guxon të dëmtohet në asnjë formë natyra dhe mjedisi i saj. Madje, është paraparë edhe dënim për ata që e shkelin këtë pikë të marrëveshjes, pra të dëmtimit të natyrës dhe të kafshëve në të. Në marrëveshjen prej 22 pikash, pika katër parashikonte: *"Lugina e tyre (pra, e banorëve të Taifit - R.N.) në tërësi është e shenjtë dhe aty ndalohet, në emër të Zotit, çdo dëmtim, çdo vjedhje dhe çdo vepër e keqe kundër botës së saj bimore dhe shtazore... As drurët gjemborë të luginës së Vexhxit, as kaçubati (vasid) që janë aty nuk mund t'i pret njeri. As shtazët e egra nuk guxon kush t'i vrasë. Kushdo që kapet duke bërë një vepër të tillë të keqe, do të rrihet me kamxhik, i zhveshur. E nëse dikush vazhdon edhe më tutje, do të kapet dhe do të çohet përpara pejgamberit Muhamed. Ky është urdhër i pejgamberit Muhamed, të dërguarit të Allahut."*^{xxxv}

Në sajë të angazhimit të Muhamedit (a. s.), siç pamë, Meka me rrethinë, Medina me rrethinë, si dhe qyteti Taif me rrethinë, shpallen qysh atëherë si zona të mbrojtura, ose si "parqe nacionale", ku theks të veçantë i vihet gjelbërimit dhe pyllëzimit të ambientit.

Ajetet kuranore që flasin për drurët ose për pemët janë të shpërndara në tërë Kuranin - që nga suret e para, deri tek ato të fundit, në mënyrë shumë të barspes-shuar. Përsëritja e shpeshtë dhe në kontekste të ndryshme e fjalës "dru", ose "pemë", në Kuran, e mban gjallë imazhin e tij në kokën e atij që e lexon Kuranin me vëmendje të plotë. Kështu që, besimtari i cili e kupton në mënyrë të gjallë dhe shumë tërheqëse rëndësinë shoqërore dhe

qytetëruese të drurit, mbjelljen dhe mbrojtjen e drurëve e sheh si formë adhurimi dhe këtë e bën me kënaqësi të thellë shpirtërore.^{xxxvi} Duke qenë se në çdo aspekt të jetës Muhamedi (a. s.) ishte një shëmbëlltë, edhe në pyllëzimin e mjedisit ka qenë angazhuar personalisht, duke mbjellë afërsisht 500 drurë hurme.^{xxxvii} Ai nuk ka lejuar që tokat djerrinë të ngelin të tilla përgjithmonë, porse i ka motivuar njerëzit që t'i gjallërojnë ato, t'i gjelbërojnë e t'i mbjellin. Kështu, ai ka thënë shumë qartë: *"Kush e ngjall një tokë të vdekur, ajo i takon atij."*^{xxxviii} Kjo, në kushtet e asaj kohe kur kishte pjesë të tokës që nuk i takonte askujt dhe ishte e lënë djerrinë.

Thëniet e Muhamedit (a. s.), sa i takon kujdesit për mbjelljen dhe pyllëzimin e tokës, janë të shumta, çka edhe një herë tregon angazhimin maksimal të tij prej ambientalisti të vërtetë.

Ai e ka ngritur në shkallë ibadeti apo adhurimi mbjelljen e tokës, si dhe pyllëzimin: *"Kushdo që mbjell një pemë ose mbjell drithë e pastaj prej tyre hanë shpezët, njeriu ose kafshët, këtij do t'i quhet sadaka (shpërblim lëmoshe)"*^{xxxix}

Madje, edhe nëse dikë e kap dita e fundit në këtë botë, pra Kiameti, dhe në dorë ka një fidan pemë që ka nisur ta mbjellë, Pejgamberi (a. s.) rekomandon që ai duhet ta vazhdojë punën dhe ta mbjellë atë, edhe pse pas kësaj dite nuk ka më jetë, nuk ka më kohë që ajo pemë të rritet e të japë frytje. Ai thotë: *"Në qoftë se dikë prej jush e kap kiameti, kurse në dorë ka një fidan, le ta mbjellë!"*^{xli} Kjo tregon edhe një herë dashurinë që duhet ta kultivojë njeriu ndaj mjedisit ku jeton. Pra, edhe në momentin më kritik, besimtari nuk përton ta mbjellë tokën apo pemën, pavarësisht nëse do të ushqehet dhe do të përfitojë ai vetë nga ajo ose jo. Ky është një mesazh i fuqishëm për vetëdijen tonë moderne - se çfarë bote dhe çfarë mjedisi po u lëmë trashëgim pasardhësve tanë.

Në traditën islame, duke u mbështetur në fjalët e Muhamedit (a. s.), ka diçka që quhet *sadakai xharijeh*, që nënkupton një *sadaka* apo lëmoshë që e ka dhënë myslimani sa ka qenë gjallë për të mirën e shoqërisë. Sipas këtyre mësimëve, sepapet apo shpërblimet për këto vepra të mira do të vazhdojnë t'i shënohen në regjistrin e veprave të mira këtij personi edhe pasi të ketë vdekur ky, pra i rrjedhin atij vazhdimisht derisa të shfrytëzohen nga ata që kanë mbetur gjallë, nga ata që ky ka lënë mbas vetes. Këto zakonisht janë: ura, shtretër të rregulluar lumenjsh, rrugë, rreshta me drurë të mbjellë, apo

toka të gjelbëruara dhe gjithçka tjetër që vihet në shërbim të njerëzimit, të kafshëve, të shpezëve etj. Kjo i jep ambientalizmit në Islam një dimension tjetër shpirtëror: e lidh edhe me mirëqenien në botën tjetër.

(Vazhdon)

ⁱ Güven, Mustafa, "Kur'an-ı Kerim'de Çevre Bilimine Dair Bazı Ahlâkî Esaslar", revistë Birey ve Toplum, vëll. 4, nr. 2, Stamboll, 2014, fq. 156-157.

ⁱⁱ Güven, Mustafa, po aty, fq. 147.

ⁱⁱⁱ Grup autorësh, *İlimihal...*, fq. 462-463.

^{iv} Sancaklı, Saffet, po aty, fq. 413.

^v Muslimi, Iman, 204.

^{vi} Buhariu, Edeb, 33.

^{vii} Tirmidhiu, Zuhd, 21.

^{viii} Muslimi, Iman, 58.

^{ix} Ibnu Maxheh, Edeb, 7.

^x Muslimi, Birr, 36; Ibnu Maxhe, Edeb, 7.

^{xi} Muslim, Birr, 36.

^{xii} Ebu Davudi, İxharah, 26.

^{xiii} Buhariu, Musakah, 5.

^{xiv} Buhariu, Vesaja, 33.

^{xv} Buhariu, Sulh, 12.

^{xvi} Ebu Davudi, Edeb, 158, 159.

^{xvii} Akyüz, Hüseyin, Ot, Su ve Ateşin Kullanimı İle İlgili Bir Hadisin Güncel ve Evrensel Değeri, *İnsan ve Toplum Bilimleri Araştırmaları Dergisi*, vëll. 4, nr. 1, Stamboll 2015, fq. 232-144.

^{xviii} Ebu Davud, Taharah, 31.

^{xix} Muslimi, Iman, 39.

^{xx} Canan, İbrahim, *Çevre Ahlakı*, Yeni Asya Yay., Stamboll 1995, fq. 17.

^{xxi} Buhariu, Xhumu'ah, 2.

^{xxii} Buhariu, Libas, 63-64.

^{xxiii} Ebu Davudi, Et'imeh, 11-12; Tirmidhiu, Et'imeh, 39.

^{xxiv} Buhariu, Saum, 27.

^{xxv} Muslimi, Taharah, 20; Ebu Davudi, Taharah, 14.

^{xxvi} Ibnu Maxheh, Ruhun, 22.

^{xxvii} Muslimi, Taharah, 96.

^{xxviii} Buhariu, İxharah, 2.

^{xxix} Sancaklı, Saffet, Fakirlik ve Zenginlik İlgili Hadisler Üzerine Bir Deneme, *Cumhuriyet Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, vëll. V, nr. 1, Sivas 2001, fq. 351 f.

^{xxx} El-Beladhuri, *Futuhu'l-Buldan*, Muesseseh el-Me'arif, Beirut 1987, fq. 18; al-Baladhuri, *The Origins of Islamic State (Kitab Futuh al-Buldan)*, nga arab. Philip Khuri Hitti, New York Columbia University, 1916, fq. 24.

^{xxxi} Muslimi, Haxhxh, 456-459.

^{xxxii} Buhariu, Xhihad, 71.

^{xxxiii} Muslimi, Haxhxh, 472.

^{xxxiv} Muslimi, po aty, 461.

^{xxxv} Hamidullah, Muhammed, *Muhamedi a.s. - Jeta dhe Vepra*, vëll. I, nga frëngjishtja Ruzhdi Ushaku, Logos-A, Shkup 2011, fq. 409-411.

^{xxxvi} Canan, İbrahim, po aty, fq. 52.

^{xxxvii} Ahmed bin Hanbel, Musned, V, 440.

^{xxxviii} Tirmidhiu, Ahkam, 38; Ebu Davudi, Haxhxh, 37.

^{xxxix} Buhariu, Muzara'a, 1; Muslimi, Musakah, 12.

^{xl} Buhariu, Edebu'l-Mufred, 480.

NUK LODHIN PUNËT, SA LODHIN PENGESAT

Të gjitha kërkesat për të hequr një trafo të EVN-së nga xhamia e shekullit XVI kanë rënë në veshë të shurdhër tek organet komunale. – Në Tabanoc pushteti as e bën riparimin e xhamisë së vjetër - monument kulture, as lë që këtë ta bëjnë besimtarët. – Plaçkitje tek varrezat! – Suksese në zhvillimin e mësim-besimit islam, në mësimin përmendsh të Kuranit (hifz) etj. – Pritet Medreseja...

Myftinia e Kumanovës përkujdeset për 37 xhami, duke filluar nga qyteti e deri te fshatrat malorë të komunës së Likovës, me gjithsej 34 imamë të rregullt. Në disa fshatra të

boshatisur për shkak të krizës së rëndë ekonomike, ka autorizuar imamë për faljen e namazit të xhumasë (mos e harrojmë pandeminë dhe gjendjen e jashtëzakonshme!). Të gjithë imamët e

kanë të rregulluar çështjen e sigurimit pensional dhe invalidor, falë punës së palodhshme të Myftiut dhe të tërë Myftinisë.



Selia e Myftinisë së Kumanovës më parë ka qenë në një ndërtesë të vjetër dhe të rraskapitur, e cila pas Luftës së Dytë Botërore ishte nacionalizuar, deri në vitin 1983, kur iu kthye Myftinisë. Zyra e parë, ku ishte selia e Myftinisë, u uzurpua nga pushteti dhe në vendin e saj u ndërtua Spitali i Kumanovës.

Pas shumë kërkesave drejtuar organeve komunale të Kumanovës, më 29.02.2012 u mor leja për ndërtimin e objektit të ri. Me marrjen e lejes, u bë një turne nëpër Turqi. Pas shumë takimeve, në Stamboll nga organizata humanitare "Rumeli Vakfi", drejtor i së cilës ishte Ismail Jalldez, u mor premtimi se do të vijë ndihma, kështu që më 19.03.2013 solemnisht u vu guri themeltar për ndërtimin e objektit të ri të Myftinisë, i cili zyrtarisht u lëshua në përdorim më 2.07.2016 në prezencë të Kreut më të lartë të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, të Kryetarit të Komunës së Bursës z. Rexhep Altepe etj.

NJË PARALELE TË MEDRESESË

Objekti ka bodrumin, i cili është i furnizuar me të gjitha elementet që i nevojiten kuzhinës, e kategorisë më të lartë. Myftinia mendon se me hapjen e një paraleleje të Medresesë Isa Beu, kjo

do të jetë kuzhinë e nxënësve, të cilët do të banonin në konviktin e Medresesë. E gjithë aparatura është dhuratë nga myslimanët e R. së Turqisë. Në përdhës janë katër lokale afariste, nga qiratë e të cilave ndihmohet sadopak puna e Myftinisë.

Në katin e parë janë zyrat administrative të institucionit, si: zyra e myftiut, sekretarit, arkëtarit, referentit, kontabilitit, një sallë për pritje të mysafirëve, një sallë për shërbime fetare (kurorëzime etj.), si dhe një bibliotekë dhe një minikuzhinë për nevojat e të punësuarve në Myftini. Kati i dytë, ndërkaq, ka disa klasa për zhvillimin e mësim-besimit islam, mirë të rregulluara dhe me standarde bashkëkohore. Kati i tretë është i kompletuar si internat, i cili në të ardhmen mund të shfrytëzohet për nxënësit që do t'i vijonin mësimet këtu, në Medrese. Kati i fundi ka një sallë për mbajtjen e seminareve shkencore, simpoziumeve, mbledhjeve të Kuvendit, si dhe për organizimin e manifestimeve dhe ngjarjeve të ndryshme nga Myftinia e Kumanovës. Salla është mirë e përgatitur dhe me inventar bashkëkohor. Ndërtesa ka dhe ashensor, i përshtatur edhe për nevojat e personave me nevoja të veçanta.

Me iniciativën e myftiut Abedin ef. Imeri, në godinën e Myftinisë është

hapur biblioteka "Ebu Hanife", me mbi 100 ekzemplarë librash fetarë, të dhuruar nga njerëz bamirës dhe dashamirë të dijes. Myftinia po ashtu ka hapur morgun e vet, meqenëse më parë nuk kishte ku të ruhej xhenazja. Morgu është dhuratë e dy vëllezërve mërgimtarë nga Kumanova, Nexhat dhe Xhevat Lutfiu, dhe ka kushtuar 60.000 euro. Morgu është i përgatitur shumë mirë dhe i plotëson të gjitha standardet. Ka vend për katër kufoma, të cilat mund të qëndrojnë aty mbi një muaj. Përveç morgut, në kuadër të këtij objekti u ndërtua edhe vendi i posaçëm për larjen e xhenazeve (gusullhane), një sallon për pritjen e njerëzve dhe tri dhoma me një ballkon në katin e dytë, ku gjithçka është funksionale.

Myftinia e Kumanovës para disa viteve kishte vendosur që një herë në vit të grumbullojë ndihma vullnetare me moton "T'i ndihmojmë xhamitë e vogla". Me këtë ndihmohen fshatrat e vegjël, të cilët nuk kanë mundësi t'i mbajnë imamët e tyre. Gjatë periudhës së kaluar ajo, po ashtu, të gjitha aksionet humanitare që i ka shpallur BFI në kuadër të RMV, me rastin e katastrofave natyrore etj., i ka kryer me sukses.

Xhamia në f. Bellanoc ka marrë emrin "Naip Rexhepi Bellanoca", është shpalosur pllaka me një ceremoni rasti dhe është bërë rivarrimi i dy dëshmorëve



të kombit: Rexhep Rexhepi dhe Jashar Arifi, të cilët janë ekzekutuar nga pushteti i kohës në vitin 1945. Opaja nga 1 janari i vitit 2020 është me xhami të re. Me xhami të re janë edhe fshati Izvor, f. Vojnoviq, Opaja (Xhamia Furkan), Llopiti, Presnica e Likovës, Nikushtaku etj.

Mësim-besimi islam vazhdon të realizohet në çdo vend. Myftinia në vazhdimësi e përcjell punën e mejtepeve në gjithë terrenin që mbulon. Referenti për arsim fetar i Myftinisë vazhdimisht është në kontakt me imamët dhe i viziton të gjitha xhamitë, për të parë nga afër nevojat e mejtepeve. Kumanova dhe rrethina e saj dallohen edhe me dua-hifzet, nga djem dhe vajza. Më 2.10.2014, në f. Likovë, Seid Imeri; më 26.12.2015, në f. Opajë, hfz. Hamza Neziri; në f. Likovë, më 15.07.2018, hafëzi Mevludin Mamuti; më 22.06.2019, në xhaminë qendrore “Tatar Sinan Pasha”, hafëzja Ebru Ameti; në Mateç, më 27.07.2019, hfz. Vaid Isufi etj.

Myftinia e BFI-së në Kumanovë gjatë periudhës së kaluar ka organizuar tribuna shkencore me rastin e datave historike islame në disa xhami me teologë mirë të përgatitur. Ajo e ka bërë tradicionale natën e fundit të muajit të bekuar të Ramazanit dhe organizon një tubim në njërin prej xhamive. Gjatë muajit të Ramazanit, që moti, nga Myftinia e Kumanovës, përpos vizitave të bëra nga

Rijaseti i BFI-së dhe Myftinia e Kumanovës, një natë bëhet ndërimi i imamëve, me çka mundësohet një freskim tek xhemati me ligjëratat që janë jashtë shabllonit të së përditshmes.

PASOJAT E SHPËRNGULJES

Disa xhami malore janë të hapura vetëm ditën e xhumasë, ngase banorët e këtyre fshatrave janë shpërngulur dhe kanë mbetur vetëm disa familje të vogla – thonë në Myftininë e Kumanovës. Çdo xhami ka imamin e saj me vendim të lëshuar nga BFI. Në disa xhami janë caktuar vaiz, hatib dhe mual-lim. Imamët e këtyre xhamive mbahen nga anëtarësia e grumbulluar nga xhemati i xhamisë dhe mjetet sillen në Myftini, nga ku edhe paguhen imamët. Në xhamitë periferike, ku ka pak banorë, por xhamitë janë funksionale, Myftinia e Kumanovës autorizon imamë për faljen e namazit të xhumasë dhe u paguan nga një mëditje, me qëllim që të gjitha xhamitë të jenë të hapura, së paku ditëve të xhumasë – përtej gjendjes së tanishme të jashtëzakonshme.

Myftinia e Kumanovës më parë ka pasur një borxh, të cilin e ka kërkuar Enti i Sigurimit Pensional dhe Invalidor për periudhën e viteve 1984-1993, me pretekstin se nuk janë paguar kontributet e imamëve aq sa kërkohej, shuma e të cilit

llogaritej afër 50.000 euro dhe ka qenë një pengesë e madhe për pensionimin e imamëve. Por, falë punës së palodhshme të Myftiut dhe operativës së tij, kjo pengesë është shlyer përfundimisht, me çka të gjithë imamët e kanë të rregulluar çështjen e sigurimit pensional dhe pa asnjë pengesë, në kohën kur i plotësojnë kushtet, kalojnë në pension.

Xhamitë e reja në brendinë e tyre kanë mejtepin, ku zhvillojnë mësim-besimin islam. Myftinia ka dy xhami të vjetra, të cilat e tregojnë kulturën islame dhe janë monumente historike të regjistruara në Ministrinë e Kulturës.

Xhamia qendrore “Tatar Sinan Pasha”, e cila gjendet në rr. “11 Tetori” p. n., në bazë të informatave që i ka Myftinia e Kumanovës, është e ndërtuar në vitin 1532. Një gjë e cila e mundon shumë Myftininë dhe xhematin e kësaj xhamie është se në oborrin e saj është një trafo e rrymës elektrike, nga ana e rrugës “11 Tetori”. Këtë trafo e ka vendosur herët mdërmarrja “Svetlina”, qysh në kohën e monizmit, pa u pyetur askush. Vendi ku është vendosur kjo trafo realisht është pronë e Xhamisë, pasi edhe gjendet në oborrin e saj. Një gjë është për t’u habitur se si vendi ku është trafoja në Kadastrën e Kumanovës figuron si pronë e EVN-së! Myftinia e BFI-së në Kumanovë disa herë ka kërkuar mënjanimin e saj nga oborri i Xha-

Në fillim, Zyra e Vakëfit

Në bazë të informatave që kemi, njeriu i parë i cili udhëhoqi me këtë institucion fetar ka qenë Veysel ef. Alishani, i cili në detyrë gjatë periudhës 1906-1913.

Myftinia e Kumanovës një kohë u quajt „Zyra e Vakëfit“. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe me instalimin e sistemit monist, u mor nëpër këmbë, ndërsa pjesëtarëve të saj iu shtua zullumi, me tendencë – shpërngulja.

Myfti aktual, i cili udhëheq me Myftininë e BFI në Kumanovë që nga viti 2006, është Abedin ef. Imeri.

misë, sepse ajo pengon dhe kur bëhet ndonjë defekt aty gropohet dhe punohet, dëmtohet parku i saj dhe rrezikohet edhe objekti i Xhamisë. Të gjitha kërkesat tona kanë rënë në veshë të shurdhër tek organet komunale – thonë në Myftininë e Kumanovës. Me shpalljen e Ligjit për privatizim të pasurive, Myftinia e Kumanovës i ka bërë kërkesë Ministrisë së Financave në Kumanovë për privatizimin e oborrit të Xhamisë, sepse nga viti i kaluar oborri i xhamisë është në pronësi të shtetit, dhe, për ta privatizuar këtë pjesë të saj, nevojitet një pëlqim nga EVN, sepse aty e ka pjesën e trualtit ku është vendosur trafoja, për çka edhe sot e kësaj dite kjo ndërmarrje nuk jep pëlqimin për ta privatizuar oborrin e Xhamisë. Kemi bërë kërkesa, takime me drejtorin e saj; kemi kërkuar prej bordit të EVN në Shkup ndihmë, ata thonë se Kumanova duhet ta kryejë këtë gjë, por, sot e kësaj dite ka ngelur pa u kryer privatizimi dhe shpresojmë që në të ardhmen të gjendet ndonjë zgjidhje – pohojnë në Myftini.

Xhamia në fshatin Tabanoc “Koca Mehmet Beg”, sipas dokumenteve që ka Myftinia e Kumanovës është e ndërtuar në vitin 1380. Që të mos lihet në mëshirën e kohës, Myftinia ka kërkuar nga Ministria e Kulturës që të evidentohet si monument historik i kulturës islame. Ministria e Kulturës – tregojnë në Myftini - me vendim nr. 08-689/9 të datës 11.12.2008 këtë xhami e regjistron në arkivin e saj si monument historik. Xhamia është e rrënuar, për çka Myftinia e Kumanovës është e interesuar që kjo xhami të riparohet dhe disa herë janë bërë takime me drejtuesit e kësaj Ministrie dhe është kërkuar që Myftinia ta riparojë, por pasi që Xhamia është monument histo-

rik, Ministria e Kulturës nuk lejon një gjë të tillë, duke u arsyetuar se këtë punë e bënë vetë Ministria, por duhet të gjenden donatorë. Ministria e Kulturës në vitin 2014 e informon Myftininë e Kumanovës se është gjetur donatori për riparimin e saj dhe prej saj kërkon që të japë pëlqimin. Myftinia e Kumanovës menjëherë e ka pëlqimin, por Ministria e Kulturës përpos që i ka bërë disa gropime rreth themeleve të saj, asgjë tjetër nuk ka bërë – thonë në Myftininë e Kumanovës.

Të vështirësitë hyjnë edhe Varrezat Qytetëse të myslimanëve, të cilat llogariten si pronë shtetërore dhe si të tilla janë të evidentuara në LP. Me varrezat e Kumanovës ka menaxhuar dhe edhe sot menaxhon NP “Pastrim dhe Gjelbërim” – Kumanovë, e cila bën edhe hapjen e varreve. NP “Pastrim dhe Gjelbërim” – thonë në Myftini - i plaçkit qytetarët e Kumanovës, duke ua marrë nga 4.000 denarë, gjoja ‘legalizim i varrit’. Këtu bëhet edhe një gjë tjetër: se njerëzit shkojnë dhe bëjnë kontratë me këtë ndërmarrje për blerjen e vendit. Myftinia e Kumanovës nga këto pazare nuk merr asgjë!

Në qytetin e Kriva Pallankës më herët ka ekzistuar një xhami, e cila është rrënuar viteve tetëdhjetë nga organet e pushtetit. Një grup qytetarësh me përkatësi fetare islame kanë organizuar blerjen e një lokal në rr. “11 Tetori” nr. 2 në këtë qytet për faljen e namazeve ditore dhe me Vendim të lëshuar nga BFI lejohet falja e namazit në këtë lokal. Në qytetin e Kratovës, ndërsa, më herët ka pasur një xhami në qendër të qytetit, por në vitin 1978 kjo xhami është rrënuar dhe në vendin e saj është ndërtuar objekt tjetër.

BASHKËPUNIMI, I SHKËLQYER

Bashkëpunimi i Myftiut me Myftininë e Kumanovës është i shkëlqyer. Duke parë gjendjen ekonomike të imamëve gjatë kësaj periudhe kohore, Myftiu është në kontakt të pandërprerë me imamët, rregullisht mban mbledhje me anëtarët e Myftinisë, ku shqyrtohen punët e arritura dhe nevojat tjera që duhen kryer, për të gjetur mënyrën më të mirë për tejkalimin e pengesave që paraqiten te të punësuarit në Myftini dhe nëpër xhami. me qëllim që të përmirësohet gjendja e tyre – bëjnë të ditur në Myftininë e Kumanovës.

Sa i përket bashkëpunimit me Rijasetin e BFI-së, ai është i shkëlqyer – thonë aty dhe shtojnë: Myftiu Abedin ef. Imeri është në kontakt me Rijasetin dhe me Kryetarin h. Sulejman ef. Rexhepi, i cili çdoherë thotë se ‘në çdo kohë jam i hapur për t’ju ndihmuar në nevojat tuaja; pa llogaritur kohën, natën apo ditën’. Çdo iniciativë që merret nga Rijaseti, Myftinia e Kumanovës me përpikëri e realizon, qofshin për nevojat e dy institucioneve arsimore - Medresenë dhe FSHI-në, organizimet tjera humanitare etj.

Vakëfet, si i vetmi burim i Myftinisë dhe i xhamive për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre, pas Luftës së Dytë Botërore janë nacionalizuar nga pushteti i atëhershëm. Myftinia e Kumanovës vazhdimisht kërkon nga organet shtetërore kthimin e vakëfeve të nacionalizuara. Disa xhematlinj, ndërsa, kanë shprehur dëshirë që disa prona të tyre t’ia lënë vakëf Myftinisë së Kumanovës. Kështu që në Kumanovë dhe në disa fshatra siç janë Opaja, Sllupçani, Runica, Likova, Bellanoca dhe Mateçi i janë dhuruar disa prona Myftinisë së Kumanovës dhe të gjitha këto prona tani janë me dokumente të rregulluara: *Vakëfi i Myftinisë së Kumanovës*.

Bashkëpunimi me mediat në Kumanovë është i shkëlqyer. Që nga themelemi i TV ‘Festa’, me plot përgjegjësi themi se kemi një bashkëpunim të shkëlqyer mes nesh dhe kësaj shtëpie informative. TV Festa një kohë të gjatë emeton emisionin fetar “Nën hijen e Kuranit”, i cili udhëhiqet nga teolog me kualifikime të larta dhe mirë të përgatitur. Ky emision jepet për çdo të enjte në mbrëmje dhe zgjon interesim të madh te popullata e kësaj ane – thonë në Myftininë e Kumanovës, e cila ballafaqohet njësoj si 12 myftinitë tjera me sëmundjen e koronavirusit dhe me masat e jashtëzakonshme të përbaljes me të.

Përgatiti: Enver Zeqiri



KËRKIMI I NJOHURIVE SHKENCORE, VEPRIM ADHURIMI



Si në atë kohë, edhe në kohën tonë, gruaja si shtyllë kryesore e familjes dhe e shoqërisë mbetet të vlerësohet dhe të mbështetet për angazhimin e saj, nga gjurmët që lë në jetën e gjithsecilit.

Shkruan: Atifete Iseni

Hind bint Ebi Umajja, e njohur gjithashtu si Umm Seleme (r. a.), ishte një nga gratë më me ndikim të Muhamedit (a. s.). Ishte fisnike e lindur, inteligjente, e mençur dhe e aftë. Para martesës së saj me Muhamedin (a. s.), Umm Seleme (r. a.) ishte e martuar me Ebu Seleme (r. a.). Umm Seleme (r. a.) ishte ndër të parat që e pranoi Islam. Vetëm Hatixhja, Aliu, Ebu Bekri (r. a.) dhe disa të tjerë ishin myslimanë para asaj.

Për shkak të dijes dhe mençurisë, Umm Seleme mbajti një rol shumë të rëndësishëm në shoqërinë islame. Ajo ishte një grua e jashtëzakonshme. Si grua, ajo i kryente dhe i përmbushte të gjitha detyrat e saj fetare. Gjatë martesës së saj me Muhamedin (a. s.), ajo u përpoq ta mbante atë të lumtur. Ajo ishte e njohur në shoqëri për inteligjencën, për aktivitetet politike dhe veprimtarinë e saj në luftën për të drejtat e grave. Umm Seleme (r. a.) ishte një grua me aftësi për gjykim.

GJITHÇKA PËR TË MIRËN E MYSLIMANËVE

Umm Seleme (r. a.) ishte e prirur të fliste për atë që ndodh ndërmjet saj dhe Pejgamberit (a. s.) në shtëpinë e tyre, në mënyrë që t'i njoftojë myslimanët se çfarë ishte e lejueshme dhe çfarë ishte e ndaluar, për t'u mundësuar njerëzve të nxjerrin rregullat e sjelljes nga kjo. Umm Seleme (r. a.) nuk ishte e trembur për



zbulimin e detajeve intime të jetës së saj me Pejgamberin (a. s.) për të mirën e myslimanëve.²¹ Umm Seleme (r. a.) gjithashtu ka nxjerrë rregulla të fikhut nga hadithet që ka dëgjuar dhe transmetuar nga Pejgamberi (a. s.) dhe i ka përdorur për të dhënë këshilla duke u bazuar në to.

Shumë prej haditheve të cilat i transmetoi Umm Seleme (r. a.) janë në lidhje me tema 'të orientuara për femrat' si: veshmbathja, zbukurimi, gjërat intime mes burrit dhe gruas, martesë dhe morali. Prandaj, hadithet e transmetuar nga Umm Seleme (r. a.) janë të përfshira në gjithë librat kryesorë të jurisprudencës islame dhe dijetarët e jurisprudencës bazohen në hadithet e transmetuara nga Umm Seleme (r. a.).

Umm Seleme (r. a.) ka transmetuar shumë hadithe që i dëgjoji nga Pejgamberi (a. s.). Në Musnad të Imam Ahmedit ajo ka gjithsej 378 hadithe. Në Sahihejn ajo ka gjithsej njëzet e nëntë hadithe, nga të cilat Bukhari dhe Muslimi u pajtuan për trembëdhjetë hadithe të saj.

Rreth tetëdhjetë e pesë persona transmetuan hadithe drejtpërdrejt nga Umm Seleme (r. a.). Transmetuesit ishin burra dhe gra, të cilat ajo i mësonte personalisht.²² Omeri dhe Zejnebja (r. a.), femijet e saj transmetuan hadithe prej saj, si dhe shërbëtorët (ndihmësit) e saj: Hind Bint el-Harith dhe Safija bint Shejba; shërbëtorët tjerë të saj si: Sunajna dhe Dumara Umm el-Hasan el-Başri, Kuraibi - shërbëtori i Ibn Abbasit (r. a.), Urva ibn al-Zubejr dhe shërbëtori i Ibn Omerit (r. a.) - të gjithë transmetuan hadithe nga Umm Seleme (r. a.).

Edhe pse të gjitha gratë e Pejgamberit (a. s.) kishin dituri dhe njohuri të mëdha, Aisha dhe Umm Seleme (r. a.) nuk kishin asnjë rival. Mahmud ibn Labid thotë: "Gratë e Pejgamberit ishin thesare të Hadithit; por, Aisha dhe Umm Seleme nuk kishin asnjë që barazohej me to."²³

Pjesa më e madhe e pyetjeve që iu parashtruan Umm Selemes (r. a.) kanë qenë rreth jetës publike dhe private të Pejgamberit (a. s.). Është mirë të theksohet se ata që interesohen dhe e studiojnë jetën e Pejgamberit (a. s.), në detaje i përdorin shpesh hadithet e transmetuara nga Umm Seleme dhe Aisha (r. a.).

Burime të ndryshme raportojnë se Pejgamberi (a. s.) mori disa shpallje nga Allahu (xh. sh.) në shtëpinë e Umm Selemes (r. a.). Pra, ky privilegj - të dëshmojë në shpalljen e disa ajeteve nga Kurani - i është dhënë edhe Umm Sele-

mes (r. a.). Ajeti numër 102 i sures et-Tevbe i është shpallur Pejgamberit (a. s.) duke qenë në shtëpinë e Umm Selemes (r. a.).²⁴

Një shpallje tjetër që Pejgamberi (a. s.) mori në shtëpinë e Umm Selemes (r. a.) është pjesa e dytë e ajetit 33 të sures El-Ahzab, sipas tefsirit të Ibn Kethirit.²⁵

Ajetet e Kuranit nuk u shpallën vetëm në shtëpinë e Umm Selemes (r. a.), por shumë ajete u shpallën gjithashtu të nxitura nga pyetjet e saj. Umm Seleme (r. a.) dikur e pyeti Pejgamberin (a. s.) se pse Kurani duket se u drejtohet vetëm burrave, ndërsa gratë gjithashtu janë konvertuar në Islam, luftuan krah për krah me burrat, migruan me ta dhe sakrifikuuan po aq sa burrat, nëse jo edhe më shumë. Pas disa ditësh, derisa po krihte flokët, ajo dëgjoji Pejgamberin (a. s.) të recitonte ajetin 35 të sures Fatir nga minberi (foltorja).²⁶

Një ajet tjetër, përkatësisht [4:32], gjithashtu raportohet të jetë shpallur pasi Umm Seleme e pyeti Pejgamberin (a. s.): pse gratë trashëgojnë vetëm gjysmën e sasisë që trashëgojnë burrat. Kjo, për shkak se burrat ishin të detyruar të luftonin në betejë, ndërsa gratë jo.

KONTRIBUTI NË MEDICINË

Gjatë historisë islame, qysh në kohën e pejgamberit Muhamed (a. s.), ka shembuj të grave myslimane që dhanë kontribut të konsiderueshëm në përmirësimin e cilësisë së jetës shoqërore. Ato morën pjesë gjithashtu në mënyrë aktive në mjekësi dhe shëndetësi, pasi ishin të motivuara nga shqetësimi i tyre për halllet, gjendjen, e njerëzve. Sheriati (ligji islam) kërkon që myslimanët të kenë shqetësim për shoqërinë në të gjitha sferat e jetës. Kështu që, gjatë gjithë historisë Islame kërkimi i njohurive shkencore konsiderohej si një veprim adhurimi. Me ardhjen e Islamit, gratë kishin mundësi të punojnë si mjekë dhe të trajtojnë gra dhe burra.

Titulli si infermiere e parë në Islam i është dhënë Rufajda bint Saad el Eslamijja (r. a.). Por, ka pasur edhe gra të tjera, që ishin infermiere dhe praktikuese të mjekësisë në kohën e Pejgamberit (a. s.), si: Nusajba bint Kaab el-Mazeneja - një nga gratë myslimane që ofronte shërbime infermiere për luftëtarët në Betejën e Uhudit; Umm Sinan el-Islami (e njohur si Umm Imara), e cila kërkoi lejen e pejgamberit Muhamed (a. s.) që të dilte te luftëtarët për të ushqyer të plagosurit dhe të sigurojë ujë për të eturit; Umm Matave el-Eslamijja, e cila

vullnetarisht ishte një infermiere në ushtrinë islame dhe njihet për kontributin e saj në Betejën e Hajberit; Umm Varaka bint Harith, e cila njihet se ka marrë pjesë në përmbledhjen e Kuranit dhe shërbimet e saj si infermiere për luftëtarët në Betejën e Bedrit.²⁷

ARRITJET POLITIKE

Politika është konsideruar si një fushë që nuk ishte e përshtatshme për gratë, por prania e pejgamberit Muhamed (a. s.) në Mekë vërtetoi se gratë gjithashtu mund të merrnin pjesë në politikë. Kishte gra Sahabijate në kohën e Pejgamberit (a. s.) që kishin rol të rëndësishëm në politikë. Ato kontribuan në emigrimin e disa Sahabëve dhe Sahabijate që kërkonin azil politik jashtë Mekës; kanë marrë pjesë në formimin e komunitetit mysliman në Medinë, kanë këshilluar Pejgamberin (a. s.) në Mekë dhe në Medinë rreth çështjeve kundër armikut dhe kanë qenë menaxhuese të politikës në Medinë.³²

Në këtë pjesë jepet një shpjegim i grave që luajtën një rol të rëndësishëm në politikë në kohën e Pejgamberit (a. s.):

Esma bint Umajs (r. a.)

Esma e pranoi Islamin në Mekë. Ajo bashkë me tri gra të tjera shkoi të Pejgamberi (a. s.) dhe kërkoi të emigroje duke kërkuar azil politik, për të shpëtuar nga problemet dhe lufta, në mënyrë që ata pak myslimanë që kanë mbetur në atë kohë të mos shkatërroheshin nga pabesimtarët kurejshitë. Esma u nis për në Habeshe me burrin e saj Xha'fer ibn Ebu Talib. Kontributi i saj në politikë ka qenë në këshillat se si duhet të mbrohen myslimanët nga pabesimtarët.³³ Në një transmetim, pejgamberi Muhamed (a. s.) thotë se Esma kishte emigruar dy herë, d.m.th. një herë në Habeshe dhe një herë në Medinë.

Esma bint Ebu Bekr (r. a.)

Esma (r. a.) ishte gruaja e Zubejr ibn Avamit, një nga personat që i është garantuar parajsa (Xheneti) nga kjo botë dhe vajza e Ebu Bekrit (r. a.). Esma njihet si një grua e cila ishte shumë aktive në politikë. Roli i saj politik u tregua se si ajo ishte gjithnjë e përfshirë në da'va dhe në luftë duke e mbrojtur pejgamberin Muhamed (a. s.). Gjithashtu, njihet për sakrificën e saj duke iu dhënë ushqim Pejgamberit (a. s.) dhe Ebu Bekrit (a. s.) në shpellën Theur, atëherë kur u përgatitën të emigronin për në Medinë.³⁴

Rukija bint Saife (r. a.)

Para Hixhretit (shpërnguljes) të pejgamberit Muhamed (a. s.) për në Medinë, mosbesimtarët donin ta rrethonin shtëpinë e tij dhe ta mbytnin. Ishte Rukijja bint Saife (r. a.) ajo që e këshilloi dhe e paralajmëroi të mos ngutet dhe mos të shfaqet në publik. Pejgamberi Muhamed (a. s.) u nis fshehurazi për në Medinë duke i pranuar këshillat e Rukijes, sepse ajo e dinte situatën aktuale të asaj kohe.

TË AFTA PËR SHUMË VEPRIMTARI PUBLIKE

Sahabijetet gjithashtu praktikuan aftësitë e tyre në bujqësi, biznes, tregti, industri, prodhim dhe disenjim të rrobave etj. Të gjitha këto përmenden në Musned-in e Imam Ahmedit. Bujqësia nuk ishte aq e zakonshme, por praktikohet kryesisht në zonat pjellore rurale, rreth qytetit të Medinës, sidomos nga gratë e ensarëve. Në mesin e emigrantëve (muhaxhret), Esma (r. a.) praktikonte bujqësinë.

Disa nga Sahabijetet drejtuan biznese të ndryshme. Hatixhja (r. a.) ishte një biznesmene shumë e suksesshme dhe dërgonte karvanët e vet për tregti në vende të ndryshme të rajonit. Havlah, Malika, Thakafija dhe Bint Faharija tregtuan me parfumet orientale të bazuara në vaj, të njohura si itar. Sauda (r. a.) operoi një industri për rrezitjet e lëkurës.

Hatixhe bint Huvajlid (r. a.) ishte

gruaja e parë e Muhamedit (a. s.). Nofka e saj ishte Hatixhetul-Kubra (e madhja). Ajo ishte bija e Huvejlid ibn Esad dhe Fatimah bint Za'ida. Hatixhja njihet gjerësisht si personi i parë që e pranoi fenë islame. Dhe, nuk ka dyshim se Hatixhja (r. a.) ishte gruaja më e besuar dhe më e preferuar midis të gjitha martesave të Pejgamberit (a. s.).

Historia e suksesit të Hatixhes (r. a.) në biznes fillon para Islamit, kur ajo pas divorcit nga burri i saj, i kushtoi gjithë vëmendjen edukimit të fëmijëve dhe ndërtimin e një biznesi, të cilin e trashëgoi nga babai i saj dhe këtë e bëri në një shoqëri ku ishin dominantë burra të rrezikshëm. Ajo ishte një grua delikate, inteligjente dhe e mprehtë. Me aftësitë e saj në biznes, Hatixhja (r. a.) arriti të bëhet gruaja më e pasur dhe një ndër më të suksesshmet në mesin e tregtarëve të Mekës.

Pas vdekjes së babait të saj, ajo mori përsipër biznesin. Kjo përgjegjësi ishte e vështirë. Ajo tregtonte mallra përmes qendrave të tregtisë të asaj kohe, nga Meka në Siri dhe deri në Jemen. Ajo punësoi burrat më të besueshëm, me karakter të fortë, për të guxuar në përbalimin e rrugëve të rrezikshme tregtare. Biznesi i saj ishte më i madhi se sa të gjitha tregtitë e fisit kurejshit, të kombinuara së bashku, ndërsa mallrat e saj ishin me cilësi të lartë. Politika e saj ishte të punësojë punëtorë të ndershëm, të tillë që ta preantojnë emrin e saj në mënyrën më të

mirë.

Jeta, vepra dhe kontributi i gruas myslimane në dije ka qenë dhe vazhdon të jetë i jashtëzakonshëm. Nga gjithë ajo që u paraqit më lart, është lehtë e kuptueshme se gratë myslimane (gratë e Medinës) janë shquar me angazhim serioz, konkret dhe shumë frytdhënës, duke filluar nga dija islame në Kuran e Hadith, gjithashtu edhe në fusha të tjera si: ekonomi, tregti, mjekësi, politikë e në jetën sociale të çdo individi.

Ajo që mbetet shqetësim, është neglizhimi në mënyrë të vetëdijshme (ose të pavetëdijshme) i shpalosjes së këtyre vlerave dhe kontributeve në shoqërinë e gjerë nga ana e studiuesve dhe kontributdhënësve të kësaj fushe.

Nënat e besimtarëve mbesin ikonat më të forta të angazhimit dhe të vullnetit për të qenë kontributdhënëse në ndryshimin konkret të çdo lëmi që ato përfaqësojnë.

Si në kohën e pejgamberit Muhamed (a. s.), por dhe në kohën tonë, gruaja si shtyllë kryesore e familjes dhe e shoqërisë mbetet të vlerësohet dhe të mbështetet për angazhimin e saj nga gjurmët që lë në jetën e gjithsecilit.

Lusim Allahun e Madhërueshëm t'i shpërblejë në shkallët më të larta të Xhennetit të gjitha gratë, nënat myslimane, për kontributin e tyre në të mirë të shoqërisë dhe të komunitetit tonë.

(Fund)

(Fusnotat, hequr nga Redaksia)



LEGJENDA THOTË: PAS ZBARKIMIT, ANIJET NË FLAKË...

Një invazion fillestar i normanëve ndoqi një ftesë vendore të myslimanëve. Njëri nga emirët e myslimanëve formoi një marrëdhënie intelektuale me Roxherin, të vëllain më të ri të Hautvillëve normanë, i cili nuk e refuzoi ofertën. Nën këto rrethana të favorshme, normanët zbarkuan në Sicili në vitin 1061 dhe filluan të përparonin me shpenzimet e myslimanëve. Dy shekuj pas marrjes së ishullit nga normanët, myslimanët u çrrënjësën nga ishulli.

Shkruan: Kurtali Kurtishi

Duke u bazuar kryesisht në përshkrimin e Ibn Havkalit, në periudhën më të mirë, myslimanëve u atribuohet një popullatë prej 300.000 banorësh në Palermo, nga rreth 500.000 gjithsej në Sicili. Sidoqoftë, do të duket më e arsyeshme të zvogëlohet dimensionet demografik që i atribuohet kryeqytetit në kohën e apogjeut të Islamit sicilian. Studiuesit më afër disiplinave të historisë së qytetit dhe të historisë së urbanizmit supozojnë një popullsi totale që është rreth 100.000 banorë.¹

Në fakt, të dhënat e para (300.000 banorë) duken absolutisht të papranueshme, si në raport me dendësinë relative të popullsisë së qytetit, së bashku me territorin sicilian, si në raport me dimensionet fizike të vetë qytetit.

Megjithatë, edhe hipoteza e dytë (rreth 100.000) mund të nxit disa dyshime dhe të jetë paksa e tepruar.

Ky aspekt i problemit do të kërkonte një vëmendje shumë më të thellë se sa ajo që jemi duke ia kushtuar në këtë rast.



Vërejmë vetëm se një popullsi prej 100.000 banorësh presupozon një densitet prej rreth 150 hektarë shtrirje të qytetit të asaj kohe, më shumë se 650 banorë për hektar.¹¹

KOHA E ASAD BIN EL-FURATIT

Asad bin el-Furati ishte një jurist dhe gjeneral mysliman nga Persia, i cili zbarkoi në Sicili në krye të egalibëve.

I lindur në Harran (Mesopotami), Asadi vinte nga një familje persiane hrasaniane, me traditë ushtarake, të cilët kishin emigruar në Ifriki (Tunizia e sotme) në vitin 761. Edhe pse jetonte në "jetën" e armëve dhe të betejave, i riu Asad preferoi jetën e studimeve dhe të bibliotekave.

Në vitin 788 Asadi shkoi në Medinë, ku juristi Malik ibn Enes tubonte traditat juridike të qytetit në të cilin profeti Muhamed (a. s.) kishte jetuar që nga hixhreti deri në vdekjen e tij, i bindur se, në të vërtetë, fryma origjinale dhe interpretimi më i saktë juridik ishin ruajtur më mirë.

Asadi pastaj shkoi në Irak për të studiuar te themeluesi i medhhebit hanefij,

Ebu Hanife, ku tanimë përgatitja e tij ishte e shkëlqyer.

Kjo përgatitje i mundësoi që të hartojë një tekst ligjor, të ashtuquajturin *Asadija*, e cila ishte ndoshta traktati më i rëndësishëm i malikitëve; më e rëndësishme se kjo vepër konsiderohet vetëm vepra *Muwatta* e Imam Malikut; megjithatë mbeti një tekst i rëndësishëm studimi për këtë shkollë juridike.

Në Ifriki fama e Asadit rritej gjithmonë e më shumë dhe për këtë arsye ai u emërua udhëheqës në vitin 818 nga emiri Zijadullah I, kadiu i Kajrvanit, kryeqyteti i egalibëve, në Tunizinë e sotme.

I vendosur për të organizuar një "xhihad detar", që mund ta ndihmonte në zgjidhjen e disa prej problemeve serioze të brendshme, që ishin kontrast me shumicën e komponentëve berberë dhe atë të ushtrisë arabe, si policë, emiri zgjodhi Asadin të udhëhiqte trupat e armatosura, të cilat ai i nisi nga baza e Suzës (Tunisi).

Mosha pothuajse 70-vjeçare e komandantit nuk nxiti ndonjë koment negativ apo sarkastik, por pati lëvdata për ata që dëshironin të theksonin se një luan (në

arabisht, esed), biri i lumenjve më të mëdhenj - Euftratit (në arabisht, at-Furat), ishte më i miri që mund të zgjedhej për të qenë në krye të ushtrisë.

Nga ana tjetër, përpjekja për ta çliruar Sicilinë merite frymëzim nga kërkesa për ndihmë nga patriarku Fimi, një turban i krishterë i flotës bizantine, i cili i ishte drejtuar emirit të Kajravanit. Fimi kishte për qëllim ta bënte Sicilin të pavarur nga Bizanti, duke vendosur veten në krye të këtij realiteti të ri politik.

Emiri pranoi hipotezën e një aleance me një të krishterë pa hezitim, por nuk ishte e qartë se deri në çfarë mase aderimi në projektin e Fimit ishte serioz.ⁱⁱⁱ

Më 14 qershor të vitit 827, flotat aleate lundronin nga Gjiri i Suzës, dhe pas tri ditësh ato arritën në Mazara në Sicilinë jugperëndimore, ku zbarkimi u zhvillua më 16 qershor 827, nën komandën e Asad ibn al-Furatit.^{iv}

Ata iu bashkuan ushtrisë besnike ndaj Fimit, por aleanca shpejt filloi të përkeqësohet - një pjesë e myslimanëve shkëmbeu disa prej partizanëve të Fimit me trupat armike, dhe plasë një përlëshje mes tyre. Edhe pse trupat e Fimit u urdhëruan t'i vendosin një shenjë dalluese në helmata e tyre, Asadi njoftoi qëllimin e tij për të vazhduar fushatën pa to.^v

Dy ushtritë u përlëshën në një fushë në juglindje të Mazarës, ku trupat e Asadit, pas nxitjeve nga komandanti i tyre, arritën një fitore.

Balata u detyrua të tërhiqej fillimisht në Enna dhe pastaj në Kalabri, me shpresën e rekrutimit të trupave të reja.^{vi}

Ndërkohë Asadi u largua nga Mazara në Ebu Zaki el-Kinanin dhe u kthye në Sirakuzë. Ushtria myslimane përparoi përgjatë brigjeve jugore drejt kryeqytetit të ishullit, por në Acrae një udhëheqës i qytetit u ofroi haraç në këmbim që të ndalte marshin ushtria myslimane.

Ky propozim u bë ndoshta për të fituar kohën e nevojshme për qytetin, për t'u përgatitur më mirë për një rrethim të mundshëm. Asadi ndaloi trupat e tij për të pushuar disa ditë. Në të njëjtën kohë, Fimi u pendua për aleancën e tij me egallibët dhe hapi fshehurazi kontakte me imperialët, duke i këshilluar ata që t'u rezistojnë arabëve.^{vii}

Sipas një legjende, emiri i berberëve dërgoi në Sicili 40.000 luftëtarë, duke përfshirë edhe udhëheqësin e quajtur Hal-kamo. Ai pasi zbarkoi në Mazara, u vuri flakën anijeve, për t'u treguar se nuk kishte kthim prapa dhe se Sicilia në një mënyrë apo tjetër duhej çliruar.^{viii}

Ndërkohë, myslimanët kishin rifilluar avancimin e tyre të rrethonin qytetin. Bi-

zanti, i cili në të njëjtën kohë u detyrua të përballët me myslimanët në Kreta, nuk ishte në gjendje të dërgonte përfundim në Sicili; ndryshe nga arabët, të cilët morën përfundim nga Afrika.

Justian Participatio, udhëheqës i Venedikut, si dhe konsull i Perandorisë Bizantine, nxitoi të ndihmonte qytetin, por nuk ishte në gjendje të detyronte myslimanët që mos e mbajnë të rrethuar qytetin.

Sidoqoftë, banorët filluan të vuanin nga mungesa e furnizimeve, si dhe nga shpërthimi i një epidemie në pranverën e vitit 828, e cila i kushtoi me jetë Asadit. Ai u zëvendësua nga Muhamed bin ebu el-Xhawari.^{ix}

KULTURA ARABE

Profesori i njohur Karim Hannachi argumenton se do të duheshin me mijëra faqe për të njohur gjithçka që arabët i dhanë kulturës në Sicili, prandaj do të mundohemi të bëjmë një përmbledhje të shkurtër.

Gjatë periudhës në të cilën Sicilia ishte nën sundimin mysliman, deri në fillim të shekullit XIII, kishte burra me kulturë të lartë, veçanërisht nëpër xhamia, ku studionin dhe mësonin leksikografinë, gramatikën dhe shkencat fetare. Pastaj, jurisprudencën (fikhu), hadithi – tradita e Pejgamberit (a. s.) dhe kiraeti – leximi i Kuranit.

Linguisti më i rëndësishëm i ishullit ishte sigurisht Ibn Rashik, i lindur në Afrikën veriore në vitin 1000 dhe emigroi në Mazara del Vallo, ku shkroi një nga veprat më të bukura poetike të kohës, *Kitab el Umda*, i frymëzuar nga jeta dhe peizazhi sicilian, por nga mënyrat tipike myslimane. Ibn Rashiki vdiq në moshën 70-vjeçare, duke lënë prova të poezisë shumë të lartë.

Para se të futemi në referencat letrare, duhet të kujtojmë dijetarët sicilianë, siç janë: sirakuziani Ibn al-Fahham (1062 – 1122), juristi el-Mazari (vdiq 1141) dhe mistiku apo sufisti al Karkunti (vdiq 983), pastaj ndër gramatikanët, filologët, retorikët dhe dijetarët sicilianë al-Kattani (vdiq 1118) dhe Ibn Rashiki (vdiq 1070).

Një doktrinë i njohur, i lindur në Sicili dhe i emigruar në Lindje, ishte Ibn Zafur as-Sakili (vdiq 1171), autor i traktatit "Konfrontimet politike", kushtuar Ibn Haxherit, mysliman i njohur nga Palermo, përkthyer në italisht nga Michele Amari. Ndër filologët e Palermos, më i madhi ishte Ibn Katta (1041 – 1121), por vepra e tij është humbur, gjë që lë një boshllëk të madh për njohjen e historisë së

letërsisë arabe siciliane. Ishte autor i një historie të Sicilisë, e cila u humb bashkë me një përmbledhje të poetëve arabo-sicilianë "Perla të çmuara nga poetët e ishullit", prej së cilës u gjetën vetëm 66 fragmente.

Ndoshta të gjitha u humbën kur Ibn Katta, me ardhjen e normanëve, vendosi të emigrojë në Egjipt.

Dihet që vepra përbëhej prej 170 faqeve për poetët arabë të Sicilisë, nga shek. X deri në shek. XII, dhe prej tyre kanë mbetur vetëm 70.

Prej poetëve më i rëndësishëm është sirakuziani Ibn Hamdis, i cili ka lënë një vepër prej rreth 6.000 vargësh. Biografia e tij thotë se është nga Sirakuza, por disa burime të tjera thonë se ka lindur në Noto në vitin 1055. Sigurisht, e ka parë rënien e Mbretërisë Kalbite dhe shkatërimin e saj. Pas pushtimit norman ka emigruar në Sevilja, ku ka qenë mik i emirit al-Mu'tamid. Pas rënies së emirit të Seviljes shkon në Afrikë, ku këndoi për Dinastinë Zirite. Ibn Hamdis vdiq në moshën 80-vjeçare, në vitin 1133, në Bi-giaya ose në Maiorka. Nga mërgimi këndoi Sicilinë e tij.

Gjithashtu, duhet të përmendim dy Abdurrahmanat - njëri nga Butera dhe tjetri nga Trapani, i njohur si sekretar i Ruxherit, të cilët lavdërojnë pallatet dhe kopshtet mbretërore të Palermos.

Këta dy, sipas dijetarëve sicilianë, janë emblemat e poezisë arabo-siciliane.^x

RËNIA E SICILISË

Për ta kuptuar rënien e Sicilisë në fund të shek. XI, është e nevojshme që shkurt të sqarojmë kontekstin e myslimanëve në atë kohë.

Në shek. XI bota myslimane ishte e kyçur në luftë mes shiitëve dhe sunitëve, mes tajfave (grupeve) të ndryshme në Spanjë dhe mes princërve të ndryshëm të Lindjes.

Bota krishtere, duke pasur dobi nga këto përçarje, ndërmori një ofensivë të madhe nga të katër anët.

Në Spanjë zbriti një aleancë e francezëve dhe forcave të tjera evropiane, ku e hoqën kontrollin e myslimanëve. Barbaro u mor në vitin 1063, pasuar me therje dhe dhunime masive të grave myslimane.^{xi}

Në lindje lufta e brendshme mes myslimanëve i ftoi Kryqëzatat (1095 – 1291), një sulm i fuqishëm dyshekullor që kërcënoi me zhdukje gjithë atë që ishte islame, gjë që nuk ka ndodhur me selxhukët dhe mamlukët, në veçanti, të cilët kanë luftuar në shumicën e luftërave kun-

dër kryqëtarëve dhe aleatëve të tyre mongolë.

Sicilia pati të njëjtat simptoma si-kurse Spanja dhe Lindja, dhe ajo nuk pati forca të myslimanëve për të luftuar. Dy shekuj pas marrjes së ishullit nga normanët, myslimanët u çrrënjësën nga ishulli.

Fillimi i fundit të myslimanëve në Sicili zuri në çelje të shek. XI, me një luftë të hapur mes Kalbid Emir-it nga Palermo dhe Ziridit nga Tunizia. Plotësisht të vetëdijshëm nga kjo ngatërsesë e brendshme mes myslimanëve sicilianë, aty erdhi një politikë parësore për forcat krishtere për ta marrë ishullin.

Së shpejti, normanët arritën t'ua rrëmbenin ishullin myslimanëve. Normanët, të cilët pastoronin nëpër Italinë jugore, ishin një bandë e vogël dhe myslimanët nuk ishin të ndarë, kurse normanët nuk kishin pikëmbështetje, dhe brenda një gjenerate, banda e vogël e aventurierëve formoi një mbretmbështetje dhe brenda një gjenerate, banda e vogël e aventurierëve formoi një mbretëri për vete.

Lufta e brendshme e vazhdueshme mes kryekomandatëve vendorë ishte faktori kryesor në pushtimin e lehtë dhe të shpejtë të normanëve në vitin 1070.

Në fakt, një invazion fillestar i normanëve ndoqi një ftesë vendore të myslimanëve. Njëri nga emirët e myslimanëve formoi një marrëdhënie intelektuale me Roxherin, të vëllain më të ri të Hautvil-lëve normanë, i cili nuk e refuzoi ofertën. Nën këto rrethana të favorshme, normanët zbarkuan në Sicili në vitin 1061 dhe filluan të përparonin me shpenzimet e myslimanëve.

Kjo dukej se nuk i mërzoiste aq myslimanët, madje edhe kur normanët u bënë gjysmë pronarë të ishullit, kryetarët e myslimanëve vazhdonin të luftonin njëri-tjetrin. Në fakt, sicilianët e krishterë më pak e përkrahnin pushtimin norman se sa fraksionet myslimane. Në vitin 1062, Roxheri I pati sukses në pushtimin e Mesinës; në vitin 1072 Palermo ra dhe gjatë njëzet viteve të tjera i gjithë ishulli erdhi nën një kontroll të sigurt të normanëve.

Komunitetet arabofolëse mbijetuan në Sicili për më shumë se dy shekuj nën sundimin norman. Kjo mbijetesë tregon ndikimin e gjerë Islam të mësimin dhe civilizimit në të gjitha mënyrat dhe format.^{xii}

Pas zbarkimit të normanëve në shkurt të vitit 1061 në majën verilindore të ishullit, krijuan një grup të armatosur në Messina. Rreth një dekade më vonë, në



vitin 1072, Palermo kapitulloi pas pesë muajsh rrethim dhe bëhet kryeqyteti nën kontrollin e normanëve.

Sulmi dhe pushtimi i kështjellave tjera kryesore të ishullit (Trapani në vitin 1077, pastaj Tormina Girgenti në vitin 1087 dhe Castrogiovanni në vitin e ardhshëm) nxitën dhunë dhe shkatërrime në pjesë të ndryshme të vendit.

Jo më pak se 30 vjet ishin të nevojshme për kontrollimin e të gjithë ishullit. Një periudhë e gjatë dhune kaploi territoret që ishin gjatë periudhës myslimane.

Dëshmitë e rralla të kësaj epoke duket se përshkruajnë një vend të mbushur me gërmadha, ku ndërtesat më të bukura te epokës islame ishin shkatëruar.

Pushtimit norman, pas shkatërimit që ka bërë, i shtohen - duke filluar nga gjysma e dytë e shek. XII - edhe presionet dhe masakrat ndaj popullatës.^{xiii}

Në vitin 1161 nis masakra e Palermos, ku myslimanët më vonë kufizohen vetëm në brendi të një lagjeje të qytetit, të cilët më pas do të zhvendosen në fshatra, ku banonin myslimanët. Kjo periudhë e gjatë e përgjakur shkaktoi braktisjen e Sicilisë nga një numër i madh i popullsisë që është vështirë të specifikohet, të cilët u nisën në drejtim të brigjeve të Afrikës.

Ata të cilët mbetën, u përpoqën të gjejnë një strehë të sigurt nëpër fshatat e fortifikuara, nëpër vende ku mund të mbronin veten më lehtë. Veçanërisht në rajonin perëndimor të ishullit.

Një valë e re masakrash goditi ishul-

lin në vitet 1189 – 1190, ku me vdekjen e Uiliamit II thyhet ekuilibri social dhe politik, i cili kishte siguruar një periudhë të shkurtër paqeje.

Pasojat e goditën popullatën myslimane nëpër fshatra, të cilët vazhdonin rrugën drejt vendeve më të sigurta.

Në vitet 1189 – 1190 u shkatëruan shumë shtëpi. 100.000 myslimanë, sipas veprave të Enrico VI, u detyruan t'ia mësynin malit, duke ikur nga lufta.

Disa dekada më vonë një lëvizje e kryengritjes nisi një luftë të gjatë civile, një ndër momentet e fundit të historisë së Sicilisë arabe-myslimane.

Shumica e myslimanëve të ishullit u dëbuan në Lucera dhe Pulja. Dëbime të reja ndodhën në vitin 1239 dhe në fund të vitit 1243, ku qendrat e fundit islame të Sicilisë, Jato dhe Entella, u pushtuan nga Federiku II.^{xiv}

Zhdukja e popullatës myslimane në ishull, me dëbimin e tyre gjatë gjysmës së parë të shek. XIII, ishte e përgjithshme? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje është shumë e vështirë; ajo që është e sigurt, është fakti se duke filluar prej kësaj periudhe myslimanët e Sicilisë nuk ekzistuan më si një shoqëri e veçantë që njihet në popull.

Duke e kufizuar periudhën me ekspeditën e parë arabe, në vitin 827 dhe dëbimi i fundit në vitin 1243, prania e Islamit në Sicili ka zgjatur pak më shumë se katër shekuj.^{xv}

(Vazhdon)

ⁱ P. Cuneo; *Storia dell'urbanistica*, Il mondo Islamico, Laterza, Roma – Bari, 1986, fq. 171

ⁱⁱ Federico Cresti, *Citta, territorio, popolazione nella Sicilia musulmana*, Mediterranea, 2007, fq. 27

ⁱⁱⁱ Michele Amari, *Storia dei Musulmani di Sicilia*, a cura di Carlo Alfonso Nallino, edizione riveduta e coretta da C.A. Nallino, Catania, Romeo Prampolini, 1933 – 39, fq. 3 voll. (in 5 tomi)

^{iv} Michelangelo Schipa, *Eufemio da Messina*, in *Enciclopedia italiana*, Roma, Istituto dell'Enciclopedia Italiana, 1932; URL: 28.10.2015

^v John Ragnell Bury; *A History of the Eastern Roman Empire – From the Fall of Irene to the Accession of Basil I (A.D. 802 – 867)*, London, Macmillan and Co., 1992, fq. 298

^{vi} John Ragnell Bury; *A History of the Eastern Roman Empire – From the Fall of Irene to the Accession of Basil I (A.D. 802 – 867)*, London, Macmillan and Co., 1992, fq. 298-299

^{vii} Po aty, fq. 299

^{viii} Alberto Costantino, *Gli Arabi in Sicilia*, Antares, Palermo, 2005, fq. 13

^{ix} Bury, fq. 300 – 302

^x Alberto Costantino, *Gli Arabi in Sicilia*, Antares, Palermo, 2005, fq. 20 – 21

^{xi} Salah Zaimeche, *Sicilia, ngritja dhe rënia e myslimanëve*, Logos -A, 2013, Shkup, fq. 15

^{xii} Salah Zaimeche, *Sicilia, ngritja dhe rënia e myslimanëve*, Logos -A, 2013, Shkup, fq. 17 – 18

^{xiii} Federico Cresti, *Citta, territorio, popolazione nella Sicilia musulmana*, Mediterranea, 2007, fq. 29

^{xiv} Federico Cresti, *Citta, territorio, popolazione nella Sicilia musulmana*, Mediterranea, 2007, fq. 30

^{xv} Po aty, fq. 31

ZEQATI - KUSHTI I TRETË I FESË ISLAME



Nga urdhëresat kuranore rezulton se zeqati është detyrë dhe e drejtë. Detyrë e të pasurve ndaj të varfëve, ndërsa e drejtë e të varfëve ndaj të pasurve. Këtë të drejtë e përcakton Allahu fuqplotë.

Shkruan:
Prof. dr. Abdulxhemil Nesimi

Agjërimi i muajit të bekuar të Ramazanit është obligim nga Allahu fuqplotë për besimtarët. Rrethimisht, është dhuratë dhe nder nga Zoti për ne, sepse drita e tij (e Ramazanit) rrezaton në zemrat dhe shpirtat e besimtarëve, të cilat kënaqësinë e vet e gjejnë në adhurimin e Allahut fuqplotë. Për këtë arsye, disa myslimanë të cilëve Allahu fuqplotë u ka dhuruar pasuri, e pastrojnë pasurinë e tyre nëpërmjet zeqatit, të cilin detyrim mund ta kryejnë edhe gjatë muajve të tjerë, mirëpo, për t'i shtuar edhe më tepër veprat e mira, e kanë bërë

shprehni që gjatë këtij muaji të japin zeqatin e pasurisë së tyre. Nisur nga kjo, zeqati është njëra prej pesë shtyllave mbi të cilat është ngritur Islami. Ai është ibadet (adhurim) që i kushtohet Allahut të madhërishtëm; njëkohësisht, është institucion mjaft i rëndësishëm dhe i dobishëm për myslimanët.

Përmes kryerjes së këtij obligimi, myslimani e pastron jo vetëm shpirtin e vet, por edhe pasurinë që ia ka dhuruar dhe mundësuar Allahu i gjithëmëshirshëm.

Për t'i motivuar besimtarët në dhënien e zeqatit, njëkohësisht për shpërblimin e shumëfishit dhe bekimin e pasurisë së zeqatëdhënës, Allahu fuqplotë e ilustron

me shembull konkret dhe thotë Furnizuesi: *“Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e Allahut është si një kokërr prej së cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron; Allahu është Bujar i Madh, i di qëllimet.”*

DOMETHËNIA E FJALËS ZEQTATË (ZEKAT)

Nocioni *“zeqatë” (zekat)* është term arab dhe në gjuhën shqipe do të thotë *pastrim, shtim, rritje* etj. Në aspektin terminologjik zeqati shpreh veprimin e dhënies së një malli në sasi dhe masë të caktuar

nga persona të caktuar personave dhe vendeve të caktuara.

Në kuptimin shpirtëror zeqatë do të thotë pastrim nga mëkatet dhe kënaqje e vullnetit dhe e urdhrit të Allahut të madhërishtëm. Zeqati e pastron dhe e çliron njeriun nga makutëria ndaj të mirave të kësaj bote. Ai të shpie në njohjen se vlera e njeriut matet sipas virtyteve morale dhe humane, e jo sipas pozitës dhe madhësisë së pasurisë.

Me zeqatë nënkuptojmë edhe pastrim të pasurisë nga e drejta (haku) e huaj, sepse njeriu kurrë nuk është i sigurt, edhe krahas kujdesit të tij, se diç e palejueshme nuk është futur në pasurinë e tij.

Institucioni i zeqatit u bë obligim për myslimanët qysh në Mekë. Mirëpo, myslimanët atëbotë qenë të persektuar e të keqtrajtuar nga ana e idhujtarëve mekas, kështu që në pikëpamje materiale ishin shumë të dobët, andaj urdhëresa e zeqatit nuk mund të zbatohet në tërësi.

Kjo dispozitë përsëri është theksuar në Medinë, në vitin e dytë pas Hixhretit, në ajetin: *“Falni namazin dhe jepni zeqatën; dhe falni me ata që falen (bini në ruku me ata që bien)”*, prej kur edhe filloi që zeqati të kryhet në praktikë.

Vlera, përkatësisht lartësia e zeqatit, nuk është caktuar me Kuran, siç nuk janë precizuar më detajisht as edhe urdhëresat tjera, siç janë namazi, haxhi etj. Muhamedi (a. s.) e ka caktuar përqindjen e ndarjes së zeqatit: *“Ndajeni një të dyzetën pjesë të pasurisë suaj”*, që d. t. th.: 2.5%. Ndërsa, Ebu Bekri dhe Omeri e kanë qartësuar detajisht këtë me rregulloret e tyre.

Arabët më të pasur, të cilët në fillim qenë të prirë të kalonin në Islam, këtë urdhëresë e shikonin me dyshim, sepse Islami u paraqiti si sistem i ri social. Mbledhja e zeqatit, si edhe e tatimeve dhe kontributeve të tjera, ishte brengë e shtetit islam. Edhe pse bota arabe gjatë jetës së Muhamedit (a. s.) e pranoi Islamin masivisht, përsëri shumëkush nuk mundi t'i flakte shprehinë dhe zakonet e veta pagane. Prandaj, ca fise pas vdekjes së Muhamedit (a. s.) refuzuan ta japin zeqatin dhe kaluan në anën e ca pejgamberëve të rrejshëm - si Musejleme el-Kedhabi - duke deklaruar se nuk e lëshojnë Islamin, por vetëm refuzojnë ta japin zeqatin. Kalifi Ebu Bekr pa kurrfarë ngurrimi luftoi kundër këtyre fiseve, duke i detyruar ta jepnin zeqatin.

Zeqati, si detyrë e domosdoshme fetare (farzi ajn) e çdo myslimani dhe myslimaneje të pasur, të cilët posedojnë sasi të caktuar të pasurisë - nisabin, është i obliguar me burimet kryesore të Sheriatit,

Kuran dhe Hadith.

Obligueshmëria e zeqatit rrjedh nga më shumë se 70 ajete kuranore, e në veçanti është potencuar në kaptinën Et-Teube, ku përmend tetë kategori të myslimanëve të cilëve u takon zeqati: *“Sadaka (zekati) është pa dyshim për të varfrit, nevojtarët, për ata që e mbledhin, për ata zemrat e të cilëve duhet përvetësuar, për lirim të skllëvërve, për borxhlinjtë e mëdhenj, për luftëtarët në rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbebur në rrugë. Allahu ka përcaktuar kështu. Allahu Di çdo gjë dhe është i Urtë.”* (Et-Teube: 60)

Zeqati bashkë me namazin përmendet në 32 vende. Ajetet me kuptimin *“Falni namazin dhe jepni zeqatin”* ose *“e falin namazin dhe e japin zeqatin”*, të cilat e pohojnë karakterin kategorik të zeqatit, të cilat përsëriten në më shumë se dyzet vende të Kuranit me anë të foljeve të dialektave të ndryshme.

KURANI E QARTËSON SE KUJT DUHET T'I JEPET ZEQTATI

Nëse e sodisim Kuranin, do të shohim se i Madhërishti i drejtohet Muhamedit (a. s.) duke i thënë: *“Merr prej pasurisë së tyre (zeqatin), që t'i pastrosh me të dhe t'u shtosh begatinë...”* (Et-Teube: 103) Pra, e urdhëron Pejgamberin për organizimin dhe zbatimin e dhënies dhe mbledhjes së zeqatit. Ky ajete, bashkë me ajete që tregojnë se kujt duhet t'i jepet zeqati, tërheqin vëmendjen në mënyrë të veçantë, me qëllim që të mos lihet ndonjë boshllëk.

Siç dihet, në hadithin e njohur si *“Hadithi i Xhibrilit”*, tregohet se Xhibrili i pati shkruar Pejgamberit me pamje njeriu dhe e ka pyetur për çështje të ndryshme. Ndër këto, pyetjes së tij se *“ç'është Islami”*, Pejgamberi i është përgjigjur: *“Islami është të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij, të falësh namazin, të japësh zeqatin, të agjërosh Ramazanin dhe të bësh Haxhin, në qoftë se ke mundësi.”* Kjo përgjigje dhe dialogë të ngjashëm janë dëshmi që tregojnë për detyrimin e dhënies së zeqatit.

Në bazë të ajeteve të cituara, zeqati jepet në arkën e përbashkët (*Bejt'ul-mal*), nga e cila plotësohen kategoritë e përmendura. Në kushtet në të cilat sundon ligji i Sheriatit, kjo është në kompetencë të shtetit, kurse në rrethanat sikurse janë kushtet tona, ky është detyrim dhe emanet i Bashkësisë Fetare Islame. Prandaj, te zeqati nuk ka marrëveshje, sepse ky është detyrim (farz), sikurse nuk ka ujdi

me namazin, me agjërimin - a duhet të agjërohet, me Haxhin e kështu me radhë. Për çdonjërin nga këto detyrime besimtarët duhet të thonë: *“E dëgjuam dhe i bindemi.”*

Në mënyrë të veçantë, zeqati nuk është vetëm një ndihmë materiale-pasurore, por një adhurim si namazi, si agjërimi dhe si haxhi. Njeriu që beson, me anë të zeqatit zbaton një urdhër të Zotit, duke fituar shpërblim për ahiretin. Ndërkaq, shpërblimi i fituar është elementi më i rëndësishëm që e formon jetën e pasme, para së cilës do të ndodhet njeriu pas bëmave të tij në këtë botë.

Për sa u përket adhurimeve, ato mund të jenë fizike (trupore) si: namazi dhe agjërimi, ndërkaq zeqati është adhurim që ka të bëjë me kapitalin dhe shpreh një organizim që synon ngritjen e nivelit të gjendjes dhe mirëqenies shoqërore jo vetëm të një grupi, por të gjithë shoqërisë. Madje, zeqati nuk është një institucion ndihme i rekomanduar siç janë institucionet e solidaritetit dhe të ndihmës në sisteme të tjera; përkundrazi, është një prej elementeve kryesore mbi të cilin ngrihet feja.

Nga urdhëresat kuranore rezulton se zeqati është detyrë dhe e drejtë. Detyrë e të pasurve ndaj të varfëve, ndërsa e drejtë e të varfëve ndaj të pasurve. Këtë të drejtë e përcakton Allahu fuqplotë, sepse Ai është pronari i vërtetë i pronës dhe i pasurisë. Prandaj, është eliminuar truallit që do t'i linte shteg të pasurit që, duke i dhënë zeqatin të varfrit, ta linte atë nën detyrimin e mirënjohjes.

DETYRAT NË ISLAM

Detyrat në Islam janë me funksione të caktuara, të përcaktuara në jetën e individit dhe të shoqërisë islame, dhe çdo neglizhim ose keqzbatim i këtyre detyrave çon në prishjen e ekuilibrit qiellor, duke shkaktuar probleme dhe trazira në jetën e njerëzve. Kështu që, kur një mysliman nuk e kryen detyrën e tij të caktuar nga Allahu fuqplotë, ai besimtar jo vetëm se ka bërë mëkat të madh, pasi nuk i është bindur urdhrit të Krijuesit, njëkohësisht ka përgjegjësi tjetër, sepse ka shkaktuar çrregullime në sistemin ekonomik dhe financiar të shoqërisë dhe të shtetit islam, duke krijuar varfëri dhe mungesa investimesh në sfera të ndryshme të jetës. Nëse myslimanët nuk e japin zeqatin, atëherë me çfarë do të paguhen grupet përfituese të zeqatit, të cilat janë caktuar nga ana e Krijuesit?! *“Zeqati është për të varfrit, për fukananë, për punonjësit që merren me zeqatë, për zemërdobët, për skllëv-*

rit, për borxhliun, për ata që janë në rru-gën e Zotit, për të mbeturin në rruqë - de-tyrë prej Allahut. Allahu është i Ditur dhe i Urtë.” (Teube: 60)

Në qoftë se ne sot nuk e paguajmë ze-qatin, atëherë me çfarë do të mbahet Fa-kulteti i Shkencave Islame?! Me çfarë do të mbahen medresetë, studentët, vakëfet, xhamitë, jetimët etj.?! Prandaj i ka mbu-luar varfëria, skamja dhe injoranca ven-det myslimane, të cilat i njohin ligjet e Zotit, por nuk i zbatojnë ato.

Pejgamberi (a. s.) ka thënë: *“O mu-haxhirë, pesë gjëra e lus Allahun të mos i arrini: Kur të shfaqet hapur imoraliteti në një popull, atëherë ata do të sprovohen me sëmundje dhe dhimbje të cilat nuk kanë qenë kurrë më parë. Kur njerë-zit të mashtrojnë në matje dhe në pe-shore, atëherë do të sprovohen me vite të vështira, me mungesë ushqimi dhe me diktatura. Kur njerëzit të ndalen dhe mos ta japin zeqatin e pasurisë së tyre, atë-herë do t'u ndalet shiu nga qielli dhe, po të mos ishin kafshët, kurrë nuk do t'u binte shi. Kur njerëzit do të thejnë besën dhe premtimet, atëherë Allahu do t'u çojë udhëheqës nga jashtë, të cilët do t'u grabisin pasurinë atyre. Dhe, kur ima-mët të mos punojnë me atë që Allahu e ka zbritur në Librin e Tij, atëherë Allahu do të hedhë mes tyre përçarje dhe armi-qësi.”*

Komentuesi bashkëkohor Muhamed Reshid Rida në komentën e tij (El-Menar), gjatë komentit të ajetit të zeqatit, ka thënë: *“Islami me obligimin e zeqatit dal-lohet mbi të gjitha fetë dhe ligjet tjera. Këtë gjë e pohojnë edhe intelektualët dhe njerëzit e mençur prej tërë botës. Sikur myslimanët ta kishin kryer siç duhet këtë shtyllë të fesë, në mesin e tyre nuk do të gjendej asnjë i varfër, asnjë fukara dhe ne-vojtari, sepse Zoti i ka dhënë begati dhe mirësi të pafund, por pjesa më e madhe e tyre e kanë lënë këtë obligim. Si rrjedhojë e këtij neglizhimi, ata kanë korrur atë çka kanë mbjellë - duke u bërë populli me gjendjen më të keqe ekonomike dhe poli-tike. Ata kanë humbur sundimin, dinjite-tin dhe nderin duke u bërë vartës dhe nevojtarë të popujve të tjerë; madje, edhe në edukimin dhe arsimimin e bijve të tyre.”*

Meqë zeqati është e drejtë për të var-frit dhe obligim i të pasurit, kam bindjen se sikur të gjithë myslimanët e botës të jepnin zeqatin, në këtë rast nuk do të mbe-tej asnjë nevojtar mbi sipërfaqen e tokës. Përderisa gjenden të varfër në mesin tonë, kjo dëshmon se përgjegjës për këtë gjen-dje janë të pasurit që nuk e japin zeqatin.

Të shumtë janë ata të cilët kur flitet



për zeqatin, automatikisht bëjnë ndërlidhje mes tatimit apo taksës shtetërore, të cilat, sipas tyre, janë si zëvendësim i “zeqatit” në konceptin islam. Përderisa i pa-guajnë tatime shtetit për bizneset, të ardhurat dhe pronat që kanë – thonë ata - atëherë nuk kanë fare obligim të japin ze-qatë dhe se nuk janë në shtet islam, madje, duke sugjeruar se “duhet të bëhen hulum-time më të detajuara dhe korrigjime, se jemi në shekullin XXI, ku shumë sende janë ndryshuar”.

Që ta kuptojmë këtë çështje, në vijim do të ofrojmë shpjegime për të bërë dallim mes tatimeve shtetërore dhe zeqatit. Si rrjedhim, për shkak se ato nuk mund ta zëvendësojnë zeqatin.

Fillimisht, tatimet nuk e zëvendësojnë në asnjë mënyrë zeqatin, ngase këto të dyja kanë dallim në emërtim dhe termi-nologji. Termi “zeqatë” gjuhësisht ka do-methënie e pastrimit të zeqatëdhënësit, por edhe të vetë pasurisë, kurse tatimi nënkupton imponimin e një shume të cak-tuar dhe detyrimin për diçka që është vë-shtirë e përballeshme për individin ose shoqërinë. Zeqati krijon bindjen se pasu-ria e tillë do të rritet, kurse tatimi bën të kundërtën.

Sipas konceptit islam, zeqati është adhurim me të cilin obligohet myslimani si falënderim ndaj Allahut dhe afrim tek Ai. Ndërkaq, tatimi ose taksa është një de-tyrim i pastër qytetar-shoqëror dhe nuk konsiderohet si adhurim. Të parin e ka ur-dhëruar Allahu, kurse të dytin e detyron faktori njeri.

Zeqati jepet brenda limiteve të cak-tuara dhe në mungesë së sasisë - nisabit, i varfi nuk jep zeqatë, në dallim nga tati-met, ku nuk bëhet dallim mes të varfrit dhe të pasurit, ku secili është i obliguar të paguajë taksat dhe tatimet ndaj shtetit.

Shuma mbi të cilën obligohet zeqati, po edhe përqindja e pasurisë që nxirret si zeqatë, thelbësisht dallon nga ajo e tati-meve. Pasuritë për të cilat obligohet ze-qati, si dhe përqindjet e zeqatit të tyre, janë statike, dhe ato nuk ndryshojnë, pa-varësisht nga rrethanat e kohës a të vendit, kurse ato të tatimeve janë të lëvizshme dhe gjithnjë me tendencë ndryshimi, qoftë për llojin, qoftë edhe për përqindjet e tyre.

Fondacionet e zeqatit janë të përcak-tuara nga Allahu i madhërishtëm në librin e Tij fisnik. Ato janë të qarta, të njohura dhe nuk ndryshojnë, prandaj nuk lejohet kurrsesi të ketë devijime në orientimin e pasurive të zeqatit, ose të fondacioneve të tij. Synimi i tyre është shpirtëror, moral dhe shoqëror. Ndërkaq, shpenzimi i bu-xheteve tatimore bëhet zakonisht për mbulimin e harxhimeve të sektorëve të shërbimeve publike, por gjithnjë me mun-dësi ndryshimi dhe orientimi për fonde dhe caqe të reja. Prandaj edhe objektivat e tatimeve janë të zhveshura nga ana shpirtërore e morale.

Nisur nga këto fakte, konstatojmë se zeqati nuk mund të zëvendësohet me ta-time të çfarëdo lloji qofshin ato, madje edhe nëse i pasuri i paguan tatime shtetit islam, në kuptimin e plotë të fjalës. Mi-rëpo, duhet ditur se zeqati duhet të nxirret vetëm nga shuma e pasurisë së mbetur, pasi që të jenë paguar prej saj tatimet - taksat dhe të gjitha detyrimet e tjera fi-nanciare, e jo nga fitimi bruto i asaj pasu-rie.

OBJEKTIVAT E ZEQATIT DHE EFEKTET E TIJ NË SHOQËRI

Ndër avantazhet e zeqatit në Islam është se ai është adhurim individual dhe sistem shoqëror në të njëjtën kohë dhe si

sistem, zbatimi i të cilit kërkon që punon-jësit ta mbledhin atë nga të pasurit dhe ta shpërndajnë në llojet e tij ligjore, ndërkaq të angazhuarit për grumbullimin e zeqa-tit paguhen prej tij.

Për shkak se zeqati është pjesë e or-ganizimit të shoqërisë myslimane, ai ka shumë efekte në shoqëri, disa prej të ci-lave do t'i potencojmë në vazhdim:

1. Zeqati ishte legjislacioni i parë i or-ganizuar që e arriti sigurimin shoqëror në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse. Imam el-Zuhri i shkroi Omar bin Abdula-zizit në lidhje me zeqatin: *“Në të ka një pjesë për përkohshmërinë dhe ata që janë me aftësi të kufizuara; një pjesë për të gjit-hë ata që vuajnë nga paaftësia, që nuk mund të shërohen dhe të lëvizin në tokë; një pjesë për nevojtarët që kërkojnë ndihmë; një pjesë për ata që janë në burg dhe nuk ka kush kujdeset; një pjesë për ata që janë prezent në xhami, ndër të var-frit, që nuk kanë ofertë e as janë pjesë-marrës, d.m.th. nuk kanë rroga të rregullta dhe nuk lypin prej njerëzve; një pjesë për ata që i ka goditur varfëria dhe kanë borxh; dhe një pjesë për secilin udhëtar që nuk ka strehë dhe nuk kanë njerëz të afërt që të strehohen tek ta.”*

2. Zeqati ka rol të rëndësishëm në sti-mulimin e lëvizjes ekonomike, sepse nëse një mysliman i depoziton paratë e tij, ai është i detyruar të paguajë zeqatin për të me një shumë prej 2.5% në vit, gjë që çon në pakësimin e pasurisë. Prandaj, ai është i prirur ta tregtojë atë, në mënyrë që të mund të paguajë zeqatin nga fitimet e tij dhe kështu paratë do të nxirren nga the-sari i qarkullimit, ekonomia do të lëvizë dhe do të jetë aktive, kurse populli do të përfitojë nga pasuria e tij.

3. Zeqati i ul dallimet midis njerëzve. Islami njih dallimet në furnizim, sepse është rezultat i dalli-meve në aftësi dhe ener-gji, por Islami refuzon që njerëzit të bëhen dy klasa - njëra që

jeton në lumturi dhe tjetra në ferr. Zeqati është një nga mjetet e shumta që Islami përdor për ta arritur këtë qëllim.

4. Zeqati ka rol të madh në eliminimin e lypjes dhe në inkurajimin e reformës mes të dyve, edhe nëse reformatorët de-tyrohen të mbajnë barrë financiare, sepse ato mund të paguhen nga Zeqati.

5. Zeqati ndihmon për të gjetur alter-nativë islame për kompanitë tregtare të si-gurimeve, të cilat marrin nga masa nga e cila përfitojnë individë të caktuar për të mbushur xhepat e pronarëve të tyre të pasur. Sa i përket Zeqatit, ajo merret nga të pasurit dhe u jepet të varfërve. Besoj se ka dallim midis kësaj dhe asaj.

6. Zeqati e çliron marrësin e saj nga nevojat dhe vështirësitë - qofshin ato ma-teriale, siç është ushqimi, veshmbathja dhe strehimi; apo është nevojë psikolog-jike, siç është martesja; ose nevojë inte-lektuale siç janë librat shkencorë, sepse zeqati shpërndahet për të gjitha këto ne-voja. Në këtë mënyrë i varfëri mund të participojë në obligimet e tij sociale, që të ndiejë se edhe ai është anëtar i gjallë në trupin e shoqërisë, në vend që të preoku-pohet me kafshatën e gojës.

7. Zeqati e pastron individin nga së-mundja e zilisë dhe e urrejtjes, sepse per-soni i varfër kur sheh njerëzit përreth tij që jetojnë jetë luksit dhe nuk i shtrin dorën e ndihmës, nuk mund ta çlirojë zemrën e vet nga zilia, urrejtja dhe smira për ta dhe për shoqërinë në tërësi. Kjo është arsyeja e prishjes së raporteve vëllazërore; ndjen-jat e dashurisë janë zhdukur dhe uniteti i shoqërisë është copëtuar.

8. Nisur nga ky realitet, kam për-shtypje se myslimanët nuk kanë nevojë për pasuri dhe fonde në masën që duhet të zbatojnë Sheriatin. Të paguajnë zeqa-tin e pasurisë së tyre, të japin një të pestën e xeheve, të pasurisë dhe mineraleve, të naftës e kështu me radhë. Vallë, a nuk janë myslimanët më të pasur në botë?! Zoti i ka dhuruar botës islame mirësi dhe pasuri të jashtëzakonshme, por ata e qarkullojnë atë në duart e individëve në numër të kufizuar. Ah, sikur ta shpenzojnë pa-surinë në mirësi dhe ta nxjerrin ze-qatin e tyre! Ata e harxhojnë në teke dhe dëshira të tyre, kurse shumica e popullatës jetojnë në varfëri ekstreme, me pamje të thatë dhe mungesë reshjesh, me përmbytje, me gjoba të tmer-shme në formën e borxheve vrastare, me luftëra civile dhe me shumë vuajtje të tjera. A nuk është turp

që disa myslimanë të vuajnë nga uria, etja dhe papunësia, ndërsa të tjerët të vuajnë nga ngopja dhe mbipesha?! Mastrafi i te-pruar çon në ndryshim, kurse tejkalimi i limiteve është shkak që Zoti të ndryshojë bekimet e Tij.

DY ALTERNATIVA

Atëherë, ku qëndron alternativa që të dilet nga kjo gjendje e vështirë? – Kam bindjen se zgjidhja e problemeve që pre-kin botën islame qëndron në dy alterna-tiva, edhe atë: të pasurit të japin zeqatin për pasurinë e tyre, kurse udhëheqësit të mos e keqpërdorin kapitalin e popullit; përndryshe, i pret dënimi i madh nga Zoti.

Sipas ajeteve kuranore, pasuria e mos-dhënies së zeqatit do t'i bëhet zjarr atij që nuk e jep dhe Zoti do ta dënojë atë shumë ashpër. Për sa i përket gjendjes së tij në këtë botë, hadithet e Pejgamberit kërcënojnë me varfëri dhe mungesë të be-reqeteve nëse një popull nuk e jep zeqatin.

Nuk ka më mirë për njeriun - si për këtë botë, ashtu edhe për botën tjetër - sesa t'i bindet dhe t'i nënshtrohet Krijue-sit të tij, i Cili për besimtarët ka përgatitur shpërblime dhe mirësi të pafund. Zoti i madhërishtëm na bën thirrje, duke na nxi-tur që të shpejtojmë drejt veprave të mira, të cilat do të na e japin parajsën sa gjerë-sia e qiejve dhe në tokës. Thotë i Madhë-rishmi: *“Shpejtoni në magfietin e Zotit tuaj dhe për në xhenet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit. Ata të cilët japin kur janë në mirësi dhe kur janë në vështirësi, të cilët e mbajnë mllëfin dhe ata që i falin njerëzit. Allahu i do bamirë-sit.”* (Ali Imran: 133-134)

Nga kjo që prezantuam, mund të kon-statojmë se zeqati është njëri prej farzeve më të mëdha të Islamit, me të cilin afro-hemi tek Allahu, të cilin e ka bërë obligim për dy qëllime tepër të rëndësishme për jetën e njeriut: për të pastruar shpirtin prej lakmisë dhe koprracisë, ndërsa pasurinë prej haramit dhe gabimeve të ndryshme.

Në Islam punët janë sipas qëllimit; sado që një person të japë prej pasurisë së tij, nëse nuk e ka dhënë me qëllim të ze-qatit, ai njeri nuk e ka kryer detyrën që Zoti ia ka ngarkuar.

Për në fund, duhet të kuptojmë se mos-dhënia e zeqatit është pasuri e të varfrit. Nëse një besimtar e ha, nëse e shkel të drejtën e të varfrit, ai do të dënohet shumë rëndë. Madje, pasuria e mosdhënies së ze-qatit mbetet pasuri haram tek ai person apo tek ajo familje, gjë që ndikon negati-visht në jetën dhe në moralin e tyre.



MOS EJA, RAMAZAN!

-Jo, edhe pak...

Shkruan: Evzal Sinani

Asnjëherë nuk kam pasur ndjenja kaq të përziera rreth ardhjes së Ramazanit. Asnjëherë shpresa, dashuria, ëndja dhe malli nuk kanë qenë të kryqëzuara një me frikën, dhimbjen, druajtjen dhe trishtimin, si këtë prag Ramazani. Nuk ka ndodhur më parë që t'i lutem në heshtje - që nga thellësitë e qenies, pa zë, pa fjalë, veç me shpirt, nga aty ku nuk sheh as nuk dëgjon gjë njeri e as di gjë për të *kiram katibinë* - Zotit, që ditët të mos ecin e të mos vijë Ramazani. Jo... Kam frikë ta pres Ramazanin sivjet dhe sikur nuk dua të vijë; të paktën jo ende, jo ende...

Mos shpejto, i dashur Ramazan, mos u ngut se, ne myslimanët ende nuk të presim. Ne nuk jemi bërë gati të vish dhe në dyert tona të vendosim fanarët që simbolizojnë prehjen e humbur që ka bredhur rrugëve të qytetit të trishtë përgjatë vitit. Ne ende nuk kemi hapur dyert e zemrës që drita e fanarëve tu të ngrohë me ndriçimin plot shpirt dhomat e errësuar nga mëkatet aty thellë në zemrat tona, e as që jemi gati që të vish, me madhështinë tënde të një nëne, të pastrosk skutat e ndyra nga llumi i gjynaheve të këtij viti të vështirë që lëmë pas.

Po, them që lëmë pas, sepse unë vitet i njuh me ty; për mua ti je kalendari më i mirë, për mua ti je fillimi dhe ti je fundi, edhe pse nuk mbaron asnjëherë. Ti je për mua përjetësia që më vë në kandar të për-kohshmen.

Ti për mua je jeta, por këtë vit, prit

edhe pak, prit sa të bëhemi gati dhe të buçasin minberet me emrin tënd! Prit sa të bëhemi gati dhe të lulëzojnë fushat nga bereqeti i shiut tënd paralajmërues myzhdë-sjellës! Prit sa të bëhen hazër imamët në xhami e të shtrëngojnë rripin bujqit e gëzuar, të cilëve ti ju fal dyfishin e forcës që kanë! Prit edhe pak sa t'i kthet buçima zërit të myezinit e të mos të thotë me dhimbje e nëpër dhëmbë pesë herë në ditë *"hajje alessalah"*! Prit sa të na kalojë ky kob e të hiqet kjo gjëmë, se s'kemi fytyrë të të presim kështu si jemi! Prit, se s'ka fëmijë sivjet që vendosin vezë në këpucët e falësve të teravisë! Prit, se të rinjtë sivjet janë të strukur në shtëpi dhe nuk t'i mbushin xhamitë namazeve të sabahut! Prit, se ne nuk të duam bardhë e zi! Prit, se ngjyrat e botës tënde janë të fshehura në tingujt e leximit të imamit netëve të vona plot dashuri! Prit, se ne ty të njohëm falë mbrëmjeve të gjata plot gëzim, shend e shpirt, kur diskutonim, merrnim e jepnim se kush do ta japë hakun më shumë ty; jo për diç tjetër, po se ashtu na jepje më shumë hakun ti neve, edhe pse ne s'iu afruam qëllimit tonë më shumë se një gisht! Prit edhe pak, se ende kemi shpresë! Prit edhe pak të kalojë kjo dhimbje e t'na hiqet kjo bela që ka strukur botën mbarë dhe na ka lënë të frikësuar të madh e të vogël.

I dashur Ramazan, thuaj hënës tënde të presë edhe pak, se mbase bëhemi gati për ty siç i ka hije.

Ose...tani që e mendoj më mirë, jo mos i thuaj, po eja, eja të lutem sa më shpejt dhe më ndiej pse pak më parë t'u

përgjërvoja të vonohesh; eja, të lutem, dhe shkrije akullin e mundimit që ka mbuluar zemrën time me diellin e ngrohtë të mëshirës sate.

Eja se ti, ti je dhurata e Zotit për ne, e mbase falë teje, do të na hiqet kjo gjëmë.

Mirë se vjen, i dashuri i Zotit, i dashuri i Muhamedit, i dashuri i zemrave tona!

MIRË SE VJEN RAMAZAN!

Me shpresë të madhe në Zot dhe mëshirën e Tij që të na largojë sproven e madhe të pandemisë që ka kapluar gjithë botën në kohën kur e shkruajmë këtë tekst, jemi të mbushur plot ndjenja gjithfarëshe, por edhe me motiv, sepse, mbi të gjitha dhe pavarësisht të gjithave, na vjen mbreti i muajve dhe na troket në derë, na vjen muaji më i mirë se gjithë muajt tjerë. Muaj, për të cilin të parët tanë janë lutur gjatë gjithë vitit që ta arrijnë. Nga gojë të tyre të bekuara ka dalë gjithmonë lutja: "Zoti ynë, na mundëso ta arrijmë Ramazanin!"

PSE RAMAZANI?

Po pse, vallë, gjithë kjo derdhje ndjenjash për Ramazanin? Ç'është sekreti që e bën atë aq të dëshiruar?

Është Ramazani, sepse është muaj i mëshirës, i faljes, i duasë, i dashurisë, i mirësisë, i dijes dhe i solidaritetit. Më shumë se kaq, Ramazani është ky që është, sepse në të është agjërimi.

E në pyetëm veten, cila është urtësia e ligjësimit të agjërimin në muajin Ramazan dhe pse pikërisht agjërimi, një adhu-

rim që është i ndërlidhur me një nevojë të përditshme fiziologjike të njeriut, në fjalët e dijetarëve gjejmë përgjigje që ndriçojnë në zemrën e besimtarit si margaritarë. E para thotë se Allahu (xh. sh.) na ka urdhëruar të agjërojmë në të dhe të ndjejmë uri, sepse uria është çelësi i mirëqenies shpirtërore dhe fizike, siç pohojnë mjekët bashkëkohorë dhe të urtët. Për këtë arsye është thënë se 'ena më e keqe që ka mbushur njeriu është barku i tij'.

Urtësi tjetër është fakti që Allahu (xh. sh.) na ka urdhëruar të agjërojmë, sepse për banorët e xhehenemit nuk ka dënim më të rëndë se uria. Bile, Allahu fuqiplotë pasi ua çon urinë, nga uria e madhe ata harrojnë edhe dënimin e zjarrit. Prandaj i kërkojnë ushqim Malikut, rojtarit të xhehenemit, e ai u jep "ushqim që nuk gëlltitet" (73:13). Kur ky ushqim u mbetet në fyt, thonë: 'kur na mbetet kafshata në fyt në dynja, ne e përpinim me ujë'. U jepet "ujë si katran, që nxin fytyrat" (18:29). Allahu (xh. sh.) e ka urdhëruar ummetin e Muhamedit (a. s.) të agjërojë muajin e Ramazanit që të shpëtojë nga kjo uri.

Asketizmi (zuhdi) është dy llojesh: të frenosh veten nga sendet e ndaluara dhe të frenosh veten nga gjërat e lejuara. Kjo e dyta është më fisnikja dhe më e çmuara te Zoti. Prandaj, Allahu (xh. sh.) ka urdhëruar myslimanët të agjërojnë këtë muaj, që të arrijnë vlerën e abstenimit nga sendet e lejuara. Kjo është urtësia e tretë. E katërta, ndërkaq, thotë që agjërimi i muajit të Ramazanit ka për qëllim t'ia përkujtojë njeriut vështirësitë e ditës së Kiametit dhe ta kenë parasysh se po pati ndonjë vështirësi në adhurimet e Allahut, kjo krahasuar me vështirësitë e botës tjetër është një hijë e madh.

ÇELËSI I FSHEHTËSIVE

Edhe më shumë se kaq: "Ramazani është muaji në të cilin u zbrit Kurani, që është udhërrëfytes për njerëzit, plot me argumente të dokumentuara për rrugën e drejtë dhe dallues i së mirës nga e keqja..." (2:185) E, përkujtimi i zbritjes së këtij universi të përjetshëm, që flet në botën e të vdekshmëve, që nuk dëgjojnë, që flet me lexim, është adhurim në vetë - është nga adhurimet e mëdha, që e pastrojnë shpirtin e njeriut nga cytjet e djallit dhe të egos.

"Ata që e lexojnë librin e Allahut, që e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e hap-tazi, ata e shpresojnë një fitim që kurrë nuk humbet." (35:29) Për vlerën e madhe të këtij adhurimi flasin shumë bukur këto hadithe të Muhamedit (a. s.):

"Lexoni Kuranin, se ai do të vijë ndërmjetësues në Ditën e Kiametit për ata që e kanë lexuar dhe kanë punuar me të." (Transmeton Muslimi)

"Ai që lexon Kuran me përpikëri, është me melaqet e ndershme. Ai që lexon duke i ardhur vështirë, e ka shpërblimin e dyfishuar." (Buhariu dhe Muslimi)

I dërguari i Allahut, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Nuk lejohet zilia, pos në dy kategori njerëzish: kur një njeriu Allahu ia ka dhënë Kuranin dhe ai çohet natën, fal namaz me Kuran dhe e përsërit atë ditën; dhe një njeriu që i ka dhënë Zoti pasuri dhe ai jep lëshues (sadaka) ditën dhe natën." (Buhariu dhe Muslimi)

Përcillet nga Bera ibn Azibi se një njeri ishte duke lexuar suren Kehf kur filluan t'i zbrisin retë, aq sa e mbuluan atë dhe filluan t'i afroheshin shumë. Kali i tij, që ishte i lidhur, filloi të ikte sa më shumë që afroheshin retë. I treguan për këtë ndodhi Muhamedit, paqja e Allahut qoftë mbi të, e ai tha se ato ishin melaqe që kishin zbritur nga qielli për ta dëgjuar Kuranin." (Buhari dhe Muslimi)

Ibn Mesudi transmeton nga Muhamedi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi të: "Kush lexon Kuran, për çdo gërmë i ka nga dhjetë sevape. Nuk them se elif lam nim është një shkronjë, por elif është shkronjë, lam është shkronjë dhe mim është shkronjë." (Tirmidhiu)

Transmetohet nga Ibn Abbasi (r. a.), nga Muhamedi (a. s.), të ketë thënë: "Shembulli i atij që në gjoksin e tij nuk ka send nga Kurani është sikur një shtëpi e vjetër, e braktisur." (Tirmidhiu)

Transmetohet nga Muhamedi (a. s.) se "Ditën e Kiametit i thuhet lexuesit të Kuranit 'lexo e zbukuroje leximin tënd të Kuranit, siç ke lexuar ashtu, në dynja, se ngritja jote në grada do të ndalohet kur të mbarosh ajetin e fundit'." (Tirmidhiu)

Veçimi me Kuranin gjatë Ramazanit ka qenë praktikë e ndjekur e të parëve tanë, nxitur dhe shtyrë nga fjala e Muhamedi (a. s.): "Më i miri prej jush është ai që e mëson për vete Kuranin dhe ua mëson atë edhe të tjerëve." (Buhariu, Muslimi) Këtë fjalë Muhamedi (a. s.) e zbatonte vetë së bashku me Xhibrilin derisa për çdo Ramazan e bënin hatme Kuranin. E, ku ka çast më të mirë për t'u veçuar me Kuranin sesa në kohën kur ka ardhur Xhibrili dhe e ka sjellë në Tokë peshqeshin më të madh për mbarë njerëzimin?! Për këtë dhe shumë arsye të tjera Ramazani u quajt: "muaj i Kuranit".

PËRSËRI TEK AGJËRIMI

E, po deshëm ta trajtojmë mirë Kuranin, doemos duhet ta kuptojmë esencën e atij agjërimi të cilin në vetë Kuranin urdhërohem ta mbajmë. Ajo që me ngulm të gjitha tekste tentojnë të na mësojnë, është se agjërimi është tre llojesh: agjërimi i shpirtit është të mos shpresosh kot, agjërimi i mendjes është kundërshtimi i egos dhe i epsheve; dhe i treti, agjërimi i trupit është ndalimi nga ngrënia, nga pija dhe kontakti mar-tesor.

Kështu që, kush agjëron vetëm nga ngrënia dhe pija, e bën këtë për adet. Kush largohet nga kamata dhe haramet tjera dhe çel iftar me hallall, agjërimi i tij është adhurim. Kush largohet nga mëkatet dhe çel iftar me hallall, agjërimi i tij është agjërim që kënaq Zotin. Kush largohet nga punët e ndyra dhe çel iftar me pendim, ka bërë agjërimin e të devotshmit. Kush largohet nga përgojimi dhe shpifja dhe çel iftar me lexim të Kuranit, është agjëruar që ka fituar shpërblimet e Zotit të vet.

Allahu (xh. sh.) thotë: "Kush prej jush është i sëmure ose në udhëtim, le të kompensojë me ditë të tjera!" (Bekare, 184) Shih ç'rahmet! Ka pranuar të lëshojë pe nga urdhri i Tij dhe të lë mangët prej detyrimeve të Veta, që mos të lë mangët prej shëndetit tënd. Të lejon të prishësh agjërimin në ditë e nxehta dhe të gjata, ndërsa ta kompensojë në ditë të shkurtra dhe të freskëta. Të lejon ta prishësh ditëve një pas një, ndërsa t'i kompensojë ndarazi. Kjo është mëshirë dhe butësi.

Ramazani është si haremi i Mekës dhe Medinës, brenda të cilit është e ndaluar që të hyjë Dexhalli. Edhe në Ramazan djajtë e kanë të ndaluar të hyjnë në zemrat e besimtarëve të devotshëm. Ramazani është si lajmëtar i një mbreti, i çuar te një fis; po e pritën me dashamirësi dhe e nderuan, do të kthehet te mbreti dhe do ta lëvdojë atë fis e kështu mbreti do jetë i kënaqur me ta dhe do t'i shpërblejë. E, po u sollën ndaj tij keq dhe e dëbuan - e kanë hidhëruar Atë e bashkë me Të edhe mbretin. Na mbetet neve të zgjedhim: a do të ecim rrugës për te Zoti, bashkë me lajmëtarin e tij dhe të çojmë vepra të mira, që të jetë i kënaqur me ne Zoti i gjithësisë, apo do ta hidhërojmë lajmëtarin dhe do ta hidhërojmë Zotin tonë, që urdhëroi Muhamed *mustafanë* të na tregojë se "po t'u jepte Zoti qiejve dhe tokës leje që të flasin, do të dëshmonin se agjëruesi i Ramazanit ka hyrë në xhenet."

BETEJA E BEDRIT

Është kjo fitorja e parë e myslimanëve ndaj mushrikëve të Mekës. Arabët filluan menjëherë t'i përhapnin lajmet e saj. Kështu, njerëzit filluan të kuptonin se myslimanët ishin bërë të fortë dhe se duhej të merreshin parasysh.

Shkruan: Mr. Lutfi Nexhipi


Bedri është një nga betejat më të dalluara në historinë e Islamit. Allahu (xh. sh.) e ka quajtur "Jevmul-Furkan" - betejë dalluese. Thotë në Kuran: **"Dhe në atë që i kemi shpallur robit Tonë ditën e Furkanit (luftën e Bedrit), atë ditë kur u ndeshën dy ushtritë. Vërtet, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë."** (El-Enfal: 41) Është zhvilluar më 16 Ramazan të vitit të 2-të hixhrij (13 mars 624). Po ashtu, ajo është përmendur edhe në ajetin uranor, që thotë: **"(Përkujto) Ditën kur do t'i kapim me atë rrëmbimin Tonë të fuqishëm e do t'u hakmerremi."** (Ed-Duhan: 16)

Nga shkaqet e kësaj beteje ka qenë se Muhamedi (a. s.) vazhdimisht i ka përcjellë lajmet e kurejshëve dhe i ka përgjuar ata. Mushrikët kishin torturuar atë dhe shokët e tij, i kishin dëbuar nga shtëpitë e tyre, ua kishin uzurpuar pasurinë, disa prej tyre i kishin burgosur dhe i kishin ndëshkuar.

Muhamedi (a. s.) ndërkohë merr vesh se karvani i kurejshëve po vinte nga Shami për në Mekë në rrugën që kalonte në afërsi të Medinës. I dërguari i Allahut i thirri ata që ndodheshin aty për të dalë me të. Ata dolën me nxitim, pa ndonjë parapërgatitje para-prake. Të Dërguarin e shoqëruan mbi treqind e dhjetë veta - shumica këmbësorë, kanë pasur dy kuaja dhe shtatëdhjetë deve. Kanë menduar se do ta takojnë karvanin dhe nuk do të luftojnë; për këtë shkak nuk kanë qenë të përgatitur plotësisht për luftë.

Udhëheqësi i karvanit të kurejshëve ka qenë Ebu Sufjan ibn Harbi. Ai e kishte kuptuar se Muhamedi (a. s.) ka dalë ta kërkonte atë dhe karvanin e tij, andaj e kishte ndërruar rrugën dhe kishte shkuar rrugës së bregdetit, rrugë të cilën myslima-

manët nuk e kanë llogaritur se ata mund të shkonin përmes saj. Në të njëjtën kohë, kanë dërguar në Mekë lajmëtarë për të lajmëruar se karvani mund të rrezikohet nga myslimanët dhe kanë kërkuar që të dilnin dhe ta mbrojnë. Dolën paria e kurejshëve, guximtarët e tyre, kokat e kufrit. Ndërkohë Ebu Sufjani shpëton nga myslimanët me karvanin e tij dhe e dërgon një



kalorës te banorët e Mekës, për t'i lajmëruar për shpëtimin e karvanit dhe kërkon prej tyre të kthehen në Mekë.

MENDJEMADHËSIA E JOBESIMTARËVE

Mirëpo, Ebu Xhehli, udhëheqësi i jobesimtarëve kurejsh, në mënyrë sfiduese, mendjemadhësi dhe mburrje shpalli se nuk kthehet derisa nuk arrinte te burimet e Bedrit, aty të thernin një deve, të ushqeshin dhe të pinin verë, të këndonin këngëtarët dhe të dëgjonin arabët për

marshimin e tyre, që t'ua kenë frikë përgjithmonë. Kjo ishte ajo me të cilën e ka përshkruar Allahu (xh. sh.) në Kuran, ku thotë: **"Mos u bëni si ata që dolën prej shtëpive të tyre sa për krenari e për t'i parë bota, e që pengonin nga rruga e Allahut. Allahut nuk mund t'i shpëtojnë me atë veprim të tyre."** (El-Enfal:47) Kështu, ata vazhduan derisa arritën në luginën e Bedrit.

Muhamedi (a. s.) ka kuptuar për marshimin e kurejshëve dhe i ka mbledhur shokët për t'u konsultuar. Edhe pse ishte i mbrojtur nga Allahu (xh. sh.) në mendimet e tij, ai megjithatë u konsultua me shokët për gjëra të rëndësishme. Prej tyre dy gjëra: e para, bashkimi i rreshtave të myslimanëve, përmirësimi i mendimeve të tyre, që është shumë e rëndësishme, në veçanti me ensarët në këtë periudhë, se ata ishin nikoqirë. E dyta: arritja në një vend më të përshtatshëm dhe përkatës.

Muhamedi (a. s.) kërkoi prej tyre mendim, duke iu thënë: **"Më jepni mendimet tuaja, o ju njerëz."** I pari e mori fjalën Ebu Bekri, i cili i pranoi propozimet e Muhamedit (a. s.) dhe i lavdëroi ato. Pas tij u ngriti Omer b. Hattabi, me të njëjtin mendim, si Ebu Bekri (r. a.). Në vazhdim u ngriti Mikdad b. Amir dhe tha: "O Pejgamber i

Allahut, shko rrugës të cilën ta ka treguar Allahu. Ne jemi me ty. Pasha Allahun, çkado që të ndodhë me ty, nuk do të themi ashtu siç i kanë thënë Beni Israilët Musait (a. s.) **'...Shko, pra, ti dhe Zoti yt dhe luftoni; ne po rrimë këtu!'** (Kuran,V:24) Ne do të luftojmë djathtas teje dhe majtas teje, para teje dhe prapa teje. Po të ecje me ne, edhe deri në Berkul Gumad (vend në jug të Mekës, në drejtim të Jemenit) Ne do të luftojmë me shpatat tona, bashkë me ju, derisa të arrijmë atje." Muhamedi (a. s.) u lut për të dhe pastaj tha për së dyti: **"Më jepni mendimet tuaja, o ju njerëz."** Dëshir-

ronte të dëgjonte mendimet e ensarëve. Ngrihet Sad ibn Muadhi me thënien e tij: "Sytë sikur i ke te ne, o i dërguar i Allahut?" Pejgamberi (a. s.) tha: "Po." Sadi vazhdon me lavdërime ndaj Muhamedit (a. s.) dhe përmend se ata qëndrojnë në marrëveshjen me të. Tha: "O i dërguar i Allahut, vazhdo me atë që e ke synim. Pasha atë që të ka dërguar me hak, edhe po të na dilte deti përpara, e ti do të zhyteshe në të, edhe ne do të zhyteshim në të - asnjëri prej nesh nuk do të kthehej mbrapsht; ne jemi popull që durojmë në luftë, jemi besnikë në takim (në luftë), e ndoshta Allahu ta bën të mundur të shohësh te ne atë që ta kënaq syrin. Andaj, ec përpara me bekimin e Allahut!" I dërguari i Allahut u gëzua shumë me fjalimin e Sadit dhe u lut për të, për muhaxhirët, për ensarët dhe u rehatua me qëndrimin e ushtrisë për në luftë me armikun.

Pejgamberi (a. s.) vendosi të nisej me ushtrinë e tij dhe të zinte pozitë afër lumit në Bedër. Në mëngjes arritën afër burimit të Bedrit. Habab ibn Mundhiri, njëri nga vëzhguesit, u ngrit dhe tha: "A mendon, o pejgamber i Allahut, të qëndrojmë këtu? A të ka urdhëruar Allahu që të jemi në këtë vend dhe se nuk guxojmë të shkojmë as përpara, as prapa, apo kjo është çështje e mendimit të lirë - luftë dhe taktikë?" Pejgamberi (a. s.) u përgjigj: **"Ky është vend për konsultim; luftë dhe taktikë."** Habab ibn Mundhiri vazhdoi dhe tha: "O pejgamber i Allahut, ky vend nuk është i mirë për të qëndruar. Nisu me njerëzit, derisa të arrish gjer te pusi më i afërt i kurejshëve; pusin rrënoje dhe mbuloje me dhe e me gurë. Kështu vepro edhe me pusët tjera. Pastaj për vete do të hapim një kanal, të cilin do ta mbushim me ujë. Vetëm atëherë do të nisemi në sulm. Ne do të kemi ujë për të pirë e ata jo." Pejgamberi (a. s.) u përgjigj: **"Ke dhënë mendim të saktë."**

Resulullahu (a. s.) e ngriti ushtrinë dhe u nisën gjer te pusi më i afërt i kurejshëve. Aty arritën në mesnatë. E hapën kanalin dhe i mbuluan burimet kryesore.

Sahabët ia ngritën tendën Muhamedit (a. s.) të veçohej në kohë, për t'u lutur dhe për t'u falur. Mirëpo, i Dërguari e kishte vendin në krye të safit në luftim, sepse ai ishte më i guximshmi në mesin e të guximshmeve.

Pasi arritën kurejshët dhe i pa i dërguari i Allahut tha: "O Allah, këta janë kurejshët; kanë arritur me mendjemadhësinë e tyre, me mburrjen e tyre, që të të kundërvihen Ty dhe e përgënjeshtrojnë të dërguarin tënd, andaj më jep fitoren që ma ke



premtuar. O Allah, mposhti që sot!"

Disa nga udhëheqësit e kurejshëve u orvatën t'i bindnin të vetët të ktheheshin në Mekë, por Ebu Xhehli dhe të ngjashmit me të, nga kokat e kufrit, nuk i përfillën ata dhe i bindën kurejshët që të qëndronin në luftë kundër myslimanëve.

ALLAHU (XH. SH.) UA ZBRITI QETËSINË MYSLIMANËVE

Myslimanët e kaluan natën (Natën e Bedrit) duke e lutur Allahun që t'u jepte fitoren dhe suksesin kundër armiqve. Allahu ua zbrit qetësinë atyre. Andaj, ata u ndjen të rehatshëm dhe i kaploi gjumi. Allahu (xh. sh.) zbriti një shi të imët, për të cilin në Kuranin e madhërishtëm thotë: **"Ai bëri që ju të kotenit në gjumë të lehtë, si shenjë sigurie nga ana e Tij dhe lëshoi nga qielli shi për t'ju pastruar nëpërmjet tij, për të larguar prej jush ndyrësinë e djallit dhe për të forcuar zemrat dhe këmbët tuaja."** (El-Enfal: 11)

Muhamedi (a. s.) në atë natë falej dhe qante, duke e lutur Allahun (xh. sh.) t'u ndihmojë besimtarëve. Prej lutjeve që i tha atë natë, apo mëngjes, ishte: **"O Allah, unë pres të ma realizosh marrëveshjen dhe premtimin Tënd. O Allah, nëse dëshiron Ti, nuk do të adhurohesh pas kësaj dite më kurrë."**

Sa u përket mushrikëve, ata natën e kaluan duke ngrënë dhe duke pirë verë, me këngë që këndoheshin nga këngëtarët, duke u krenuar me forcën dhe pajisjet që kishin.

Në mëngjesin e ditës së Betejës my-

slimanët u falën pas të dërguarit të Allahut dhe pas namazit Muhamedi (a. s.) u foli, duke i inkurajuar për luftë dhe durim. Njerëzit prisnin urdhrin e Muhamedit (a. s.) për fillimin e betejës.

Edhe kurejshët ishin rreshtuar dhe ishin bërë gati për luftë. Njëri prej kurejshëve u mundua të pinte ujë nga burimi, duke depërtuar në rreshtat e myslimanëve, por atij ia preu rrugën Hamza bin Abdul Motalibi dhe e vrau. Pas kësaj filloi dueli i parë mes palës së idhujtarëve: Utbe bin Rabia, djali i vëllait të tij Shejbe bin Rabia dhe djali i tij, Velid bin Utbe; dhe palës myslimane: Hamza bin Abdul Motalib, Ali bin Ebi Talib dhe Ubejde bin Harith. Pra, të gjithë ishin pjesëtarë të familjes së Muhamedit (a. s.). Ky dyluftim mbaroi me vrasjen e idhujtarëve dhe plagosjen e Ubejde bin Harithit, i cili më vonë ra dëshmor.

Dy grupet u përballën me njëri-tjetrin dhe filloi beteja. Muhamedi (a. s.) mori një grusht me dhe, e gjuajti mbi kurejshët, duke thënë: **"U nxifshin fytyrat e idhujtarëve."** Për këtë rast zbriti fjala e Allahut të madhërishtëm: **"Kur gjuaje, nuk ishe ti (Muhamed) që gjuaje, por ishte Allahu Ai që gjuante, me qëllim që t'u bënte besimtarëve një dhuratë të bukur. Vërtet, Allahu dëgjon dhe di çdo gjë."** (Kuran, VIII: 17)

Beteja mes të dy palëve u ashpërsua. Muhamedi (a. s.) qëndronte në rreshtat e parë, sa që edhe sahabët ruheshin pas tij. Shumë sahabë treguan trimëri të rrallë në këtë betejë, prandaj filluan të dukeshin shenjat e triumfit.

Idhujtarët u mundën. Gjithashtu, edhe krerët e tyre si: Ebu Xhehli, Utbe bin Rabia, Umeje bin Halefi dhe shumë të tjerë u vranë. Numri i tyre arriti deri në shtatëdhjetë të vranë, ndërsa ata që mbetën gjallë u larguan të shpartalluar, pa parë se çfarë linin prapa. Pas betejës myslimanët qëndruan në Bedër tri ditë, ku varrosën dëshmorët, numri i të cilëve kishte arritur në katërmëdhjetë shehidë.

Pas kësaj Muhamedi (a. s.) dhe shokët e tij u kthyen në Medinë shëndoshë e mirë, bashkë me prenë e luftës që kishin marrë. Atje i prisnin myslimanët me gëzim të madh për kthimin dhe për triumfin e qartë që korrën myslimanët në këtë betejë.

Beteja e Bedrit ka qenë fitorja e parë e myslimanëve ndaj mushrikëve të Mekës. Arabët filluan menjëherë t'i përhapnin lajmet e saj. Kështu, njerëzit filluan të kuptonin se myslimanët ishin bërë të fortë dhe se duhej të merreshin parasysh.

FITIMI DHE NDIHMA E NDËRSJELLË

Shkruan: **Jusuf Zimeri**

Sikurse dhe çdo kontratë tjetër, edhe kontrata e sigurimit ka shtyllat e saj: 1. **Palët kontraktuese**. Palët kontraktuese janë: personi - organizata e cila siguron (ar. **El muem-minu** **المؤمن**), që në të shumtën e rasteve është kompani ose shoqëri e sigurimeve, që siguron shërbime dhe detyrohet t'i paguajë kompensimin material palës tjetër në raste fatkeqësie. 2. **Personi i cili sigurohet** (El Muem-menu lehu ose El Muste'minu-المستأمن له), është pala e cila ka lidhur kontratë me organizatën apo shoqërinë e sigurimeve për të siguruar pasurinë në raste fatkeqësie. 3. **Fatkeqësia apo katastrofa** (ar. **El muemmenu did-dehu** **المؤمن ضيده**), për të cilën pala që sigurohet e ka frikën se do të ndodhë në të ardhmen, të cilën disa juristë e emërtojnë me nocionin "e hataru - rreziku". Rreziku apo fatkeqësia është dukuri që nuk varet nga asnjëra palë kontraktuese. Ajo kushtëzohet nga: a) rreziku - fatkeqësia duhet të ndodhë në të ardhmen, sepse nëse fatkeqësia ka ndodhur, atëherë nuk mund të realizohet kontrata e sigurimit; b) fatkeqësia apo rreziku që do të ndodhë të mos jetë veprim i asnjërës palë. Kështu, dallojmë: 1. pagesën (ar. **El Bedlu** **البدل**), të pala që sigurohet duhet t'ia bëjë palës sigurose; 2. kompensimi ekonomik (ar. **Et-ta'vidul malij** **التعويض المالي**), përmes pasurisë që detyrohet t'i paguajë siguroses palës së siguruar; 3. koha, (ar. **Ez-zemenu** **الزمن**) si element shumë i rëndësishëm që përkufizohet në kontratë, për sa vlen ky sigurim.

Meqë kontratat e sigurimit kanë pësuar një evolucion shumë të shpejtë në kohën bashkëkohore, atëherë juristët kanë vështirësi në përcaktimin e saktë të llojeve të kontratësⁱⁱ, sepse ekzistojnë kri-tere të shumta për ndarjen e sigurimit, kështu që me kalimin e kohës në skenë po paraqiten edhe kontrata të ndryshme të si-



gurimit.

Ndarjen e kontratës së sigurimit për nga forma e saj e gjemë të definuar edhe në Vendimin nr. 200 (21/6) nga Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam. Kështu, kontrata e sigurimit për nga forma e saj ndahet në: a) sigurim (konvencional) i tregtisë, që synon fitimin; b) sigurim bashkëpunues dhe solidar, që synon ndihmën reciproke mes njerëzve.ⁱⁱⁱ

Sigurimi i tregtisë (a konvencional) është lloji më i përhapur i sigurimeve sot. Kjo kontratë e e sigurimit është dypalëshe me kompensim, e cila i obligon të dyja palët kontraktuese me efektet juridike që janë regjistruar aty. Ky lloj i sigurimit ndryshe quhet edhe sigurim me pagesë të caktuar i këstit (ar. **et-te'minu bi kistin thabitin**). Në literaturë, kur e lexojmë vetëm nocionin "te'min - sigurim", pa cilësinë e saj, e nënkuptojmë këtë lloj të sigurimit.

Nën llojin e kontratës së tregtisë përfshihet sigurimi detar apo ujqor, sigurimi ajror dhe ai tokësor. Kjo kontratë është kur i siguruari ka për detyrim t'i paguajë sasinë e përcaktuar siguroses. Kjo kontratë paraqitet për organizatën që grumbullon një numër të madh të të siguruarve, por në këtë sigurim nuk bën pjesë edhe pala që siguron, sepse ato paguhen nga fitimi i organizatës. Ky lloj i sigurimeve sot aplikohet më së shumti në shoqërinë njerëzore.ⁱ

Sigurimi bashkëpunues (operativ – solidar, ar. **te'min et-teavuni** **التأمين**) është kur bashkohen një grup njerëzish, themelojnë një organizatë apo shoqëri humanitare, për të qëndruar përballë ndonjë rreziku kërcënues dhe për të siguruar nevojat e atyre që anëtarësohen në këtë organizatë. Anëtarët e kësaj organizate paguajnë anëtarësi në bazë vullnetare, që me atë pasuri të intervenohet në ndonjë fatkeqësi që e përfshin ndonjërin prej anëtarëve të saj. Me pasurinë e grumbulluar nuk synohet të investohet diku, apo të bëhet ndonjë tregti, ose ndonjë fitim. Në rastet kur pagesat nuk mjaftojnë për të kompensuar dëmin, anëtarët angazhohen që në bazë vullnetare të mbledhin sasinë e nevojshme. Në rast se teprojnë të mirat materiale nga pasuria e grumbulluar, ajo u kthehet anëtarëve të saj. Në këtë rast secili anëtar është siguroses dhe i siguruar, edhe pse ky lloj i sigurimit sot aplikohet shumë pak.

(Fund)

ⁱ El iskenderij, Et-te'minu envauhu el muasire – fq. 51

ⁱⁱ Dr. Abdulvedud Jahja, Et-te'minu alet hajaj, fq.18; Dr. Rexheb Abdutevak Kudvani, nadharijt u et-te'min et-teavunij fi esh-sheriatil islamiye vel kanunin vad'ij, – dirase mukarene, fq. 83, disertacion doktrate, lejuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Kajros në vitin 1987.

ⁱⁱⁱ Vendimi nr. 200(21/6) i Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam lëshuar më 22 nëntor 2013.

^{iv} Prof. Dr. El Husejn ibn Muhamed Shevat dhe Dr. Abdulhak Hamish, Ba'du ahkam et-te'min, <https://www.alukah.net/sharia/>.

DOKUMENT: BFI NË LIDHJE ME RAMAZANIN 2020

Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, në mbledhjen e vet të mbajtur më 17.04.2020, duke debatuar rreth aktiviteteve gjatë muajit të Ramazanit në kushtet e jashtëzakonshme, pas masave të marra nga organet kompetente shtetërore për të parandaluar dhe për të luftuar virusin Covid-19, mes tjerash mori këto

V E N D I M E

1. Për çdo ditë gjatë Ramazanit në xhami të qëndrojnë Imami, Myezini, Kryetari i Mexhllisit të Xhamisë, apo njëri nga anëtarët e Mexhllisit, për të qenë në lidhshmëri të përhershme me xhematin.

2. Gjatë muajit të Ramazanit për çdo kohë të namazit të thirret Ezani, ndërkaq pas namazit të drekës të lexohet mukabele, mundësisht ajo të dëgjohet edhe jashtë xhamisë.

3. Të punësuarit në BFI dhe në institucionet e saj edukativo-arsimore të jenë në shërbim të organeve të BFI-së, respektivisht të Myftinive të BFI të RMV për të zbatuar programet e tyre lidhur me grumbullimin e sadekatul-fitrit, zeqatit dhe të dhënat tjera vullnetare në fondin e institucioneve edukativo-arsimore të BFI të RMV.

4. Nxënësve dhe studentëve u rekomandohet që të kenë lidhshmëri permanente me Drejtorinë, respektivisht me Dekanatin gjatë muajit Ramazan. Ndërkaq, duhet që t'u sugjerohet familjeve të nxënësve dhe studentëve që sadekatul-fitritin dhe zeqatin ta japin në fondin e Bejtul-malit, respektivisht tek organet e BFI të RMV, ku të dorëzojnë fletëpagesat (e sadakutul fitritit) e tyre para Drejtorisë dhe Dekanatis.

5. Gjatë muajit të Ramazanit të shfrytëzohen maksimalisht mjetet e informimit, qofshin të nivelit qendror dhe lokal, për të mbajtur ligjëratat me tematikë fetare.

6. Luten besimtarët myslimanë të këtij nënqielli që të gjitha këto vendime që u morën në mbledhjen e Rijasetit të bëjnë përpjekje që t'i respektojnë. Gjithashtu, nga myslimanët e këtij nënqielli kërkohet që maksimalisht të bëjnë përpjekje që t'i respektojnë organet legale dhe legjitime të BFI të RMV; njëkohësisht, të bëjnë përpjekje që të mos bien pre e dezinformatave dhe propagandave negative, t'i mbyllin sytë dhe veshët nga sajatat e ndryshme të nëntokës, ngase feja e Muhamedit (a. s.) nga dita e parë ka pasur, ka dhe do të ketë armiq të cilët përpiqen që ta zbehin Islamin dhe t'i përcajnë radhët e popullit mysliman. Gjithashtu, besimtarët në bashkëveprim me organet e BFI të RMV të tregojnë sens dhe kulturën e duhur në drejtim të respektimit të udhëzimeve të dala nga organet kompetente shtetërore lidhur me parandalimin e virusit Covid-19. Gjithashtu, u sugjerohet organeve shtetërore që të tregohen vigjilente dhe tolerante në veprimet e tyre, vetëm e vetëm që të kemi bashkëveprim efikas dhe rezultate në luftën kundër pandemisë dhe tejkalimin e situatës, duke festuar bashkërisht triumfin kundër Covid-19.

7. Duke filluar nga muaji prill i këtij viti, të gjithë të punësuarit në BFI (të punësuarit në Rijaset, në institucionet edukativo-arsimore, në Myftini, në subjektet dhe shoqatat e themeluara nga BFI, përfshi edhe nëpunësit fetarë) do të marrin rrogë minimale prej 14.500,00 denarë për shkak të krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia, të cilën e përjetojmë dhe me të cilën jemi duke u ballafaquar.

Në fund, lusim Zotin që të na japë shëndet e fuqi që ta presim dhe ta përjetojmë ashtu siç i ka hije këtë muaj të Ramazanit të Bekuar.

Urime!

Rijaseti i BFI të RMV,
Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi



OH "HILAL" NDIHMON TË ISOLUARIT NGA COVID-19

Me pëlqimin, mbështetjen dhe bekimin e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, **Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi**, dhe të Letrës qarkore të Rijasetit të BFI-së nr. 03-130 të datës 22.03.2020, **OH "Hilal"** e BFI-së ka filluar më 24 mars, 2020, aksionin e madh, të përditshëm, të ndihmave me paketa ushqimore dhe higjienike për familjet me gjendje të rëndësishme sociale, të izoluar nga pandemia e koronavirusit (Covid-19).

Aktivistët e OH "Hilal" kanë dalë në terren dhe po shpërndajnë pako me produkte ushqimore dhe mjete higjienike për familjet e mbyllura nëpër shtëpitë e tyre shkaku i sëmundjes dhe i gjendjes së jashtëzakonshme në vend – ka theksuar kryetari i saj, **mr. Mustafa ef. Dauti**. Ai po ashtu ka thënë se organizata humanitare e BFI-së është duke e ndjekur nga afër situatën, janë regjistruar shumë nevojtarë që kanë nevojë për ndihmë, "Hilali" do të jetë për çdo ditë në terren që të ndihmojë për aq sa ka mundësi, duke bërë thirrje që kategori të mirëgjendura të shoqërisë t'i bashkohen aksionit, të solidarizohen me skamnorët dhe me ata që po vuajnë shkaku i shtrëngesave të pandemisë, me qëllim: kapërcimin sa më të lehtë të situatës.

Aksionet e OH "Hilal" shtrihen në të 13-të myftinitë e BFI-së në RMV dhe gjithçka shkon në bashkëpunim me kujdestarët e të gjitha xhamive në vend, të caktuar mbi bazë të Letrës qarkore të shpërndarë nga Rijaseti pas shpërthimit të hovshëm të koronavirusit në vend. Nga BFI bëjnë thirrje që njerëzit të bëjnë gajret, të ruajnë qetësinë dhe besimin dhe të presin ndihmën e OH "Hilal" dhe të Zotit të madhërishëm.

BFI DHURON 10 MIJË MASKA

Drejtoresha e Institucionit Publik nga sfera e shëndetësisë për nevojat e ISHP Klinikat Universitare, Entet Shëndetësore dhe Qendrën Urgjente Shkup, **Shkodrane Dardhishta**, ka pritur në një takim Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, **Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi**, më 27 mars, 2020. Me këtë rast, Reis'ul-Ulema i ka dhuruar këtij institu-



cioni shëndetësor 10 mijë maska, donacion nga vendi, si kontribut i BFI-së për të përbulluar gjendjen e jashtëzakonshme në lidhje me koronavirusin. Në takim kanë qenë të pranishëm Zv/ministri i Shëndetësisë **Armend Arslani**, më shumë drejtorë të Klinikave të Shkupit në mesin e të cilëve edhe **Nexhati Jakupi** etj.

Zonja Dardhishta ka falënderuar Kryetarin e BFI-së për pajisjet, duke thënë që BFI është i vetmi institucion i cili deri më tani i ka dalë në ndihmë Institucionit Publik nga Shëndetësia të RMV-së. Ajo ka sqaruar se këto maska do të ndahen nëpër klinikat e ISHP-Shkup, të cilat, ka thënë, do t'i kontribuojnë situatës emergjente të paraqitur nga pandemia.

Reisi ka falënderuar drejtoreshën për mikpritjen, duke thënë se BFI është e gatshme që edhe më tej ta japë kontributin e vet për kapërcimin e situatës. Ai po ashtu është lutur që kjo sëmundje të kalojë sa më shpejt. "Me ndihmën e Allahut (xh. sh.), e gjithë kjo do të jetë kalimtare; vetëm duhet të ruajmë vetëdijen, t'i lutemi Zotit, të bëjmë gjithçka që është e mundur, që sëmundja të kalojë me sa më pak pasoja" – ka thënë ai.

REISI SHPËRNDAN NDIHMË NËPËR SPITALE

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka vazhduar aksionet e ndihmave humanitare në përbalim të pandemisë Covid-19. Personalisht

Kryetari i saj, **Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi**, më 4 prill, 2020, ka dalë në terren për të shpërndarë ndihmat e BFI-së, përkatësisht të OH "Hilal", për spitalet publike të RMV.

Në këtë ditë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, Kreu i myslimanëve të Maqedonisë së Veriut ka qëndruar në spitalin "8 Shtatori" në Shkup dhe Repartit të tij të Gastroenterohepatologjisë i ka dorëzuar një numër të pacaktuar maskash për të punësuarit dhe pacientët e kësaj njësie spitalore. Ndihamen e ka pranuar drejtori i Repartit, **dr. Jusuf Veseli**.

Kryetari i BFI-së, ef. Rexhepi dhe drejtori dr. Veseli, me këtë rast, janë shprehur optimistë në tejkalimin e pandemisë së koronavirusit, duke bërë thirrje për respektimin e urdhëresave dhe të rekomandimeve të organeve shtetërore, si dhe të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në përbalimin me sëmundjen që ka përfshirë pothuajse tërë botën. Dr. Veseli ka falënderuar Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepin për ndihmën e dorëzuar, të cilën e ka cilësuar si jashtëzakonisht të rëndësishme, për shkak se – ka thënë ai – vjen nga një Bashkësi Fetare dhe nga vetë Kreu i saj.

MBËSHTETJE PËR SPITALIN E GOSTIVARIT

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, **Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi**, me bashkëpunëtorë, ka qëndruar më 6 prill, 2020, në Myftininë e Gostiva-

rit, ku janë pritur nga Myftiu **h. Shaqir ef. Fetahu**. Me këtë rast, drejtorit të spitalit të qytetit "Ferid Murat", **dr. Jakup Jakupi**, i janë dorëzuar 3.000 maska, kontribut nga BFI për të përbulluar sa më lehtë pandeminë e koronavirusit.

Reis'ul-Ulemaja është shoqëruar nga Myftiu i Myftinisë së Tetovës **prof. dr. Qani ef. Nesimi**, nga Myftiu i Myftinisë së Shkupit **dr. Qenan ef. Ismaili**, nga Sekretari i Përgjithshëm i BFI-së **Irsal ef. Jakupi**, nga Kryetari i OH "Hilal" **Mustafa ef. Dauti** etj.

Drejtori Jakupi ka falënderuar Reis'ul-Ulemanë dhe tërë BFI-në për donacionin e dorëzuar, duke thënë që BFI, përveç përkrahjes në ngritjen shpirtërore të qytetarëve, po gjen kohë që në këto momente të vështira për të gjithë, të ofrojë edhe ndihma materiale për institucionet publike.

Myftiu **h. Shaqir ef. Fetahu** ka thënë se Myftinia e Gostivarit i respekton me përpikëri vendimet e Reis'ul-Ulemasë, udhëzimet e institucionit të BFI-së dhe të organeve të saj në kushte të mbylljes së plotë të xhamive, mejtepeve dhe të instituteve islame, përveç të Ezanit, që vazhdon të këndohet nga ana e myezinëve.

Spitali i Gostivarit dhe Myftinia e këtij qyteti – është thënë – bëjnë përpjekjet maksimale për kapërcimin sa më lehtë të sëmundjes Covid-19. Po ashtu, është theksuar se të gjithë qytetarët duhet t'u përbahen kushteve të gjendjes së jashtëzakonshme, të shpallur nga Qeveria, dhe udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Kreu i myslimanëve të Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi, ka përgëzuar ekipet mjekësore të Gostivarit për menaxhimin e situatës, duke thënë që donacionet për Spitalin e Gostivarit janë vazhdimësi e donacioneve që BFI ka bërë dhe që do të bëjë në të ardhmen edhe për institucionet tjera. Ai po ashtu ka bërë lutje që Zoti i madhërishëm të ndihmojë në tejkalimin e krizës me virusin Korona.

"JEMI ME POPULLIN"

Sot jemi këtu për të ndihmuar Spitalin Klinik të Tetovës jo vetëm me maska, por edhe me mjete tjera. Duhet të jemi me popullin tonë si në gëzim, ashtu dhe në hidhërim. I bëj lutje popullit që mos t'i nënshtrohet panikut. S'ka vend për pesimizëm, për shkak se ai që jep dhe që merr jetë është Zoti i madhërishëm, kështu që duhet t'i stimulojmë njerëzit që kjo situatë të kalojë sa më shpejt – ka thënë më 8 prill, 2020, në Myftininë e Tetovës, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të

Republikës së Maqedonisë së Veriut, **Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi**.

Kreu i BFI-së, me bashkëpunëtorë, në Myftininë e Tetovës ka ndarë 3 mijë maska mbrojtëse për Spitalin Klinik të Tetovës, donacion i Myftinisë së këtij qyteti. Pas Shkupit dhe Gostivarit, kemi ardhur në Tetovë, do të shkojmë edhe në shumë qytete tjera të Maqedonisë së Veriut, për të dhënë kontributin tonë si BFI në luftimin e pandemisë që ka përfshirë pothuajse tërë botën – ka shtuar Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepi dhe ka nënvizuar: "Gjithmonë duhet të jemi tok, të bashkuar, për shkak se vetëm kështu më lehtë do t'ia dalim me virusin. Myftinia e Tetovës e ka përcjellë me shumë kujdes dhe me vigjilencë të madhe situatën në terren dhe ne jemi mirënjohës për këtë."

Prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myftiu i Myftinisë së Tetovës, ka deklaruar se i është raportuar Reis'ul-Ulemasë për gjendjen në të gjithë hapësirën e Myftinisë që ai drejton, për respektimin e rregullave dhe të urdhëresave të ardhura nga organet më të larta të BFI-së dhe të gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur nga Qeveria. Njoftimi ka përfshirë virusin Korona dhe situatën e përgjithshme, hallet dhe dertet e besimtarëve, si dhe përgatitjet e tyre në vigjilje të muajit të shenjtë të Ramazanit.

Kryetari i BFI-së në Tetovë ka qenë i shoqëruar nga Myftiu i Shkupit **dr. Qenan ef. Ismaili**, i Gostivarit **h. Shaqir ef. Fetahu**, i Strugës **Salim ef. Sulejmani**, i Ohrit **Samet ef. Hajdari**, i Kumanovës **Abidin ef. Imeri**, i Shtipit **mr. Nasir ef. Rexhepi**, nga Sekretari i Përgjithshëm **Irsal ef. Jakupi**, Kryetari i OH "Hilal" **Mustafa ef. Dauti**, Drejtori i Drejtorisë për Diasporë **dr. Selver ef. Xhemali** e të tjerë.

NDIHMË PËR KATËR RAJONET E MYFTINISË SË SHKUPIT

Në prani të më shumë hoxhallarëve, OH "Hilal" dhe Myftinia e Shkupit më 13 prill, 2020, kanë ndarë ndihma humanitare për rajonin e Dervenit, të Karshiakës, të Karadakut dhe të Shkupit. Ndihamen janë siguruar nga donatorët "Gematik", "Eko Sharr", "Uka Komerc", "6 Vëllezërit" etj.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, **h. Sulejman ef. Rexhepi**, e ka çmuar lart bashkëpunimin e subjekteve ekonomike me BFI-në dhe me OH "Hilal", si pjesë e saj, sepse, ka thënë ai, "njerëzit sot, si kurrë më parë, kanë nevojë për ndihmë,

për shkak se janë të rraskapitur nga pandemia e koronavirusit".

Mr. Mustafa ef. Dauti, Kryetar i OH "Hilal", ka falënderuar Kryetarin e BFI-së për ndihmën e rezervë për Organizatën Humanitare, themelues i së cilës është ai vetë, dhe ajo tani vjen në kohën e duhur për të katër rajonet e Myftinisë së Shkupit falë donatorëve, të cilët, ka thënë ai, "gjithmonë kur u kemi kërkuar, na e kanë hapur derën". Reisi – ka thënë ai – na ka urdhëruar që në fillim t'i respektojmë vendimet e Qeverisë dhe gjithnjë të jemi të gatshëm ta japim ndihmën tonë, sidomos në këto kohë të vështira, kur tërë bota përballet me sëmundjen Covid-19.

Myftiu i Shkupit, **dr. Qenan ef. Ismaili**, është shprehur mirënjohës për ndihmën e ofruar nga sponsorët dhe për punën që ka bërë OH "Hilal". "Unë jam këtu vetëm në rolin e koordinatorit të ndihmave në terren, në shpërndarjen e tyre" – ka nënvizuar ai.

Ndihamen janë me paketa ushqimore dhe higjienike dhe do t'u ndahen kategorive më të prekura sociale të Myftinisë së Shkupit, pavarësisht besimeve të tyre.

AKSION HUMANITAR NË KUMANOVË

Organizata humanitare "Hilal" e BFI të RMV vazhdon me aksionet e saj humanitare.

Që nga fillimi i paraqitjes së Covid-19 dhe shpalljes se gjendjes se jashtëzakonshme në RMV, çdo ditë jemi në terren dhe vazhdojmë të ndihmojmë familjet me gjendje të rëndësishme sociale – është shprehur mr. Mustafa Dauti, Kryetar i OH "Hilal".

Aksioni humanitar i kësaj shoqate është zhvilluar më 20 prill, 2020, në Kumanovë, ku numri i të prekurve nga Virusit, siç bëhet e ditur, është menjëherë pas Shkupit.

Kemi ndarë pako me produkte ushqimore dhe higjienike. Ndihamen ia kemi dorëzuar Myftiut të Kumanovës, Abidin ef. Imeri, dhe operativës së Myftinisë. Njëherësh, i falënderoj për angazhimin dhe transparencën në shpërndarjen e ndihmave – ka thënë Kryetari Dauti.

Myftiu i Kumanovës ka falënderuar BFI-në dhe organizatën e saj "Hilal" për ndihmën e ofruar. Gjithashtu, Myftiu ka falënderuar Reis'ul-Ulema h. Sulejman ef. Rexhepin dhe Kryetarin e OH "Hilal" Mustafa Dauti, të cilët, ka thënë ai, vazhdimisht po e ndihmojnë Kumanovën, e në veçanti gjatë kësaj gjendje të jashtëzakonshme.

Ndarja e ndihmave nga OH "Hilal" vazhdon.



BËJMË BARTJEN E KUFOMAVE:

- Prej të gjitha spitaleve dhe shtëpive të shëndetit në tërë territorin e vendit,
- Prej aeroportit të Shkupit,
- Prej aeroportit të Prishtinës
- Prej aeroportit të Tiranës
- Prej portit detar të Durrësit
- Prej një vendi të caktuar (shtëpia e pleqve, burgje, banja, etj.)

Jemi në shërbim për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë 24/7.
Mund t`na kërkonit në telefonat vijues:

Adresa: Bashkësia Fetare Islame në RM,
rr. Çairska, nr.52, Shkup.

i-meil: er.rahatu.bfi@gmail.com

Tel: ++ 389 2 3117 410; ++ 389 2 3117 412

Mob: ++ 389 75 374 402; ++ 389 75 374 411



Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.